Metafora

Revistë letrare / nr. 1 / Prishtinë / qershor 2025



Floresha DADO

LSHK



Kryetari i LSHK-së, prof. dr. Shyqri Galica, në hapje të FNP "Drini poetik", 2025



FNP "Drini poetik", Prishtinë: Pjesëmarrës të festivalit

Metafora

Viti XIII, nr. 42

Boton
Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës
SHB "MESHARI", Prishtinë

Kryetar
Prof. dr. Shyqri Galica

Kryeredaktor
Prof. dr. Adem Zejnullahu

E redakton
Kolegjiumi i Redaksisë

e-mail. metafora-lshk@hotmail.com
(LSHK, Prishtinë)

Faqja ueb
www.lidhjashk.com / revista-letrare-metafora

fb: Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës
Mob. +383(0)44 158 324

Disenji
Armend Ademi

Shtypi
Printing Press



Akad. Prof. Dr. Floresha Dado

Pedagoge e studiuese e shquar e shkencave filologjike, një emër i veçantë i albanologjisë. Vepra e saj karakterizohet me akribi të thellë shkencore, ndërsa kontributi në fushën e teorisë së letërsisë është tejet i ndjeshëm.
Pos ligjërimeve në Fakultetin e Histori-Filologjisë të Universitetit të Tiranës, ka publikuar më shumë se njëqind tekste e artikuj shkencorë në sferën e teorisë dhe të kritikës letrare, ka mbajtur dhe një varg ligjëratash për studimet e larta në vend dhe jashtë tij.
Anëtare e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.



Publiku letrar



FNP "Drini poetik", Kukës: Pjesëmarrës të festivalit



Prof. Dr. Agim VINCA

REXHEP QOSJA PËR NAIM FRASHËRIN

Më vjen mirë që jemi mbledhur këtu në Frashër, për të folur për veprën e pavdekshme të vëllezërve Frashëri. Unë, që vij nga Prishtina, qytet që Naimi nuk harronte ta përmendte, sikurse edhe Prizrenin, Pejën, Gjakovën, Shkupin, Dibrën, Tetovën e Ulqinin, tek përvijonte poetikisht hartën etnike të Atdheut te Bagëti e Bujqësia (njësoj vepronte edhe Samiu te Shqipëria), pra unë që vij nga Prishtina, sot kryeqytet i shtetit të dytë shqiptar në Ballkan, do t'i them dy fjalë për studimet e studiuesit të shquar të letërsisë shqipe, akademikut Rexhep Qosja, për veprën e Poetit tonë Kombëtar.

Interesimi i Rexhep Qosjes si studiues i letërsisë për veprën e Naim Frashërit është i hershëm. Qysh në librin e tij të parë, Episode letrare (1967), ai shfaqte kërshëri për krijimtarinë e poetit të Luleve të Verës. Ky libër hapej me trajtesën Nji kuptim i të bukurës dhe dashunisë, në të cilën autori bënte përpjekje ta zbërthente poemthin erotik Bukurija në prizmin e botëkuptimit filozofik të poetit. Një vit më vonë, në librin Dialogje me shkrimtarët (1968), do të merret përsëri me veprën e Naimit, duke e shikuar atë në plan më të gjerë. (Njeriu etik dhe utopia e Naimit është një nga zërat e shkrimit). Ndërkaq, në librin e tretë, Kritika letrare (1969), duke folur për figurën e Skënderbeut në letërsinë e Rilindjes, pas shkoqitjes që i bënte poemës Histori e Skënderbeut, pohonte se heroi ynë kombëtar në vizionin naimian është "mit kolektiv dhe realitet historik".


Këto shkrime përfaqësojnë fazën e parë të Rexhep Qosjes si kritik letrar dhe të interesimit të tij për Naim Frashërin si shkrimtar.

"Porosia e madhe" - e pashmangshme në studimet naimiane

Ndryshe ndodh me studimin Semantika e rimës (1979), që i takon periudhës kur Qosja e kishte formuar metodën e tij si studiues i letërsisë, përfshirë edhe stilin dhe terminologjinë. Në këtë studim, poezia e Naim Frashërit vështrohet nga aspekti i rimës si përbërës i rëndësishëm i poezisë në përgjithësi dhe i poezisë naimiane në veçanti. Ky është në të vërtetë një studim i tri përmbledhjeve të tre poetëve të shquar të letërsisë shqipe: Lulet e Verësë të Naimit, Psallme Murgu të Asdrenit dhe Vargjet e lira të Migjenit, ku, pas një analize të hollësishme, edhe statistikore, autori vjen në përfundim se rima te këta poetë ka funksion jo vetëm eufonik, por edhe semantik.

Interesimi i Qosjes për veprën e Naimit do të zgjerohet dukshëm, duke marrë tipare, përmasa dhe cilësi të reja në veprën Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi I-III (1982-1984).

Te vëllimi i tretë i kësaj vepre kapitale, Qosja i kushton mbi njëqind faqe veprës letrare të Naimit, duke e vështruar atë prej tri aspekteve kryesore: nga aspekti i gjenezës së saj kulturore, kombëtare dhe botërore; nga aspekti i shumësisë së përmbajtjeve të saj dhe i realizimit të tyre ideoartistik me mjetet e shqipes dhe nga aspekti i ndikimit dhe receptimit të kësaj vepre te lexuesit shq-



Akad. Prof. Dr. Rexhep Qosja

iptar, përkatësisht i horizontit të pritjes (term i studiuesit gjerman Hans Robert Jaus).

Por kurora e punës studimore të profesor Qosjes për Naim Frashërin është pa dyshim monografia Porosia e madhe, vepër me një vëllim prej 600 faqesh dhe me një tirazh prej 5000 kopjesh, që doli te Redaksia e botimeve Rilindja e Prishtinës në vitin 1986.

E botuar gati dyzet vjet më parë, vepra "Porosia e madhe" mbetet e pashmangshme në studimet naimiane. Do-emos. Ajo është vepër e historianit të letërsisë që letërsinë kombëtare dhe veçanërisht atë të Romantizmit e ka fushë të specializimit dhe e intelektualit të mishëruar me vlerat shpirtërore të popullit të vet, ku vepra e Naimit zë kryet e vendit.

Në pamundësi që të merremi gjerësisht me këtë vepër, gjë që e kemi bërë në një rast tjetër, po cekim kalimthi disa nga vlerat dhe veçoritë e saj.

Për Naim Frashërin është shkruar më shumë se për cilindo shkrimtar tjetër të traditës sonë letrare. Për krijimtarinë e tij janë botuar shkrime të llojeve dhe formave të ndryshme: artikuj, recensione, trajtesa, sprova, vështrime, studime etj., por edhe vepra monografike, si ajo e Zija Xholit: Naim Frashëri - Jeta dhe idetë, e botuar në vi-



Naim Frashëri

tin 1962 dhe e Dhimitër S. Shuteriqit Naim Frashëri. Jeta dhe vepra, e botuar njëzet vjet më vonë (më 1982), ndonëse gurin e parë në themelin e godinës së naimologjisë sonë e vuri Mali Kokojka, alias Mid'hat Frashëri, me librin Naim be Frashëri të botuar në vitin 1901, një vit pas vdekjes së poetit, që ishte xhaxhai i tij. Duke përftuar nga përvoja e studiuesve pararendës, shqiptarë dhe të huaj, Rexhep Qosja arrin të bëjë një hap tutje në njohjen e poezisë së Naim Frashërit, por edhe të veprave të tij diturore, shkollore, filozofike etj.

Naimi - poeti më i madh i Rilindjes Kombëtare

Te Porosia e madhe analizohen gjerësisht veprat letrare të Naim Frashërit: poema lirike Bagëtia e Bujqësija (1886); vëllimi me vjersha atdhetare, dashurore dhe filozofikofetare Luletë e Verësë (1890); poemat Histori e Skënderbeut dhe Qerbelaja (1898), pa lënë mënjanë as veprat e shkruara në gjuhë të tjera si përmbledhja Tehajylat / Ëndërrime (persisht), poemat Dëshirë e vërtetë e Shqiptarëve dhe Erosi / Dashuria (greqisht) dhe novela Katër stinët (turqisht), por me subjekt të marrë nga letërsia frënge. Krahas analizës së bazuar mbi konceptet e teorive moderne letrare, ku teksti dhe konteksti ndërveprojnë reciprokisht, autori bën edhe klasifikimin gjinor të veprave që analizon. Konform përcaktimit të tij teorik, të një poetike strukturale historike, Qosja heton, në rrafsh sinkronik e diakronik, idetë, kuptimin dhe domethënien e veprës së Naimit, me një fjalë porosinë e saj të madhe kombëtare dhe njerëzore.

Në vështrimin e Rexhep Qosjes, Naim Frashëri është shkrimtar vepra e të cilit ka, përveç vlerës letrare dhe gjuhësore, edhe peshë të madhe etike, edukative, arsimore, pedagogjike; ajo është vepër e njeriut që ka luajtur rol të madh në kapërcimin e ndasive fetare, krahinore, dialektore apo edhe ideologjike. Duke qenë krijues që ngrihet përmbi këto kufizime, Naimi është, sipas Qosjes, shkrimtar i një rëndësie «mbiideologjike dhe mbipolitike», që do të thotë «shkrimtar i të gjithë shqiptarëve», të të gjitha kohëve dhe të të gjitha trevave. Për autorin e Porosisë së madhe, Naimi është, jo vetëm poet i dorës së parë - poeti më i madh i Rilindjes Kombëtare - por edhe pedagog, filozof, shkencëtar, mësues, veprimtar, atdhetar dhe humanist i madh.

E shkruar me dashuri e adhurim për veprën dhe shëmbëlltyrën e poetit apostull, Porosia e madhe është vepër që bën «jetëshkrimin krijues të Naimit», në krijimtarinë e të cilit, sipas Qosjes, sintetizohen prirjet letrare, gjuhësore, ideore dhe stilistike etj. të letërsisë, të gjuhës dhe të kulturës shqiptare deri në atë kohë dhe hershohen (anticipohen) kahet e mëtejshme të zhvillimit të tyre.

Si e tillë, vepra Porosia e madhe paraqet një gjedhe të monografisë shkencore për krijimtarinë tërësore të një shkrimtari të traditës, kurse autori i saj, Rexhep Qosja, rezulton studiuesi më i përkushtuar i veprës së Naimit deri në kohën e botimit të Porosisë..., në mos edhe deri më sot. (Nga studimet e bëra në periudhën pas ndryshimeve politike në Shqipëri, vëmendje dhe vlerësim të veçantë meriton studimi i Jorgo Bulos, Tipologjia e lirikës së Naim Frashërit, 1999, një qasje e re poezisë lirike të Naimit, që është kuintesenca e krijimtarisë së tij).

Roli i Naim Frashërit në letërsinë dhe kulturën shqiptare është, pak a shumë, i ngjashëm me atë të bardëve nacionalë në vendet e tjera evropiane dhe ballkanike, çfarë janë: Hygoi në Francë, Bajroni në Angli, Pushkini në Rusi, Leopardi në Itali, Mickieviçi në Poloni, Eminesku në Rumani, Pallamasi në Greqi etj., por në kushte specifike shqiptare, ku poeti është i detyruar të bëjë, pos vjershave dhe poemave, edhe tekste shkollore dhe të kërkojë leje për hapjen e shkollës së parë shqipe.

Vepra dhe idetë e Naim Frashërit, sikurse edhe ato të vëllezërve të tij, enciklopedistit Sami Frashëri dhe ideologut Abdyl Frashëri, janë shprehje e aspiratave të kohës kur jetuan e vepruan, pra, shprehje e aspiratave liridashëse dhe qytetëruese të epokës së tyre, të gjysmës së dytë të shek. XIX (më i riu ndër ta, Samiu, me jetën e tij preku edhe fillimin e shek. XX), por edhe një nxitje për të ardhmen dhe si të tilla vazhdojnë të jenë të gjalla e frymëzuese. Rëndësia e tyre bëhet edhe më e madhe sot, kur në botën shqiptare, si pasojë e rrethanave të reja politike e shoqërore, por edhe e proceseve globale në botë, janë rishfaqur tendenca dhe dukuri që dobësojnë kohezionin shpirtëror të shqiptarëve si komb.

Dhe, në fund, edhe diçka.

Frashëri, ky fshat me natyrë fantastike dhe me histori të lavdishme, që i dha kombit tre njerëz të mëdhenj të kohës së vet dhe profetë të së ardhmes, duhet të jetë vend pelegrinazhi për shqiptarët. Që vendlindja e vëllezërve Frashëri, këtyre tre korifenjve të gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare, por edhe të mendimit politik shqiptar, të bëhet e tillë, duhet, pos veprimtarive intelektuale, edhe mbështetje institucionale. Shkurt e shqip, ky fshat qytet, si e quante Samiu Frashërin tek Enciklopedia e tij, dikur i banuar cep më cep, kurse sot, mjerisht, i zbrazët, meriton vëmendje më të madhe të institucioneve shtetërore. Në ditëlindjen e poetit që shkroi vargun lapidar: "Ti, Shqipëri, më jep nder, më jep emrin shqipëtar" dhe që iku në amshim 125 vjet më parë, Frashëri thërret për ndihmë! Duhet dëgjuar ky zë jetik!



Zeqir GËRVALLA

DO TË VIJË NJË KOHË

PAK BIOGRAFI

…Im atë
Lindi në perëndim të diellit
E unë - në mesnatë
E ti - me yllin e parë të mëngjesit…

E tërë dita e madhe
Është para teje, bir.

Gjyshi betohej në shpatë
Babai - në pushkë
Unë - në libër
E ti… ku ta di!

Toka, biro,
gjakon njerëz të rinj.

PORTRETI I NJË MALËSORI

Në shpinë - një barrë
Në kraharor - një varrë
Në sy - një lot
Në zemër - barot.

Këmbëzbathur ecën
Rrugës zigzage të malit
"A t´ia zë pritën hasmit -
A t´i blej abetare djalit?"

FJALA E TIJ
(Rexhep Elmazit)

Do të vijë një kohë
Që do ta dënojë një kohë
Edhe për vdekjen time

Do të vijë një kohë
Që do ta ndriçoj një kohë
Edhe me fjalën time

Do të vijë një kohë
Që do t'i lidhë të gjitha kohërat
Edhe me lindjen time

KOHA E LULEVE

Koha e luleve - zëri i zogjve
Ku po të dhemb, o Nënë!
Malli yt - deti i lotëve…
…Natë e errët pa yj e hënë!
…për diell yj e hënë
Vera do t'vijë
E frutat do t'piqen, o Nënë!

NUK DI

S´di
Një natë ka kaluar
Apo një shekull vetmi
S´di
Zëri im apo zëri yt
Del nga kjo thellësi
S´di
Unë bie apo trungu im
Lulëzon përsëri





Prof. Mr. Naxhie KASTRATI

MËRZIA E VAZHDUESHME E MITROVICËS

Përmbledhja poetike "Mërzia e Mitrovicës" e profesorit Muhamed Kërveshi, krijuesit tonë të shquar të të gjitha zhanreve dhe gjinive letrare, është përmbledhje vargjesh e shkruar me një përvojë krijuese të një mendimi të thellë të kultivuar mjeshtërisht.

Me këtë vepër profesor Muhamed Kërveshi ndalet edhe njëherë andej nga i ka rrënjët, në Mitrovicë. Mitrovica është e ndarë, vret. Ndaj Mitrovica e rikthen edhe njëherë birin e vet në gjirin e saj, t'ia shohë plagët e saj, të venerojë sa të thella janë. Poeti i rraskapitur nga dhembja, ulet në Urën e Ibrit të tij të rrëmbyer, se ku ta dijë nëse mund kthehet edhe njëherë tjetër. Dhe, profesor Kërveshi ka hequr mall, duke qarë me lot e ngashërime, me dënesje e ulërima. Për ato që i kanë parë sytë dhe i ka ndier zemra, kur ka qëndruar mbi urën e gjymtuar, poeti ynë ka bërë gjëmë, ka vajtuar si asnjëherë më parë …*sy të ndarë / një sy andej / tjetri këndej… andej nata / këndej dita…*

Kjo përmbledhje e vargjeve të latuara me mjeshtëri dhe përvojë krijuese e tij, është e tëra dhimbje dhe pikëllim. Mërzia e tij është në lulëzim, ajo pikon veç mërzi që nuk di të prajë asnjëherë. Një *Spleen* i vazhdueshëm e ka kapluar, e ka zënë me gjemba, e ka kërrusur, e ka pikëlluar…



Prof. Dr. Muhamed Kërveshi

Spleeni i prof. Kërveshit është i njëllojtë sikurse S*pleeni* i veprës "Lulet e së keqes" të Sharl Bodlerit, simbolistit më të madh botëror, të cilin poeti ynë e përktheu me dashuri, që e kishte aq për zemër.

Këto poezi pikojnë pikëllim...

Mërzia e Mitrovicës rrjedh vrer, mërzia e Mitrovicës çel sythe, çel lule mërzie, mërzia e Mitrovicës gjakon. *Spleeni* i Kërveshit përkundër atij të Bodlerit është më universal, më tokësor, më shpirtëror. Derisa Bodleri i flet një mërzie të vazhdueshme që godet njeriun nga fëmijëria dhe vazhdon pa e ndalur rrjedhën gjatë gjithë jetës së tij, ngaqë si fëmijë jetim Bodleri ndihej i përbuzur nga njerku diktatorial e nga nëna soprano, mërzi e tij shkon tutje rrjedhjes së vet për ta përplasur me *Spleen* poetin e vrarë edhe nga dashuria. Me gjithë mërzinë e Bodlerit, që është individuale, Mërzia e Mitrovicës e profesor Kërveshit është kolektive. Ajo po ashtu sikurse te Bodleri është *Spleen*, një mërzi e vazhdueshme që rrjedh pa pra, por që helmi i saj helmon të gjithë përreth, këndej e andej Ibrit. Një zog matanë urës ka krahun e lidhur e nuk po mund t'i bashkohet tufës. Ky zog Mitrovice është edhe zog Kosove, prandaj, mërzia është gjithëpërfshirëse, rrjedh pa u këputur gjithandej dejve të mëmëdheut. Ibri nuk po sheh matanë veriut, ngaqë rrethoja me gjemba i kanë vënë në kurriz e sytë e atdheut po qajnë, mërzia nuk ka fund.

Në qytetin e erërave / jepet sonte / shfaqja mërzia / Perdja u hap / rolin kryesor e luan / mërzia. Shfaqje shumë e gjatë…

Kjo temë nuk është trajtuar asnjëherë më parë më thellë e më me përkushtim sesa te këto poezi që pikojnë pikëllim. Kërveshi sjell nota të trishtueshme, aktuale, që shfaqen figurshëm me një gjuhë shumë të pasur, me një fjalor të kursyer që bart peshë të rëndë e të nderë, që vret thellë në vetëdijen e shkrimtarit. Vargjet e sjella në këtë përmbledhje shpeshherë qëndrojnë si vargje më vete. Ato mund të jenë motive për tema të reja, lënë vend për interpretime të tjera më të thella. Një numër i madh i poezive të shkurtra të kurdisura me të tjerat aq mirë si Ora e Gijom Apolinerit japin copëza dhimbjesh, pjesë që çjerrin, saqë poeti klith …*më dhemb edhe lulja e shpirtit. Dhembja ime urë pikëllimi im Ibër!*

Me këto vargje kushtuar prof. Latif Berishës, vendësit, mikut të tij të studimeve, fillon vepra "Mërzia e Mitrovicës": *Qyteti është i plagosur / në jug na dhemb veriu i ndarë.* Muhamed Kërveshi na kujton edhe njëherë të fundme se duhet të kthejmë sytë andej Ibri. Gjaku nuk lihet të humbasë. Mitrovica do një dorë për ta mbajtur, një krah për ta mbështetur, një zë për t'u dëgjuar. Kërveshi dëshiron ta përmbushë amanetin e moçëm; t'i dalë zot tokës së tij të vjedhur hajnisht, të prerë në besë nga besëkëqijtë, nga dinakët. Evropa na bën hile…

Profesor Muhamedi nuk mund të mbyllë sytë pa e parë Mitrovicën të bashkuar, pa e parë fluturimin e zogjve, pa

u ndier fërkemet udhëve të saj, andej e këndej ure, se … urat janë për të parë me sy, e sytë nuk po shohin matanë urave, përtej brigjeve. *Sytë e mi të ikur / i kërkoj në Mitrovicë.* Me përmbledhjen poetike "Mërzia e Mitrovicës", poeti solli një vepër të realizuar mjeshtërisht, një poemë, në mos një elegji, pa shfaqur emocione të tepruara. Ai e lë poezinë të piqet për të dhënë fryte më të arrira apo vargje të përsosura: *…dhembja ime urë / pikëllimi im Ibër.* Duke personifikuar urën me veten e tij dhe pikëllimin me Ibrin, poeti i flet urës që ka kurthuar Ibrin e rrjedhshëm: *Mitrovicës i duhen dyer dhe dritare të reja.*

Si na mbeti Mitrovica me një derë jashtë dyerve të atdheut. Një kleçkë e vënë në zemër të Evropës. Gjakon dhe paralajmëron profesori më 2015 se gjendja është shumë e rëndë, prandaj *Spleeni* ka lulëzuar lule të tjera të së keqes, lule të egra që kanë marrë malin me dergjen e fryrë… *Mitrovicës i duhet një rrugë më e drejtë*, thërriste poeti atëherë, po tani? *Spleeni* është në lulëzim. Kosëtarëve u janë ndryshkur tehet, lozët e stërkequra kanë kapluar edhe detet.

Ura e dhembjes - për ta pikëlluar lumin nën të

Libri ka dy pjesë – "**Mitrovica, qyteti i pikëllimit tim**" dhe "**Mërzia e Mitrovicës**". Të dy pjesët kanë nga njëzet poezi. Në pjesën e parë poezitë kanë tituj, ndërsa pjesa e dytë e poezive është shënuar me numra që nisin nga një dhe shkojnë deri në njëzet. Të gjitha poezitë janë të lidhura njëra me tjetrën varg. Në poezinë e dytë ka ndonjë varg të poezisë së parë e kështu me radhë, krijohet një varg poezish me elemente të bartura, të ngjashme siç barten gojëzat e varganëve, për të krijuar një varg zinxhiror mërzie, që nuk këputet, por vazhdon të gojohet duke pjellë varganë edhe më të zinj mërzie kombëtare.

Secila gojëz e vargut vazhdon udhën e mërzisë për Mitrovicën, në të cilën valojnë flamuj serbë, *"edhe era flet me fotografitë e çetnikëve të afishuar mureve tona."* Këta janë varganët e mërzisë së vazhdueshme të nyjëtuar fort mbi lumin e Ibrit, që ndajnë qytetin në dysh.

Në gjithë përmbledhjen vërehen tri elemente kryesore që enden gjithandej basmës së librit me fije të holla brilante, me penj të hirtë, të zinj, të murrmë: Ibri, Ura, Mitrovica. Pastaj tri fije të tjera që natyrshëm lidhen me të parat, zogu me krahë të lidhur, antitezat jugu-veriu, dita-nata dhe këndej-andej. Dhe, kjo basmë e errët vesh gjithë Mitrovicën. Prandaj, poeti klith, *Mitrovicës i nevojiten rroba të reja. Është e veshur me rroba të grisura / me rroba të huaja.*

Qyteti i ndarë, lumi i ndarë. E, urat përse të shërbejnë, ato kanë të vetmin mision; bashkojnë brigje, njerëz, qytete. Por ura e dhembjes, e Ibrit e ndan qytetin e saj për ta pikëlluar lumin nën të; për ta kërrusur qytetin, i cili shkallë-shkallë përjeton dhimbje, shfaq dhimbje, kullon dhimbje, e gufon veç dhimbje deri në ulërimë. Por, nuk përkulet qyteti… ecim, ecim, ecim…

Uluron ura, Ibri, Mitrovica e kërrusur, ulërima e saj dridh natën, ulërima e Mitrovicës së kërrusur shpon veshët




Një çast - prof. Muhamed Kërveshi në një takim me Adem Demaçin

e shurdhër. Zogu i Mitrovicës është edhe zog Kosove, i dhemb krahu i lidhur. Zogu ëndërron të fluturojë matanë Ibrit, janë thirrje për çlirim, janë thirrje për të bërë bashkë veriun me jugun, për të shëruar Zogun me krahë të lidhur, për t'i veshur rroba të reja Mitrovicës, për ta çliruar, për ta sjellë brenda dyerve të atdheut.

Në përgjithësi, të gjitha ndarjet apo pjesët e poemës janë të shkruara në distikë me një gjuhë të pastër dhe figura stilistike ndër më të ndryshmet, dominon antiteza, personifikimi, metafora, epiteti, si te fjalët: Mitrovica e pikëlluar, dua të jem Ibër pikëllimi, e kërrusur, krahu i lidhur etj. Antiteza është figura qendrore e gjithë përmbledhjes, zaten kjo është ndër figurat më të përdorura nga mjeshtrit e mëdhenj të fjalës së bukur artistike. Kjo figurë paraqet realitetin si *mimesisi*, këndej dita, andej nata, për ta realizuar pastaj mjeshtërisht *poessisin* me një gjuhë të thukët të kursyer nga çdo gjë boshe. Me kaq pak fjalë, eruditi Muhamed Kërveshi shpërfaq një realitet të tërë, një dhembje bjeshkë. Qëllimi i tij është që me anë të kundërvënieve që sjell në librin "Mërzia e Mitrovicës" të zgjojë një popull të tërë, t'ia kujtojë atij se varret janë andej… Na ka mbetur një gjymtyrë matanë, prandaj ne këtej që jetojmë me ditën, duhet mbrojtur varret tona të lashta… që i ka zënë terri i vazhdueshëm, që i ka kapluar zija, që ende vazhdojnë të rrojnë në *Spleen*. Sepse, derisa më 2015 kishte fotografi të çetnikëve të afishuara mureve, sot ata kanë dalë që andej dhe po e bëjnë lëmsh politikën, po kërcënojnë atdheun.

Ne në këmbë, ecim, ecim, ecim. Ne në këmbë, Kosova në këmbë!



Prof. Dr. Sabile KEÇMEZI - BASHA

GRATË LUFTËTARE NË KRIJIMTARINË ARTISTIKE

Është një sfidë në vete, por dhe një përulje – një përpjekje për t'u dhënë një mirënjohje, sado të vogël, grave që për lirinë krijuan gjithçka. Në çdo fjalë që do të shkruaj, dëshiroj të paraqes jo vetëm dhembjen, por edhe guximin, jo vetëm luftën, por edhe dashurinë që i shtyu të qëndronin deri në fund. Kjo ide është më shumë se një temë, ishte një premtim që ato gra, me gjithë heroizmin e tyre të pamatshëm, nuk do të harrohen kurrë.

Kjo histori shumëshekullore është e mbushur me emra të paharruar dhe me zëra që flasin për kurajën dhe përkushtimin e gruas shqiptare. Kosova mburret me heroinat e saj: Shotë Galica, simbol i rezistencës dhe i sakrificës; Marie Shllaku, zëri i arsimit dhe i humanizmit; Gratë e Jasharajve, simbol i stoicizmit dhe i dashurisë për atdheun; Xhevë Lladrovci, luftëtare e paepur për liri; Hanumshahe Avdullahu, një ikonë e devotshmërisë dhe e forcës.

Simbol i përjetshëm i guximit dhe i krenarisë

Por Kosova ka edhe shumë e shumë gra të tjera, heroinat e heshtura që bartin peshën e historisë në heshtjen e tyre madhështore. Ato janë pjesë e një tapicerie të gjerë, që meriton të njihet e të nderohet. Në një ditë tjetër, në një vend tjetër, do të përpiqem të përmend çdo emër të tyre, sepse ato janë yjet që ndriçojnë qiellin e lirisë sonë. Çdo hap i tyre, çdo sakrificë dhe çdo betejë, është një testament për forcën e jashtëzakonshme të gruas shqiptare dhe përkushtimin e saj ndaj lirisë dhe drejtësisë.

Nga viti 1981 e më tej, historia e dhimbjes së popullit shqiptar u shkrua me penën e padrejtësisë dhe të lotëve të pafajshëm. Më shumë se gjysma e popullatës u ndalua, u pyet dhe u trajtua me ashpërsi, pa kursyer as gratë, simbolet e jetës dhe të qëndresës. Çdo vit që kalonte, intensiteti i ndjekjeve dhe i maltretimeve ndaj femrës shqiptare rritej si një dallgë e pamëshirshme që përplasej mbi brigjet e dinjitetit të saj.

Gruaja shqiptare, si një emblemë e forcës dhe e guximit, kishte të njëjtin fat të hidhur me burrin, duke përballuar maltretime e dhunë të pamëshirshme. Brutaliteti nuk njihte kufi – ajo u rrah, u shtyp nga armët dhe shkopinjtë prej gome, u shkelmua me egërsi, u burgos, ndërsa mbi trupin e saj shfryhej shovinizmi barbar. Madje, mizoria sulmonte edhe lindjen e saj, duke e kërcënuar: "Më nuk do të lindësh shqiptarë të vegjël!"

Në agimin e fundit të shekullit, shqiptarja vijonte të përndiqej nga plumbat dhe dhuna, duke paguar çmimin e kërkimit të lirisë dhe të barazisë. Në pragun e shtëpisë, në dhomat e saj, ajo u vra dhe u plagos vetëm pse donte të jetonte e lirë. Rrugët e Kosovës dhe sheshet e mbushura nga demonstratat u bënë dëshmitarë të sakrificës së saj – aty ku ajo ngrihej si një zë i palëkundur për liri, u rrëzua nga dhuna e pashpirt, por kurrë nga fryma e saj e pathyeshme.

Ajo nuk ishte thjesht një grua – ishte një flamur që valëvitej për të gjithë ata që ëndërronin një të ardhme të drejtë. Çdo plagë mbi trupin e saj është një testament i sakrificës dhe i rezistencës, një kujtesë e përhershme e shpirtit që nuk mund të mposhtet. Gruaja shqiptare, edhe në dhimbjen më të madhe, qëndroi si një simbol i përjetshëm i guximit dhe i krenarisë.

Gjatë luftës së fundit të UÇK-së, 45 gra shqiptare ranë dëshmore, duke mbajtur mbi supe barrën e një dhimbjeje të pamasë dhe një sakrifice të pavdekshme. Ato u vranë në mënyrën më çnjerëzore, duke përjetuar dhunë që thyen trupin, plagosin shpirtin dhe sulmojnë vetë qenien e tyre të brishtë. Metodat barbare nuk kursyen asgjë, duke i shtrënguar ato në një vorbull të mallkimit dhe të tmerrit.

Kur të lexosh për këto gra, ato do të hyjnë thellë në qenien tënde, duke u bërë pjesë e shpirtit dhe e dhembjes sate. Është e pamundur të mos ndiesh tronditje, dhe nëse ke qoftë dhe një ndjenjë poeti në shpirt, lapsi do të të thërrasë vetë për t'i dhënë zë këtij rrëfimi. Nuk mund të qëndrosh indiferent – do të ndiesh nevojën ta përjetësosh historinë e tyre në vargje që frymojnë dhimbje dhe krenari.

Edhe nëse nuk je këngëtar, zëri yt do të dalë si një melodi përvajtëse, një refren që përngjan me notat e dhimbjes dhe madhështisë në Boleron e Maurice Ravelit. Piktura do të lindë vetiu, sikur Onufri të kishte marrë përsëri furçën e tij për të kapur shpirtin e sakrificës dhe të trimërisë. Regjisorët, të kapur nga frymëzimi, do të krijonin një film sa çel e mbyll sytë, një epikë vizuale që do të shfaqte gjithë dritën dhe hijen e këtyre heroinave.

Një histori rrëqethëse

Këto gra janë muzë për çdo art, burim i pashtershëm frymëzimi për të gjithë ata që duan të kapin të vërtetën e shpirtit njerëzor dhe të shkruajnë historinë e tyre nëpër kohë. Çdo varg, çdo notë, çdo penel dhe çdo kornizë filmi qëndron si një testament për heroizmin dhe qëndresën që ato mishëruan.

Këto gra, me sakrificën dhe qëndresën e tyre, janë flamuj që valëviten përjetë në kujtesën tonë. Ato janë dëshmia e gjallë e shpirtit shqiptar që nuk dorëzohet,



Nga cikli "Në udhëtim"

një frymëzim për brezat e ardhshëm dhe një përkujtim që na fton të mos harrojmë kurrë dhimbjen e tyre dhe krenarinë e tyre të pashuar.
Vetëm në vitet e ngarkuara të 1981-1990, numrat rrëfejnë një histori rrëqethëse: 3,348 shqiptarë të dënuar, 183 të vrarë nga armët e ushtrisë dhe të policisë, përfshirë 16 fëmijë. Pas këtyre shifrave është një dhimbje e pamasë, një britmë që nuk u dëgjua. Edhe gratë nuk u kursyen: burgosjet e tyre, nga viti në vit, ishin plagë të hapura që dëshmonin një padrejtësi të thellë. Shtatë gra më 1981, katër më 1983 dhe lista të gjata duke u rritur çdo vit që kalonte.
Pjesa më e madhe e të burgosurve politikë ishin të rinj – 18 deri në 20 vjeç, 26 për qind e tyre, ndërsa 21 deri në 24 vjeç përbënin 21 për qind. Por edhe fëmijët, 14 dhe 15 vjeç, nuk i shpëtuan këtij realiteti të egër, përfaqësuar në 3.9 për qind të dënimeve. Të miturit e moshës 16-18 vjeç, me 15.6 për qind, bartnin mbi supet e brishta një barrë të rëndë që nuk u takonte.

Vera ISTREFAJ
GJETHNAJË SHPIRTI

Gjethnajës së shpirtit fëshfërisin mendimet
Gjethe më gjethe peshojnë dhimbjet
e me pika vese ujis sythe shprese

Puhizë e pranverës freskon shpirtdjegien
Kohë mbi kohë, dhimbje mbi dhimbje
mbjell fidanë të jetës

Me rrezet e diellit përkëdhel ëndrrat
Pranverohet shpresa ime çdo vit që ikën
Gjethnajës së shpirtit fëshfërisin mendimet
në pritje të vjeshtës mbi gjethe mundimet

Xheladin MJEKU
ME DORËN TËNDE TË BEKIMIT

Të prekën yjet pa dorën tënde të bekimit
Një mundësi të tillë zemra s'ma thotë
Pa bekimin tënd me shpirt engjëlli
Universi i dritës nuk më hapet dot

Edhe sikur t'i prek yjet lart në qiell
Pa ty nuk jam vetvetja e guximit
Ëndrrat e dashurive të mëdha
Më mbyten oqeaneve të pafund
Dhe dita më përfton si hije e pavërejtur
Pa ty neveria mallin po ma shkund

Me dorën tënde të bekimit prek yjet në qiell
Galaktikën e ëndrrave e kthej në realitet
Shtigjeve të jetës u çel hulli të reja
Ditës ia hap perden e flatrimit të vërtetë.

Kujtimet më treten si krahnezë para agimit
Hap krahët e ëndrrës deri në dashuri
Për ty thur kurora fushave të gjelbërimit
Qielli më errësohet edhe në pikëditë
Mes yjeve të kërkoj me pishtar në dorë
Shtegtar i paepur gjithkah nëpër orbitë

Dora e bekimit m'i zbret yjet në shuplakë
Fryma jote engjëllore shpirtin ma ndez flakë
Jetës i japim fre shtigjeve të adhurimit
Pa ty s'do të isha vetvetja e guximit



Istref HAXHILLARI

MUZIKTARI PLAK
(*Tregim*)

Burri me kaçurrela lëshuar teposhtë zverkut shkeli i druajtur oborrin e hijesuar nga pemët e kopshtit. Ishte i ligështuar, donte të zbrazte teprinë e dhimbjeve. Muziktari plak ngriti violinën të mbrohej nga drita e fortë. Prapa vetullave të brymta, bebëzat në bojën e verës së fortë kundruan paqësisht.
Iu bë se e njihte, ndoshta i ngjante dikujt!
- Si të quajnë? - e pyeti.
Zërin e kishte të vjetër e të ngadaltë.
- Omer.
- Gruan?
- Nuk jam i martuar.
Priti të kthjellohej. Sytë rrethuar me shirita të zbardhëllyer e prekën. Kur ngjyrat humbasin veten, e liga ngulet thellë palcës së shpirtit, turbullon mendjen.
- Vaje, - u ftillua, si të kujtohej atë çast përse erdhi. - E mbaja në pëllëmbë të dorës... harroi dhjetë vjet si të mos qenë kurrë... u largua nxitimthi, si era.
Fjalët rrodhën më shpejt se mendimi. Copë-copë, të rrëmujshme. Ankimi sikur vinte nga zonat e largëta në periferi të ndërgjegjes, buzët artikulonin mekanikisht fjalët. Gruaja s'ndryshonte nga të tjerat, kënaqej me plotësimin e dëshirave, efektin e drejtpërdrejtë të sharmit, veçse dhjetë vjet ishin shumë, për të mos pasur zemër.
- Ik, - e përkëdheli me sy, - ik dhe mos e ndiq, thyeja zemrën.
E vështroi me habi fëmijësh, pa kuptuar kurrgjë.
- Eja pas një jave, - i tha.
U ngrit në këmbë, i rrudhur, imponues. Në dorën e majtë violina u ankua.
Omeri kapërceu portën aq ligsht sa erdhi. U end rrugëve pa ndonjë drejtim. Me shushurimën e erës dhe zërin vajtues të violinës muzikë sfondi.
Hapi i zvargur, fjalët të vyshkura.
"Ç'dreqin nuk shkonte?"
Ftohja erdhi papritur. Bënin dashuri si ngaherë, po fjalët rridhnin nëpër gjuhë të zbehura, të përcipta. Heshtja zgjaste, sytë bosh i ngulte kushedi ku. Megjithatë, ishte e vetmja që mund ta ngushëllonte.



Nga cikli "Qetësia"

- Ç'të ka gjetur? - dëgjoi zërin e Giles.
- Asgjë, - u tremb, si i kapur në vendin e gabuar.
- Nuk më fshihesh dot, - i tha pa shqitur ngërdheshjen miqësore buzëve, - vjen një ditë, gratë mërziten. - Nuk e honepste përfshirjen serioze në lidhjet me gratë, aq më tepër vuajtjen.
Nuk e ndihmuan fjalët, as buzëqeshja.
- E desha pa hile, - lëshoi një fije zëri, - s'e harroj dot.
- Lëri, ore, këto!
E përcolli me sy. I shfytyruar, mbledhur grusht.
"Tërë ai Omer! Për një grua!"
Nuk ishte i vetmi që çuditej.
E ëma e priste me ankth. Vonesa i futi dridhmat. Sytë e plakur, të rreshkur, pikëpyetje e madhe, e harkuar.
- Më dhemb gjoksi, - i tha nëpër dhëmbë.
I mbyllur, me zor i nxirrte fjalët.
Nuk e besoi...
Ditët rrëshqisnin, ai zhytej brenda vetes. Njerëzve u dhimbsej.
Letra me shenjat e mistershme i rëndoi më tepër se fletët e zakonshme.
- Gjej dikë ta lexojë, - i tha muziktari plak, i mallëngjyer si t'i dorëzonte diçka tejet të rrallë.
I ra ndërmend Gilja. Grupi i tyre mbahej ndër më të mirët e qytetit. Sidomos violina.
- Duhet të vini në opera, - u pati thënë muziktari vite më parë.
Tani ishte reklama e grupit.
Kënga e re u hyri në zemër.
- Ç'dhimbje! - psherëtiu violinisti, - bar plagësh.
Këngëtari u përlot...
Me këngën hajmali brenda vetes, u end rrugëve të qytetit, i turbullt si mëngjes dimri me diell të fshehur. Tundte kokën, përtypte nëpër dhëmbë copëza fjalësh. Shtëpinë e harroi, flinte ku ta zinte nata. Lumi i kohës merrte me vete gjithçka. Atë e anashkalonte.
S'ia mbështillte dot pikëllimin...
Të dielën e fundit të gushtit Gilja e mori me vete.
- Mos u ndie! - i tregoi karrigen prapa orkestrës.
Dasma ishte gëzim pas humbjesh të njëpasnjëshme. Vallet, këngët, bisedat e vogla, të parëndësishme, mpinin dhimbjen. Ahengut i dha gjallëri një grua shtatlartë, me cipën e lëkurës të ndritshme, flokë të bollshëm derdhur supeve. Pas e ndiqte shoqja e pandarë e gëzimeve dhe e brengave të jetës së tyre bosh. Hareja i dehu njerëzit më shumë se vera e rakia.
- Këngën e re, - thirri një zeshkan çakërrqejf e bukurosh me mustaqet e holla të përdredhura.
Gotat i pinte radhazi.
- Këngën e re, - bërtitën njëherësh sedërqarë e marrakë që e ndiqnin hap pas hapi në pije, valle, sherre.
Dasmorët mbajtën frymën.
Violina rënkoi me zë të mekur, dajrja e ndoqi me britma të shkurtra ekstaze si në një shkëmbim të shpejtë intimiteti. Tingujt erdhën duke u ngritur, derisa shpërthyen rrapëllimë gurësh shpateve të thepisura.

Greta KADARE

TË PRES TE SYTË

Besoj ende se do të vish, veç
kur të vish
mos më eja më nëpër gjinjtë e mi.
Koha shtroi mbi to dëborë,
u ftohën
mushkëritë, zemra, u lodhën
dhe trupi u shter,
mos duket më oazë e bukur.

Vetëm sytë s'pranuan të vdesin
në këtë vjeshtë që di të heshtë,
e thinjet sikur pylli përpara dimrit.

Eja, sikur dielli, qielli, që s'fiken kurrë —
veç kur të vish, të pres te sytë.

Rënkimet e violinës u bënë të pikëllimta.
Këngëtarin e rrëmbeu dalldia. Lotët pikuan telat e violinës, u përzien me notat, i dhanë këngës dhimbje.
Njerëzit u ngashëryen...
Burri i leckosur braktisi qoshen e fshehtë, u ngrit në këmbë lugat.
- Për atë zot, mos ndaloni! - u çor me aq zë sa i kishte mbetur.
Gruaja shtatlartë me lëkurën e lëmuar zuri sytë, i hapi, u plas në dysheme. Leshrat iu shpleksën fytyrës, qafës, gjinjve ngjyrë kajsie. Dasmorët bërtitën njëherësh, shumë syresh u rrekën ta sillnin në vete.
Një klithmë e trembur u ngrit disa nota më lart se të tjerat.
Shoqja e saj ra pa ndjenja.
Omeri u mblodh, si ta kishin fshikulluar me kamxhik. Jehona tepër të thella gurgulluan të rraskapitura, duart u çliruan prej ngërçit, shikimi iu kthjellua. Lotët bënë udhë faqeve të palara.
Për herë të parë pas shumë kohe.
Çau grumbullin e grave, u përkul mbi të alivanosurën, i përkëdheli flokët e rrëmujshëm, zverkun, buzët e plasaritura.
- Ka qenë e tmerrshme, - i tha.
I pazoti të gjente fjalë tjetër.
Vaja hapi sytë, e mjeruar si të mos kishte bërë atë që bëri. Buzët ia veshi diçka si nënqeshje e përgjumur.
- E ç'faj mund të kesh! - pëshpëriti.
Ngecën në krahët e njëri-tjetrit.
Zërat e ngjirur, puthjet, psherëtimat i mbytën tingujt e këngës së re të muziktarit plak.



Rrustem BERISHA

DRITË PËR SYTË

ATDHE S'KA TË DYTË

Zemra rrah gëzueshëm n'dheun tënd
ndihet Zemra rrah gëzueshëm prek gurrave
Përqafon hapësirën në çdo kënd
Ku zëri i fortë i burrave

Në luftë shkohet për fitore
Pika e fundit për të vdekur
Ngul mendje gazmore
Atdheu nuk të lë t'vdekur

Atdheu kurrë s'humb burra
Nuk lë burrëri në harresë
I përtërin ata si gurra
Me emrat e tyre shpresë
Atdhe s'ka të dytë
Shpresë e dritë për sytë

KUSH JEMI

U ngritëm pas shekujsh robëri
U ngjallëm u bëmë kush jemi
Pikërisht në shekullin e ri
Kosovën e lirë e kemi

Historinë e prapashpinës e dimë
Kur na vranë haptas e tinëzisht
E volëm në kujtesë e shtimë
Atë sundim mizorisht

Nuk na rrah çekani robëri
S'ka gjurmë ushtrie të huaj
Kosova është Shqipëri
Gurin kush s'mund t'ia luajë

FLIJIMET E LUMTURISË

Lufta ndodhi ne duruam
Dhunë krime e djegieje
Ndodhën vrasje i jetuam
Me kallje e pjekje

Këtu merr hisen historia
Me imtësi fakte nxjerr
Po edhe zë nga poezia
S'kemi gjë për të bjerrë

Varrezat ku n'qetësi të vrarit
Nuk ndryshojnë aspak
Po jehonat andejparit
Kujtojnë veç plagë e gjak

Koha legjendat mbyll
Ëndrra e shpresa mbaroi
Shekulli kapak me dyll
Jemi të lirë robëria shkoi

Këtu jetoni fjalët e qarta
Për varreza të paharruara
Historia jep medalje të arta
Medalje krejt të praruara

Në kujtime përvjetorësh fliten
Emrat e bëmat radhiten
Në përmendore qiellit ngriten
Emrat që sollën dritën

Në pritje në varreza me mik
I them "Lufta qe tragjike"
Po na solli me një dekik
Lirinë me dritë magjike

Simfoni dhembje e zi
Me krime të rënda plumb
Po kishte edhe poezi
Atdheu bën lum e lum

AJKUNAT QAJNË

Lufta mori fund e dimë
Po mori e treti botë
Vend njerëz copë e grimë
Ashtu si thyhet një gotë

Ku mbetën ata fëmijë
Ku mbetën pleq e plaka
Vajzat e djemtë e rinj
Të gjithë i përpiu flaka

Varre as shenjë s'u dihen
Përrenjtë lumenjtë e furrat
Me kufoma nuk ngihen
S'ndalen as lot si gurrat

Ajkunat qajnë shkulin flokë
Mallkojnë diell e hënë
Dhe i ulin yjtë në tokë
Si bën përherë një nënë

Bagerët rrëmojnë copa toke
Kërkojnë shenja e eshtra
Makinat bëjnë gjëmë oj loke
Gjëmë ndër lugje e kreshta

Erdhën vaje prej largësie
Shpirtrat e gjallë digjen
Dogji një hordhi ushtrie
Ajkunave lotët s'u hiqen

FIJET E HOLLUARA

Jetën e shikoj fije të holluara
Ndoshta si dru pa gjethe
Mjegull e malet e mbuluara
Botë që dergjet në ethe

Të kap shikimi këto çudira
Mendja fare s't'i do
E shpirti nëpër errësira
S'del fjalë as po as jo

Fijet e holluara dikur bukuri
Për këdo që rrit shtatin
Tash pa fuqi me mërzi
Të shtyn ta zësh shtratin

Shtratin pak sa nën shtrat
Të botës ku flihet gjatë

Tinëzisht hollohet jeta si hije
Dhe këputet tak si fije

KUR HUMB NË LARGËSI

Ti moj e mira moj
Të thërras - përgjigjesh "Oj"
Të përshkruaj si më mirë di
Flokëlëshuar mbi krah e gji

Duart lëviz si dy shpata
Trupin mbi bjeshkë të larta
Shkel në gishta e thembra
Fton veç sy e zemra

Lë prapa për sytë ëmbëlsi
Të shohë kur humb në largësi

U MËSOVA TË DASHUROJ

Shihja vajza me peshqir në kokë
Me xhaketë të kuqe e dimingushta
Diçka me shqetësonte, tërmet në tokë
Sikur të m'i binin gjoksit grushta

Ç'ishte kjo a ndien kështu dhe fshati
Apo mua po m'ikin mendtë
E sillen e sillen si akrepa sahati
Ikja tyret, se m'u trembën dhentë

Një lakmi kisha e çfarë nuk e di
Diçka lëvizte gjoksit më çonte te to



Vend kujtimi

Po kur qasesha e fryma strukej n'gji
As fjala e shterur s'më dilte jo

Me naivitet ëndërroja nën hije mollë
Derisa dëgjova të rriturit me përvojë
Për cicat e vajzave dhe belin e hollë
Njëri i kishte parë tjetri pasur në gojë

Blerimja një ditë ma mori dorën
E vuri në gjoks mbi gjinj
Pushoi së jetuari humbi orën
U frikova: m'vdiq n'gishtërinj

Kur bëri oh, oh, oh, unë qesha
Zjarri më dogji pa mëshirë
Dorën në shpinë ia ngjesha
Në bari u shtruam mirë

Mësova të dashuroj te mali
Ditët më çonin peshë
Me shpejt vetes lum djali
Të takohem me bareshë

Dikur gjërat me heshtje ngadalë
Besa sillnin rrezik
Më vonë në Shkollën Normale
U bëra tamam ashik

Mësova e mësova shumë dashuri
Mësova po ç'të bëj s'jam ngi



Dr. Migena ARLLATI

LETËRSIA SI SENDËRTIM I IDEALIT MË TË LARTË, LIRISË

Për shqiptarët e Republikës së Kosovës, lufta e vitit 1999 konsiderohet një plagë e pambyllur, një vuajtje që qëndron në popull brenda vetes si një lëkurë e dytë. Vuajtja është në ne. Dhe, sado që tani lufta është 25 vjet larg, një e vetmja fjalë e rrëfyer për atë kohë, na prek dhe bën të na dhembë sërish po aq shumë, sa ata muaj e vite kur kishte gjak, gjak, shumë gjak… deri në theqafjen e pushtuesve në fund të shekullit që shkoi.

Rrëfimet e panumërta të njerëzve në Kosovë, lidhur me ngjarjet tragjike të luftës dhe zhvillimet para saj, vazhdojnë edhe pas gati tri dekadave të shkaktojnë efekt tronditës. Plagët dhe dhembjet e popullatës, jo vetëm nuk janë mbyllur, por në vazhdimësi vënë re se faktet e shumta që detajizojnë ato kohë kanë nisur të ndërrojnë trajtë, dhe nga rrëfime personale apo kolektive, gjithmonë e më shumë po kthehen në lëndë artistike, si: në trajtën e subjekteve letrare, pjesëve teatrore, përmbajtjeve muzikore, paraqitjeve figurative etj.

Çmimi i lartë i lirisë

Veçanërisht në letërsi, autorët kanë sjellë rrëfime të shumta të shkruara për qëndresën, burgosjen, luftën, ankthin, dhimbjen dhe për lirinë e çmimin e lartë me të cilin u pagua ajo. Është ky tregimi për ne, shqiptarët e Kosovës, për përplasjet dramatike në vitet '90 (shek. XX), në gradacion rritës dhe shpërthyes në dy vjetët e fundit të dekadës ku gjithçkaja mori formë tragjike. Një tregim ku nga njëra anë, dashuria lind, ushqehet, përkëdhelet dhe çmohet me gjithë fuqinë e shpirtit, nga ana tjetër, shkelet, dëmtohet, gjakoset e vritet me gjithë potencialin dhunues e shtazarak që mund të përmbajë një shpirt (i ashtuquajtur) njerëzor.
Efekti i artit përgjithësisht, në këtë rast i letërsisë, është i tillë që të magnetizon dhe të bën të hidhesh nga një përjetim në tjetrin si në kolovajzat që lëkunden në ajër. Para syve të mendjes të vijnë dhjetëra e dhjetëra ngjarje të rënda të ndodhura në Kosovë, por edhe në zona të tjera ballkanike, ku u bënë krime nga serbët. Veçmas tronditëse vazhdon të jetë pandjeshmëria dhe ftohtësia me të cilën policët, ushtarët dhe paramilitarët shkelnin mbi jetët e njerëzve të pafajshëm duke hedhur mbi ta plumba e zjarr.
Nuk mund të hiqet nga sytë pamja nga një video e shfaqur para Gjykatës Penale Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, video e cila bashkë me një mal dokumentesh u paraqit si provë për krimet e serbëve në Bosnjë, Kosovë, Kroaci etj. Aty shihet njësiti serb "Skorpionët" duke pushkatuar gjashtë boshnjakë. Më i riu prej tyre ishte 16-vjeçari Azmir Alispahiq. Ushtari serb, para se ta vriste Azmirin, e pyeti:
"A ke bërë ende dashuri?"
"Jo", - i tha i riu.
"E, pra, nuk ke për të bërë kurrë!" - ia kthen krimineli serb dhe menjëherë korr me breshërinë e automatikut.
"Lufta është e keqja më e madhe", e ka titulluar Kris Hegdesi librin e tij. Ky titull sikur do të vulosë një aksiomë ndërtuar mbi përvoja të provuara e riprovuara me qindra e mijëra herë në shekuj në vende e popuj të ndryshëm.
Shembuj përkatës janë shqyrtuar në këto vepra:
***"Velloja e kryqëzuar"**, roman i autorit Prend Ndoja, 2024.*
***"Gjuha e gjakut"** e autorit Enver Mulliqi, 2019.*
***Romani "Japonezi"** i autorit Sabit Gashi, 2018.*
***"Agim i një jete pa perëndim",** vëllim i autores Zarije Zenuni Bajrami, kushtuar heroit të lirisë së Kosovës, Agim Bajrami, 2017.*

Odisejada e pushtimit dhe liria

Në arte, në letërsi në veçanti, ne vërejmë një aktualizim tematik të shpeshtë të luftës, të qëllimeve dhe të pasojave të saj. Ishin kohë të vrullshme e me plot ndodhi kolektive ato të dy dekadave të fundit të paraluftës dhe të luftës në Kosovë, kohë në të cilat aktet dhe sakrificat personale e kolektive renditeshin njëra pas tjetrës dhe, për fat të keq, fatet e njerëzve gëlltiteshin nga makineria torturuese, vrasëse, shfarosëse e pushtetit serb. Nuk ka familje shqiptare në Kosovë që të mos ketë përjetuar ngjarje në të cilat janë atakuar drejtpërdrerjt ndonjë a disa nga familjarët e saj, sikurse shumë të tjera ku është përfshirë mbarë familja. Nuk ka familje shqiptare në Kosovë që të mos ketë në historikun e saj peripeci përndjekjesh, keqtrajtimesh a burgosjesh, e deri në odisejada të vërteta nëpër të cilat kanë kaluar jo lehtë, e nga të cilat me shumë fat kanë mundur të shpëtojnë gjallë, ndërsa plot të tjerë e kanë paguar me jetën e tyre.
Në këtë kuadër, historitë e letrarizuara nga autorët e shumtë përbëjnë një fragment të rëndësishëm që përfshihet në historinë e madhe të popullit shqiptar të Kosovës në rrugën e idealit për liri. Doemos, fati i individit, fati i familjes shqiptare, fati i misionarëve fetarë, ishte determinues në arritjen e qëllimit final: daljes nga robëria dhe gëzimit të lirisë, e cila u pagua vërtet shtrenjtë. Kthehet gati në profetik përcaktimi dhe iniciativa e njerëzve të cilët fatin individual e shkrinë në favor të arritjes së misionit kolektiv. Ndaj, vepra të tilla vijnë si sendërtim i qëllimeve të larta për daljen nga pushtimi i gjatë kolonial dhe arritjen e qëllimeve të mëdha qoftë duke u përgjakur, qoftë duke shkuar nga kjo jetë, vetëm e vetëm që kauza të realizohet si qëllim dhe plotësim i idealit më të lartë, lirisë.

Botime

NJË VEPËR ME PESHË TË MADHE STUDIMORE PËR EPOSIN E KRESHNIKËVE

Zymer Ujkan Neziri, "Studime të folklorit V, Gjurmë të Eposit të Kreshnikëve në Ballkan: Kërkime në fondet arkivore të Harvardit dhe në disa vise të Ballkanit", Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2023.



Prof. dr. Zymer Neziri

Vëllimi Studime për folklorin, V, Gjurmime të Eposit të Kreshnikëve në Ballkan: Kërkime në fonde arkivore të Harvardit dhe në disa vise të Ballkanit, është rezultat i një pune shumë serioze të profesor Zymer Ujkan Nezirit. Ky libër paraqet vijimësinë e përpjekjeve të tij të pesta që Eposi i Kreshnikëve të ndriçohet sa më mirë dhe të popullarizohet sa më shumë në qarqet albanologjike, sidomos në epikologjinë shqiptare. Ndahet në tri pjesë: Eposi i Kreshnikëve në fonde arkivore të Universitetit të Harvardit (2002-2020); Rezultate të punës kërkimore në Ballkan për Eposin e Kreshnikëve (2012-2020); Portrete rapsodësh të njohur të Rrafshit të Dukagjinit.


Në pjesën e parë vlerësohet Koleksioni i Millmen Perit në Harvard, ku autori kreu kërkime shkencore pasdoktorale, sepse është kryevepër arkivore e Ballkanit dhe ndër kryeveprat arkivore botërore. Prijnë katër punime për Eposin e Kreshnikëve në krahinat: Sanxhaku i Pazarit të Ri, Plava e Gucia, Rugova, Mërturi. Në pjesën e dytë autori paraqet rezultatet e punës së tij kërkimore në Ballkan për Eposin e Kre¬sh¬nikëve, në vitet 2012-2020. Shkruan për krahinat e Eposit: Kraja, Malësia e Madhe, Llapusha, Drenica, Gostivari, Kërçova, nga përpjekja e tij shumë e gjatë kërkimore, me rreth 300 ditë punë terreni në pesë shtete të Ballkanit.

Unë, autori i shkrimit, isha pjesëtar për Kosovën Lindore i këtij projekti tejet të madh kombëtar dhe kontinental, me 15 vëllime të mbledhura e të incizuara dhe fitues i çmimit evropian ("Europa Nostra, Madrid", 2016).

Në pjesën tretë, prof. dr. Zymer Neziri, tash edhe akademik i Akademisë së Shkencave të Evropës, Academia Europaea, flet për dy rapsodë të njohur të Rrafshit të Dukagjinit, Halil Beka dhe Bajrush Doda. Punimet në libër janë renditur sipas kronologjisë gjeografike dhe kanë bibliografi dhe rezyme në gjuhën angleze. Vepra është hartuar sipas kritereve të larta tekniko-shkencore. Me këtë rast po shtoj se recensues i këtij libri shumë të rëndësishëm për epikologjinë shqiptare, ku janë vlerësues studiuesit prof. dr. Nikolla Skalldaferi, prof. dr. Nebi Bardhoshi, prof. dr. Izaim Murtezani, dr. sc. Mikaela Minga dhe autori i këtij shkrimi.

Në fund, duhet thënë se prof. dr. Zymer U. Neziri, ndër epikologët e rrallë ndër ne e në rajon, tashmë i njohur edhe në qarqet ndërkombëtare, aktualizon edhe projektin e hershëm të tij, të vitit 2008, në Institutin Albanologjik të Prishtinës, që Eposi i Kreshnikëve të renditet në Listën e UNESKO-s.

Prof. Asoc. Dr. Albin SADIKU





Prof. Dr. Adem ZEJNULLAHU

SHQIPTARËT NË LIGJËRIMIN POETIK
TË ULMAR KVIKUT

Sipas traditës etnokulturore shqiptare ta duash veten, shoqërinë dhe kombin tënd është obligim individual e i përbashkët gjatë historisë. Ky virtyt i lartë njerëzor e kombëtar është trashëguar e përcjellë brez pas brezi deri në kohën e sotme. Por, ta duash, ta mbrosh, të kujdesesh e të kontribuosh për të mirën e një populli tjetër, me të cilin nuk të lidhë gjaku, as gjuha, përpos ndjenjës së humanizmit gjithënjerëzor, është nder, madhështi e pavdekësi për individin apo për një bashkësi njerëzore në rruzullin tokësor. Sipas ligjit të natyrës, çdo krijesë njerëzore e ka të drejtën e saj – të jetojë e lirë dhe të veprojë sipas rregullave natyrore dhe të përcaktuara me kodin moral shoqëror e gjithënjerëzor, ndaj ai që robëron tjetrin është vetë i robëruar.



Ulmar Kvik

Qëmoti është thënë e është shkruar se historia është mësuese e jetës dhe e njerëzimit. Ndaj, po të vështrohet fjalia e sipërthënë nga konteksti përmbajtjesor, i brendshëm e i jashtëm, del në pah e dhëna tashmë e dëshmuar në shekuj, se edhe popujt e vegjël kanë vlera të veçanta, të çmuara, madje të shumta, që nuk i hasim te popujt më të mëdhenj. Por këto vlera i vërejtën vetëm ata që kishin vlerë në popujt e tyre.

E kaluara historike ndaj popullit shqiptar, etnik në tokat e veta, ishte e padrejtë, dorështrënguar e nuk i dhuroi atë që e meritoi, krahas popujve të tjerë të botës, ndaj me shekuj shqiptarët bënë përpjekje, qëndresë, luftë dhe sakrificë sublime për të mbijetuar. Në këtë kontekst jetësor e historik do theksuar se shqiptarët, në ecjen e tyre nëpër tym e erë baruti, asnjëherë nuk u përkulën para kundërshtarëve, por ecën vertikalisht, dhembshëm, tragjikisht dhe triumfalisht drejt lirisë, pavarësisë dhe vlerave më të larta kombëtare e gjithë njerëzore. Të ardhmen më të lumtur dhe më të suksesshme ata gjithmonë e patën synim, pa të keqen e të tjerëve. Këto vlera të larta njerëzore të huajt, studiuesit e fushave të ndryshme, me kohë i hetuan dhe i gjurmuan, ndaj u morën me rrënjën tonë në këto hapësira ballkanike. Shumë prej tyre ia kushtuan një pjesë të jetës, por ka edhe të tillë që gjatë tërë jetës u morën me çështjen dhe problematikën shqiptare - me gjuhën, traditën, kulturën dhe me historinë, siç janë: Thunmani, Pederseni, Robert Elsi, Malkolmi, Shmiti, Hahni, Viliam Liku, Edit Durhami, Milan Shuflaji, Gustav Majeri, Nobert Jokli, e sidomos Ulmar Kviku, i cili një jetë të tërë ia kushtoi popullit shqiptar, duke hulumtuar e duke trajtuar gjenezën, gjuhën, traditën, etnokulturën, krijimtarinë shpirtërore gojore dhe letërsinë e kultivuar. Ai, më mirë dhe më bindshëm se të gjithë të tjerët, e dëshmoi, e hartoi dhe e trajtoi gjeografinë e identitetit të popullit shqiptar nëpër periudha të ndryshme jetësore e historike.

Një jetë kushtuar popullit shqiptar


Për Ulmar Kvikun dhe veprimtarinë e tij shumëdimensionale ndaj shqiptarëve, me rastin e 91-vjetorit të tij të lindjes, Fetah Bahtiri, njëri ndër njohësit dhe miku më i mirë i tij, i botoi dhe përmbledhjen 91 År/Vjet // 91 Dikter/ Poezi në gjuhën suedeze, të cilën më pas edhe e shqipëroi. Do theksuar se këto 91 poezi, numër mitik, në rrafshin simbolik nënkuptojnë jetëgjatësinë dhe veprimtarinë e tij gjuhësore, kulturore, historike, politike dhe diplomatike kushtuar popullit tonë, që e deshi dhe e do me tërë qenien e tij shpirtërore dhe krijuese.

Ulmar Kviku, ambasador i kulturës shqiptare në Suedi, në disa dokumentarë e intervista të ndryshme e shpërfaqi përkushtimin e tij, çka do të thotë se ai me kohë e kishte formuar një kod të pathyeshëm të dashurisë, të përkushtimit, të miqësisë dhe të përjetësimit të dy popujve gjeografikisht të largët, me gjithë të veçantat dhe të përbashkëtat, por ndjeshmërisht shumë të afërt dhe të përzemërt. Ai, më mirë se çdokush tjetër, e kuptoi identitetin shqiptar, fatin e tij, rënien e ngritjen e tij në përballje me historinë, qëndrueshmërinë, luftën, sakrificën sublime për liri e shtetformim, por edhe

dashurinë e tij ndaj rrënjës, ndaj gjuhës shqipe, traditës kulturore, tokës e qiellit shqiptar, që shumë herë u rrezikua nga të tjerët, më të fuqishëm e të përkëdhelur nga të mëdhenjtë. Të gjitha këto dritëhije vuajtjesh, qëndresash, luftërash e sakrificash të popullit tonë, në përballje shekullore me kundërshtarët e ndryshëm, Ulmari i artikuloi bukur në këto vargje poetike: Romakë, vandalë dhe kryqtarë, / turq, serbë dhe malazez, / italianë dhe gjermanë, / të gjithë janë vërsulur këndej. (Q. Kryeziu)

Ulmar Kviku, për tërë këtë reliev dhembjesh, tragjedish e krenarish të shqiptarëve, është frymëzuar nga balada e njohur Rozafa në Shkodër, çka do të thotë se ky erudit i madh e njihte shumë mirë edhe krijimtarinë gojore të kombit tonë, sidomos zhanrin e baladës, si kryevlerë e artit popullor. Rrugëtimin historik të shqiptarëve ai e paraqet në mënyrë simbolike dhe sintetizuese me anë të këtyre vargjeve kuptimplota: Të jesh i vogël, por të qëndrosh i fortë / do të thotë sakrificë dhe humbje. / Kështu është ndërtuar fati shqiptar / me gurët e rëndë të historisë. ("Kalaja në Shkodër")

Po të vështrohet me kujdes krijimtaria poetike e Ulmar Kvikut, pothuajse në shumicën e saj, ky poet është identifikuar tërësisht me fatin e popullit shqiptar. Ai është i vetëdijshëm se shqiptarët gjatë rrugëtimit të tyre jetësor e historik kaluan nëpër shumë mugëtira të kohëve pa mbarim, pa diell, të cilat u sollën dhembje e tragjedi të vogla e të mëdha, individuale, shoqërore e kombëtare, por të cilat, sipas Ulmarit, i përballuan dhe i mbizotëruan stoikisht, duke ecur vertikalisht dhe krenarisht drejt fatit të tyre. Shqiptarët shumë herë u dogjën dhe u rilindën, si zogu i diellit – feniksi. Ata, edhe në kohë e mot pa diell "fidanëve të tyre, u japin emra shpresëdhënës" për të nesërmen e ëndërruar, të projektuar në vizionin e tyre të lumtur e mendjendritur. Të keqen që errësoi qiellin shqiptar, poeti, kohë pas kohe, e konsideron si diç të përkohshme, që vjen e shkon, merr me vete atë që i takon, mynxyrën, dhe të nesërmen lind ditë e re me diell, përplot shpresë, që shëron e lumturon: Sot lindi dielli i ri, / po zhduket koha barbare, / koha e zezë. / Liridona zgjedh profesionin e vet / dhe djalin që ia do zemra... ("Fatet shqiptare")



Për poezinë e Ulmar Kvikut

Në përmbledhjen me 91 poezi të Ulmar Kvikut një numër të konsiderueshëm të tyre i shquan ligjërimi soditës, meditativ, me theksin nostalgjik të poetit për të kaluarën, të sotmen, shpresën, për të madhërishmen, të pavdekshmen si qëllim kryesor i subjektit lirik. Ai shpreh ndjesi për fenomenet dhe dukuritë e ndryshme natyrore e njerëzore. Për bukurinë dhe shëmtinë si kategori estetike, për dritëhijet që vijnë e ikin, duke lënë pas vetes mbresa, kujtime, dashuri, dhembje e nostalgji. Kështu, poeti e koncepton dhe artizon të kaluarën, të bukurën, të ëndërruarën, lulet, pranverën, gjelbërimin, por edhe të pabërën, si synim për ta përballur me vështirësitë që sjell koha, jeta e shoqëria. Pra, dashuria, ndarja, takimi, nostalgjia, fatkeqësia njerëzore, gradualisht në vargjet e këtij poeti suedez vijnë e artikulohen rrjedhshëm në mesazhe e imazhe të mirëfillta përmbajtjesore dhe artistike, duke u bërë pjesë e qenies, të ndjenjës e të kujtesës, të shprehjes me ngjyrim meditativ e filozofik.

Kujtimi për të shkuarën, djalërinë e miqësinë me të dashurit, me të gjitha nuancat joshëse dhe irrituese si "trëndafil me gjemba" në qenien dhe në frymëzimet e poetit, janë një baladë e fshehur me shtresa e nënshtresa të ndryshme, të cilat me kalimin e kohës shpupurishen dhe marrin trajtën e ligjërimit elokuent, duke e bërë subjektin lirik herë-herë të gazmuar e herë-herë edhe melankolik: Zëri i brendshëm më tregon: / Sa je i gjallë ke dashurinë, / Sa je i gjallë ke bukurinë, / Sa je i gjallë ke mirësinë, / Sa je gjallë ke mëshirën... / Dhe vdekje nuk ka, / Jeta përtërihet në formën të re. ("Duke mohuar vdekjen")

Rrugëtimi jetësor i njeriut në këtë botë, sipas Ulmar Kvikut, është një proces dialektik që ka fillin dhe mbari-

min, por që sipas tij çdo fund e ka dhe një fillim të ri që ngashënjen e premton, ndaj në këtë udhëtim ka madhështi, pavdekësi në çdo gjë që është e bukur, e dashur, e përjetshme, e dobishme për njerëzimin, që shprehet bukur në fjalë e në art.

Natyrisht, njeriu s'e pranon vdekjen - dëshiron të jetojë, të arrijë atë që s'e ka arritur dot, por koha është e pamëshirshme - kalon dhe nuk kthehet, merr me vete të mirën dhe të keqen, ngazëllimin dhe hidhërimin, të bukurën dhe të shëmtuarën. Rëndom poetët e sfidojnë vdekjen me frymëzimet dhe ligjërimet e tyre poetike, secili në mënyrën e vet. Ata, gjatë dhe pas jetës, me fjalën e bukur, me elokuencë pavdekësojnë veten dhe të tjerët, duke lënë vepra që u shërbejnë breznive, artit dhe shkencës. Në mesin e këtyre poetëve të shquar një vend të veçantë zë dhe Ulmar Kviku, i cili, me veprimtari-



në e tij të përgjithshme jetësore e shkrimore, me fjalën e bukur poetike, me mesazhin dhe imazhin për të madhërishmen, ngriti një përmendore kujtese të çmuar e të respektuar; me vargjet e tij të rrjedhshme, që i largojnë aktet e ulëta e të këqija të subjekteve të ndryshme, duke i madhëruar të gjithë ata që bëjnë dhe lënë pas vetes vepra të mira, që ua lartësojnë dhe nderojnë emrin; duke e pavdekësuar të bukurën, të dashurën, të njerëzishmen në jetë dhe në art, me të cilat ata që vijnë pas shërojnë plagë e gazmojnë zemra në kohë pa fund.

Edhe në moshë të shtyrë ai e do jetën, i do njerëzit, dashuron lulet, lumin, diellin e gjelbërimin, ndaj me një qëndrim stoik, mendjendritur e frymëzim elegant i sfidon hijet që duan ta rrëmbejnë. Ballafaqimin e tij me të papriturat, me të padëshiruarat, me hijet që i sillen vërdallë, ai klith në vargje, që i shquan toni krenar dhe melankolik:

Dielli më tregon se rrezet e tij i kam vetëm si hua / Lulet më tregojnë se bukuria e tyre është e përkohshme / Dhe si lulet është edhe jeta ime, diçka kalimtare / Ende jam në diell, ende po shëtis në mes të gjelbërimit / Por hijet, hijet bëhen si gishta që duan të më kapin / Për të më futur në dhe... ("Ulmar Qvick 91 Ar/Vjet 91 Dikter", poezi, fq. 18)


Ulmar Kviku dashurinë, respektin dhe adhurimin e patundur ndaj shqiptarëve e shfaqi botërisht nëpër të gjitha fazat e jetës dhe të veprimtarisë së tij. Në mënyrë të veçantë ai i dha zë rrënjës, lashtësisë së shqiptarëve në hapësirat ballkanike, zhvillimit dhe qytetërimit të tij në të gjitha fushat e jetës, të historisë, të traditës etnokulturore e gjuhësore, krahas popujve më të qytetëruar të botës. Të tëra këto Ulmari i shpreh me anën e këtyre vargje të rrjedhshme dhe kuptimplota: Fatet e shqiptare në ditët tona të paqes / Le të bëhen si diell që ndriçon mbi fushat tona të lumtura! / Le të bëhet si shiu i butë, që po presin bimët; / le t'i japin forcë dhe nam emrit shqiptar nëpër botë! (Fetah Bahtiri, "Ulmar Qvik, 91 Ar/Vjet//91 Dikter", poezi, fq. 11).

Një përmendore artistike e ambasadorit të kulturës shqiptare

Poezia e Ulmar Kvikut është dëshmi e një bote të pasur ideore dhe emocionale, e cila me ligjërimin poetik është e veçantë, elokuente, si në aspektin e procedimit krijues, ashtu dhe të artikulimit dhe të realizimit artistik e estetik. Kjo përmbledhje me 91 poezi, me tematikën dhe motivet që trajton, në fushën e poezisë sonë, por edhe më gjerë, pa dyshim, zë një vend të veçantë si vlerë, ndaj botimi i saj, në rrafshin kuptimor, artistik e shkencor, mund të konsiderohet si një përmendore artistike e këtij poeti, e ngritur me rastin e 91-vjetorit të lindjes së tij si ambasador i kulturës shqiptare.

Duhet thënë se Ulmar Kviku, në veprimtarinë e tij krijuese, u ndie, mendoi e shkroi përherë sikur të ishte shqiptar, ndaj më mirë se çdokush tjetër nga Evropa e bota, që u morën me çështjen dhe problemet e shqiptarëve, ai e njohu në gjerësi dhe thellësi popullin tonë, ndaj në angazhimet e tij - me fjalë e me shkrim - ua çjerri maskën dashakëqijve, intrigantëve, gënjeshtarëve e mitizuesve, që me shekuj thurnin dhe vepronin kundër nesh.

Në vazhdimësi do të ndërrohen stinët, motet, brezat, do të fryjnë erëra kahesh të ndryshme, por në mendje, art e kujtesë, kurrë nuk do ta fshijnë emrin e mikut të madh të shqiptarëve - Ulmar Kvik, i cili tërë potencialin e tij jetësor, mendor, ideor, diplomatik, gjuhësor, artistik e njerëzor e vuri në shërbim të kombit shqiptar, duke u bërë pjesë e tij, zë i fuqishëm në kohë e hapësirë të caktuar jetësore e historike në shtetet skandinave, në Evropë dhe në botë. Shqiptarët, në saje të këtij eruditi të madh, veçmas me paraqitjet e tij bëri për të mos u harruar asnjëherë si njeri, krijues dhe mirënjohës i popullit tonë.



Muharrem ELEZI

TRADHTIA
(Tregim)

Ishte një pasdite e muajit shkurt, kur më thirrën me ngut në një tubim elektoral që po mbahej në sallën e restorantit "Astoria". Porsa hyra në sallë, vura re se aty afër meje ishte edhe njëzetedyvjeçarja, e cila disa javë më parë kishte kërkuar një këshillë nga unë. Dukej e dëshpëruar, sytë e saj ishin të skuqur, madje dukej mjaft e dobësuar, në krahasim me herën e fundit që e kisha takuar. Ndërsa po afrohesha, ajo më shikoi për një çast dhe në atë shikim ishte një ndjenjë që përshkruhej më mirë nga heshtja e dhimbshme sesa me fjalë. Sytë e saj, që dukej sikur po kërkonin shpëtim, e tradhtonin gjendjen shpirtërore të saj.

Në atë çast, ndjeva një lloj tensioni që mbulonte gjithë sallën. Ata që ishin aty, pa dyshim, po përpiqeshin të qëndronin në tokë, ngase i kishte kapur euforia e turmës që bërtisnin sa mundnin për liderin e partisë sonë, por unë nuk mund të shmangia idenë se ndodhesha në një skenë më të madhe, ku politika dhe jeta personale po shpërndaheshin si dy rrjedha të kundërta. Teksa e shikoja, u përhumba në historinë që ma kishte treguar atë ditë, një histori që më ngjante me ato të serive latino-amerikane. Ajo atë ditë më pat thënë: "Bashkë me fqinjën time po udhëtonim drejt Prishtinës. Derisa prisnim autobusin, befas, para këmbëve tona, u ndal një veturë. Në atë çast, e dallova menjëherë, ishte ai. Kishte kaluar kohë e gjatë që më vardisej. Ndërsa vetura qëndronte aty përpara, një heshtje e çuditshme më mbërtheu. Fqinja ime, pa asnjë ngurrim, hapi derën dhe u fut brenda. Unë, për një çast, mbeta e ngurtësuar. Një ndjenjë e pazakontë më shtrëngoi brenda. Një zë i brendshëm më thoshte të hezitoja, po vetë shoqja ime, e pavëmendshme ndaj shqetësimeve të mia, tashmë ishte brenda, edhe unë si pa menduar, iu bashkova.

Vetura lëvizi ngadalë, dhe ashtu siç e ndieja, ishte një shteg pa kthim. Pavarësisht që isha pranë shoqes, diçka e çuditshme më mbërthente, një trishtim i papritur po më kalonte nëpër trup. Përpara nesh, rruga shtrihej e shkrirë me dimrin e acartë, ashtu siç shkrihej edhe heshtja mes nesh, që mezi po mbaja frymën. Ai fliste pak, por nuk kishte nevojë për fjalë. E dija se në çdo fjalë të tij kishte një qëllim që ta kuptoja plotësisht. Ndërsa shoqja ime, ashtu si gjithmonë, ishte e qetë, e shkujdesur, duke shikuar përtej dritareve.

U gjenda në një situatë të pavolitshme. Ishte dita më e mallkuar e jetës sime dhe vetura, ku nisi fati im i keq, që tani po më drobiste shpirtin dhe nervat. Është e çuditshme se si ngjarjet në jetë nganjëherë ndodhin aty për aty nga rrethanat e krijuara dhe më pas habitemi se pse ndodhi pikërisht ashtu, si në ndonjë skenar. Edhe ditët në vijim ai nuk po më linte rehat. Fjalët e tij ishin të fuqishme dhe dalëngadalë fillova të ndikohesha, pas një kohe fillova edhe unë të ndieja diçka për të. Vala e dashurisë u transmetua edhe te unë, po u mëshonte telave të instrumentit që më pëlqenin edhe mua. Më në fund, u bëra e tij. Çdo javë shfrynte epshin e tij dhe për mua secila përvojë tjetër ishte përsëritje e asaj të parës.

Nuk kaluan as dy muaj, kur një natë mbetëm në shtëpi vetëm unë dhe motra ime, ajo nisi të më tregonte për lidhjen e saj me të njëjtin djalë. Nuk po e dija kokën ku e kisha, isha duke i larë filxhanët e kafeve, sytë m'u errësuan, nuk shija gjë, këmbët më lëshuan dhe rashë në dysheme. Kur erdha në vete, e pashë motrën mbi kokë e cila më pyeti: "Ç'pate, oj e marrë?"

Atë natë kokërr gjumi nuk futa në sy. Në ato fjalë, ndjeva një barrë të rëndë që më rëndonte në gjoks. E kuptova që isha e humbur në një botë që nuk kishte vend për mua. Ishte si një copëz e humbur e një historie që kishte mbaruar dhe që pas një periudhe të gjatë harrese, rikthehej me një shije të hidhur. I dashuri im qenka edhe i dashuri i motrës sime. A mund të shikoja në sy atë bir bushtre? E pyeta veten. Por pas një reflektimi, brenda pak ditësh vendosa të ndahesha prej tij.

Një ditë, pas një vizite në Prishtinë, po kthehesha në shtëpi. Autobusi që më kishte sjellë, ndaloi afër stadiumit. Rruga ishte e qetë, por ndoshta ishte kjo natyra e errësuar që të bën të ndihesh më i pranueshëm ndaj gjithçkaje që mund të ndodhte aty. Po ecja drejt shtëpisë, kur papritmas diçka më tërhoqi vëmendjen. Matanë murit, aty ku zakonisht nuk e shihje njeri, dukeshin si në mjegull dy silueta. Ishte një çast i çuditshëm, një ndjenjë e paqartë që më pushtoi. Fillova të afrohesha për të parë më qartë. Ata po bënin dashuri. Duket sikur gjithçka u ngrit për një çast dhe mbrapa të dyve u shfaq një zë, një zë që më ishte i njohur, një zë që i përkiste dikujt që kishte pasur një vend të veçantë në jetën time. Një ndjenjë paniku më përshkoi trupin. O zot, ky ishte veprim i marrë dhe i shëmtuar, thashë me vete. Çfarë duhej të bëja tani? A mund të njoftoja motrën time për këtë? Jo, nuk bën, thashë me vete dhe nuk i tregova gjë, ndërsa ai vazhdonte ta tradhtonte motrën time, jo vetëm me një, por edhe me disa femra të tjera. Unë nuk bënte t'ia thosha, frikësohesha se do të më keqkuptonte motra.

Ajo atëherë më pat pyetur se çfarë të bënte? Ndërsa unë i pata thënë: "Dëgjoje zemrën."

Kur përfundoi tubimi elektoral dhe u shpërnda turma, interesimi për fatin e saj, si një hije, më ndiqte gjatë gjithë kohës. Fillova të gjurmoja te disa të njohur dhe pas pak kohësh, një zë më tregoi atë që nuk do të doja ta dija. Motra e saj mbahej në burg për një krim të tmerrshëm. Kishte vrarë njeriun që, me padrejtësi të tmerrshme, i kishte shtypur dy motrat, duke u bërë shkak që jeta e tyre të kalonte në një ferr të panjohur.



Lutfi DERVISHI

KOHËS JEPI SHPIRT

VALA E VETMUAR

Vala
Në thellësi zhurmon
Ecën ngadalë
Përpëliten të panjohurat
Loja sa fillon
Askush s'e di ku dhe si
Nuk e di as ti
Gjëma e detit oshtin para agut
Dhe zbrazet
Neve si melodi na vjen
Qetësi mbi det qetësi
Vala s'e ndalon hapin
E vetmuar vala

JEPI SHPIRT

Jepi shpirt vetes
Të dashurosh
Të jetosh i lumtur
Kohës jepi shpirt
Të jetosh për vete
Jepi shpirt
Shpirtit i bën mirë
Shpirtit të këngës
Jepi shpirt

APOKALIPS

Dje
Ditët u bënë net të gjata
Për jetën
Krimbat
Ç'na i sollën të tjerët
Ishte postulati ynë i pamohueshëm
Ata
Na i dëmtuan lulet i copëtuan
kopshtet e bukura
Ata krimba
Shkatërruan ëndrrat tona
Ngjyrat e ylberit
Copëtuan qiellin
Ata
Krimba

Sot
Në agimin e vakët të shtatorit
Pashë krimbin në sytë e mi
Në zemrën e vëllait tim
Në shpirtin e maleve
Pashë krimbin e leshtë si në përrallë
Eh
Ç'më kujtohet fjala e gjyshit
"Krimbat ishin dhe janë në shpirtin tonë
në zemrat tona askush s'na i solli"
Sot u binda kur pashë me sytë e mi
Krimbin në zemër të vëllait tim
Në zemrën e lulëkuqeve
Mashtrimi me ujin imagjinar
Që s'u duk asnjëherë në arat tona
Në kopshtet tona
Sa herë kemi ngrënë ardhmërinë e lulëkuqeve

UJI FLET ME VALË

Fillim i jetës
Origjina e gjallesës
Etja
Uji
Pushim i shpirtit zgjimi i kujtesës
Burim frymëzimi herët para agut
Uji
Uji flet me valë pa u ndalur
Uji

NËNË


Të tërin më solle të lagur
Para agimit pa dritë
E dite ishe duke pritur
Buzëqeshe
Kur klitha unë në kashtën e lagur
Nga djersa jote
Nënë
Ti e patrembur nga dhembjet
Netët e gjata pa gjumë

Ike e heshtur si hije
Nënë
Ti je me mua kudo
Në jetën time
E heshtur e bukur e pazëvendësueshme

Unë
Të fala për ikje
Po pse hesht kur vij te varri yt
Të dhimbsem për lulet që t'i solla
Pse nuk më flet Nënë
Ti ishe lulja ime vetë
Ah ç'më djeg malli
Nënë për Ty

NATA S'VJEN KURRË

Qiell i kaltër mbi det
Sa largësi në mes
Qiell
Det
Pasqyrë
Peshku kollitet nën ujë
Bujë i bën vala lozonjare
Vala
Nata kurrë s'vjen
Dita s'i bën vend
Dita
Njeriu si nata e gjatë
I bën hile natyrës
Bën mëkat
Njeriu



Ura e Fshejtë



Zija ÇELA

ME DORËN E DJALLIT NË FYT…
(Nuk të mbytë, por t'verbon sytë.)

E pra herët e kam thënë, Djalli e merr përsipër atë që bën, sepse e ka të shpallur qëllimin njëherë e përgjithmonë. Kur hyn në marrëdhënie me njeriun, hyn me bonus të gatshëm: "Ti bëje këtë, se unë të jap atë!" Dhe gjen pikën më të dobët. Në një çast të caktuar, njeriu ndien t'i zuzullojnë vshët, pastaj sikur dëgjon një zë të mistershëm, që ia bën sedrën fërtele: "Ama, po habitem me ty! Nuk të kisha ditur kaq sedërli, kaq mendjengushtë, kaq moralist, kaq frikacak e qullac pa cak! E kujt i hyn në punë sot ndershmëria?! Vetëm atyre që janë qorra e kaqola. Pa më thuaj tani, si duron që…"
Është Djalli, ky kodosh i përbotshëm, që t'i zbraz në tru ngashënjimet e tij. Dhe për të qenë objektiv, ai di ta joshë edhe arsyen e shëndoshë. Sepse, në pamje të parë, të rren mendja se zgjedhje të tilla kleringu, më jep - të jap, janë dukshëm me përfitim.
Por në të njejtin çast ekziston një zgjedhje tjetër, duke pyetur veten: "Çfarë është ajo që Djalli ma jepka me kusht dhe Zoti nuk ma jepka falas?"
Djalli vërtet është kozmik, por Njeriu është racional, krijesë me mundesinë për të qenë superior ndaj Satanait. Prandaj njeriu nuk ka përse të ankohet aq shpesh me vonesë: "Boboo, çfarë bëra!", dhe të mos frenohet në kohën e duhur, duke shkundur veten me logjikën: "Përse, përse ta bëj?!"
Për t'i paradalë këtij "bonusi", që ta bën shpirtin pleh, Zoti nuk lë boshllëk. Boshllëkun që gjen Djalli, e krijon vetë njeriu me zgjedhjet e tij të gabuara.





Dr. Mujë BUÇPAPAJ

NJË NDIHMESË LETRARE ESTETIKE ME PESHË NË DISKURSIN POETIK

Në kontekstin e letërsisë shqipe bashkëkohore, botimi nga "Nacionali" i vëllimit poetik "Lutje në kohën e Sizifit" të Jaho Margjekës paraqet një ngjarje të mirëfilltë letrare estetike dhe një kontribut me peshë në diskursin liriko-reflektiv të poezisë shqiptare të dekadave të fundit. Margjeka, i pajisur me një intuitë të veçantë poetike dhe një ndjeshmëri përmasash ekzistenciale, na ofron në këtë përzgjedhje antologjike një panoramë të qartë të evolucionit të tij stilistik dhe tematik, duke e bërë zërin e tij poetik të identifikueshëm dhe të dallueshëm në peizazhin letrar kombëtar. Ky vëllim bart vlera të shumëfishta – poetike, kulturore dhe gjuhësore. Struktura e tij e brendshme e ndarë në cikle konceptuale më tepër sesa tematike, dhe qasja estetike e reflektuar në një poezi të përkorë, të kondensuar dhe semantikisht të ngarkuar, dëshmojnë për një autor që zotëron mjeshtërinë e masës, të ritmit dhe të përmbajtjes. Poezia e Margjekës nuk është vetëm përjetim emocional, por dhe një përsiatje filozofike për qenien, për kohën, për dashurinë dhe për mungesën. Ajo lëviz me siguri ndërmjet frymës baladike dhe tensionit bashkëkohor, ndërmjet mitit dhe realitetit, duke krijuar një univers të veçantë poetik që i flet njëherazi lexuesit të zakonshëm dhe studiuesit të përkushtuar.

Një univers mbi shtyllat e reflektimit filozofik

Vëllimi poetik "Lutje në kohën e Sizifit" nuk është thjesht një përmbledhje vargjesh, por një univers i organizuar mbi shtyllat e reflektimit filozofik, të pasurisë shpirtërore dhe të simbolikës mitike. Vëllimi "Lutje në kohën e Sizifit" i poetit Jaho Margjeka është një akt poetik i thellë, që ndërthur frymën tradicionale ballkanike me përmasat universale të përjetimit njerëzor. Autori i shndërron motivet klasike të mitologjisë, si figura e Sizifit, në simbole moderne të njeriut që kërkon shpëtim në mes të absurdit. Kjo përforcohet nga ndërtimi ciklik i përzgjedhjes poetike, ku çdo poezi është si një hallkë që lidh përvojën individuale me kujtesën kolektive. Pra, simbolika e Sizifit, e vendosur që në titull si shenjë e një tensioni metafizik e moral, shndërrohet në një shtyllë të narrativës poetike – ku poeti nuk është thjesht një bartës i gurit të vet, por një vëzhgues i thellë i trajektores së njeriut modern, që lutet jo vetëm për të shpëtuar, por për të kuptuar. Në një kohë ku poezia shpesh rrezikon të bëhet sipërfaqësore ose e ndikuar nga estetikat e konsumit kulturor, Jaho Margjeka mbetet i palëkundur në kërkimin e fjalës me peshë semantike dhe shpirtërore. Ai e njeh fuqinë e fjalës poetike si mjet për të shprehur të pathënën, për të bartur të pashprehurën dhe për të shpëtuar nga harresa gjithçka që i përket thelbit njerëzor.

Vetëdije e thellë krijuese dhe etike

Në poezinë e Margjekës, e përftuar me një mjeshtëri të natyrshme gjuhësore dhe një ndjeshmëri të lartë estetike, lexuesi has ballafaqimin me përjetimet më të thella të njeriut bashkëkohor – nga humbjet intime deri te pasiguritë kolektive, nga dashuria deri te vetmia e përhershme e qenies që vuan peshën e vetvetes. Me këtë vepër autori jo vetëm që konfirmon identitetin e tij letrar, por ngjitet një shkallë më lart në hierarkinë e poezisë shqiptare, duke qenë një zë i veçantë dhe i palëkundur në rrjedhat shpesh të turbullta të shprehjes poetike moderne. Me këtë vepër, Jaho Margjeka konfirmon jo vetëm individualitetin e tij poetik, por edhe një vetëdije të thellë krijuese dhe etike, që i jep vendin e merituar në radhët e poetëve të konsoliduar të kohës sonë. Poezitë e këtij vëllimi janë të ngjeshura, të përkryera në formë dhe të sinqerta në përmbajtje. Margjeka nuk kërkon efektin e menjëhershëm, por rezonancën e gjatë në ndërgjegjen e lexuesit. Ai është një poet i fjalës së qetë, por të rëndë si shkëmbi që Sizifi s'e ndal dot. Duke i uruar suksese të mëtejshme në rrugën e tij letrare, shpreh bindjen se kjo vepër do të marrë vëmendjen që meriton në qarqet kritike, universitare dhe receptuese.



Nazmi RUDARI

ME QETËSI PIVA LOTËT E M
(Fragment)

Në Shkup isha turpëruar shumë, isha turpëruar më atë çka po ndodhte në atdheun e ëndrrës sime. Porsa binte terri, çifti nga Shqipëria e kapërcente rrethojën e çerdhes dhe nën strehën që mbulonte shkallët e shtronin ndonjë batanije ushtarake e të vogël dhe binin aty e flinin. Në javën e dytë u bënë katër, në javën e tretë kaluan numrin dyshifror dhe ata rrezikonin të zbuloheshin. Ky nuk ishte problemi im. Problemi im ishte se m´u kishte lënduar shumë shpresa dhe ëndrra se e kemi nënën tonë. Shumë i lënduar tek po zbrisja shkallët shpesh ia prisja vetes se i kishte vdekur nëna kësaj pune. Atë ditë dola në ballkonin e bujtinës që ishte më e rregulluar se të gjitha hotelet e mesme dhe të vogla të shtetit, sepse në atë kohë edhe qeni e macja mund të të futeshin nën pragun e derës së hyrjeve e të dhomave të hoteleve shtetërore. Kjo nuk ishte vetëm arsyeja që nuk isha vendosur në asnjërin hotel. Kryesorja ishte puna se unë isha ilegal, prandaj pikërisht doja të vendosesha aty ku dyshohej më pak në mua. Unë isha i arratisur dhe secilin moment mund të arrestohesha pa kurrfarë arsyetimi. Isha tej mase i tronditur kur në kopshtin e bujtinës të shihja TV që nxirrte pamje më të tmerrshme që ka pasur njerëzimi, se si anijet pushtoheshin nga njerëz që donin ta linin Shqipërinë. Kush e bënte këtë, "sigurimet e huaja", thoshte zyrtarja dhe unë më së lehti e kisha t´i besoja kësaj. Por e kisha edhe argumentin se sigurimet e fshehta jugosllave i ndihmuan elementët e vet që i kishin ndër shqiptarë të Jugosllavisë, përfshirë edhe Kosovën. Njerëzit e parë që vërshuan Shqipërinë ishin elementi i porositur. Ata nuk lanë gur pa lëkundur për të shembur atë që e kishin urrejtur prej kur ka ekzistuar. Unë i njihja dhe janë një pjesë gjallë edhe sot, ose kanë lënë pinjollët e vet. Prapë kjo nuk justifikonte ato çmenduri që pasojë e kishin edhe vdekjen e të pafajshmëve. Kulmi i gjithë kësaj ndodhi mëngjesin e asaj mjegulle të ftohtë vjeshte. E pashë para dyerve të hekurta se po prisnin të hynin në bahçen verore ku ata pinin çdo mëngjes kafe dhe ngrohnin trupin e tyre që kishte thithur të ftohtët e natës. Nuk i kisha ngacmuar asnjëherë e as i kisha lodhur fare. E dija se njerëzit në gjendjen e tyre u frikoheshin shumë pyetjeve. E pashë se edhe kur i përshëndeta, e edhe kur po i ofrohesha tavolinës, ata u ngrysën së tepërmi. E dija se ata kishin një besim të fituar për mua. Ata e dinin se unë i shihja kur hynin dhe kur dilnin shpeshherë dhe ku flinin dhe nuk u bëja pyetje provokuese si ndonjëri se në cilin hotel apo shtëpi ishin vendosur të flinin. Kurrë asnjëherë, prandaj edhe kësaj radhe e bëra pyetjen me shpejtësi të mos i lejoja të hamendësoheshin. "Vëlla, bën ta di se a është për mua më mirë t´ia mësyj Shqipërisë apo ndonjë vendi tjetër?" Burri më shikoi si asnjëherë më parë me një shikim që më shtangu. Ende nuk e kisha veshur pallton dhe po e mbaja mbi kokë në ajër. Shtanga. Pasi veshur isha me një këmishë me mëngë të shkurtra, ai e pa orën time digjitale në dorë të djathtë dhe ajo i kishte reflektuar atij në sy, ndaj e kishte shikuar më gjatë se duhet dhe së fundmi tha: "E sheh atë orë që e ke në dorë?" - pyeti shumë ngadalë e shumë qetë.

"Po," - thashë unë.

"Atëherë po shkove te kufiri, e zgjate dorën që të ndihmojnë ata, do ta presin dorën e do ta marrin orën, dhe ti më nuk je për ta interesantë."

"Për këtë orë të ma presin dorën!" - u habita unë.

"E di ti sa kushton kjo orë?" - e pyeta i shqetësuar. "Pesë marka. Për pesë marka të ma presin dorën, nuk e kuptoj," - thashë.

"Po mirë," - tha ai, as ata nuk e dinë sa kushton ora. Dhe, po deshe ta vërtetosh këtë që thashë unë, nuk të ndaloj. Është vendim yti ai. Më pyete, unë të thashë çka po mendoj, nuk të gjykoj dhe mos më gjyko qartë," - përfundoi ai.

"Faleminderit!" - i thashë unë. E çmoj lart korrektësinë tënde. Hoqa orën nga dora dhe ia dhashë: "Merre këtë orë kujtim për takimin tonë dhe nuk do të shihemi më. Mora mëngjesin dhe ika në tarracën e dhomës sime, atje shkrova poezinë:


"Nëna qante nga turpi"
Anija ushtarake po ikte gjëmë rrethit të detit
Dhe vala e vrulli i shkëputën dashurisë spirancën
Këngë e lot shpirti si në kohë të ligë të mbretit
Qielli e toka s´e përpinin dhembjen as gjëmën
Miti i vjetër po zgjohej në mitin e hirit arbëresh
Epika e tragjedia u ngurtësuan në ciklin shqiptar
legjenda e ciklit të internimit po hapet në shesh fillimisht
po qartësohej legjenda e po digjej zjarr
Në tragjedinë e jetës burg e murg u ngjall feniksi
Nuk heshtej as mendja as zemra, po dilte shpirti nga hiri e toka e uji
dhe deti i nënës në tokën X
Për herë të parë tragjedi moderne në rrethin mitik
Po përbuzej e përulej nëna natyrale nëna biologjike
Do të verbohet nga turpi nuk e mbajnë më të bijtë
Dhe po haja e po qaja për herë të parë lotët me pikën në supën time dhe nuk u hamenda fare, por e piva me qetësi.
Kjo ishte shenjë se po çmendesha.

Botime

NJË POEZI IMPRESIVE ME KONOTACIONE MODERNE
Marjeta Shatro – Rrapaj, "Marevita", LSHK, Prishtinë, 2024.

Një emër që tani pothuajse është bërë i njohur në letërsinë shqipe që po krijohet në arealin shqiptar, Marjeta Shatro – Rrapaj. Veprat e saj ndodhen gjithandej bibliotekave e librarive me krijime në poezi, prozë, eseistikë, shkrime që kanë tërhequr vëmendjen e lexuesit e të kritikës. Njëra nga këto vepra është botuar nga Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës, me titull "Marevita", që në shikim të parë të bën të mendosh më thellë e më qartë për ta deshifruar për kërshërinë e lexuesit. Nuk është lehtë, prandaj vetë titulli besojmë se del nga kjo vepër, që është e veçantë edhe si krijim, edhe si strukturë, edhe si tematikë.

E ndarë në tri cikle: "Gjithmonë me Ty", "Mos u tall me jetën" dhe "Eklips zemre" janë njësi më shumë formale sesa që ngërthejnë tematika të veçanta të trajtimit të tyre. Para cikleve, vëllimi poetik ka dhe poezinë "Dashu-



ritë e mëdha", të cilat poetja i cilëson të tilla që "lindin vetëm një herë"! Mbase në kontekst të kësaj poezie është ndërtuar edhe vëllimi poetik si një sintezë e jetës aktuale e të përbotshme, që del si një gërshetim i jetës së përgjithshme kuptimisht e artistikisht.

Një fenomen jetësor, që është i përbotshëm, dashuria, shtrihet tejetej këtij vargu poetik, edhe në kontraste, edhe në artikulim, duke i dhënë kësaj poezie një ton admirues me pajtime e reflekse shqiptuese, që në realitet është vetë bota jonë, situatat që poetja ka arritur t'i ndërtojë duke konceptuar mjedisin aktual dhe fenomenet shoqërore, duke shprehur tërthorazi edhe njëfarë "marazi" për mospajtimet e saj.

Zëri i vërtetë i botës intime dhe i asaj refleksive

Depërtimi tejet i veçantë në jetën tonë plot divergjenca, në këtë poezi e bën receptuesin kurioz dhe kërkues për të hyrë më thellë në mendimin poetik që shqiptohet me figurat e shumta, me pikëpamje të papajtueshme me zhvillimet e botës moderne dhe pa dyshim me qëndrimin koherent të autores:

Në Askund jam askushi,
pa mbrojtje, pa fat, e ngratë.
Gëzohen "të mëdhenjtë"
Me tragjizmin çmendurak,
Ndaj fali zot djajtë! (f. 56)

Kjo botë e trazuar, ku të detyron ta shpallësh veten askushi, të bën të mendosh për të gjitha situatat që shfaqen në mjediset tona jetësore, të cilat të sintetizuara i gjen pothuajse vetëm në këtë varg poetik. Në të vërtetë, janë lëvizjet e njerëzve tanë, por dhe të vetë njerëzisë që qarkullojnë në dimensione të ndryshme, madje dhe në botën e përtejshme. Nuk është vetëm fantazia e poetes që ligjëron në mënyrë kontrastive, varësisht nga disponimi dhe situatat poetike që ndërton ajo, por bota që na rrethon me prirjet e njerëzve, fantazitë e tyre, veprimet e tyre, pajtimet e mospajtimet.

Kënga e vëllimit poetik "Marevita" tregon zërin e vërtetë të botës intime e të asaj refleksive, si një prerje deri në asht të një dimensioni artistik, që me fantazinë krijuese shqiptohet si një makth kërkues nga shtegu në shteg, si një pakuptimësi që determinon mospajtimin me realitetin aktual:

Mos u lodh,
mos pyet për asgjë,
heshtja hesht,
..buzëqeshjet si shpëtim,
koha lë gjurmë. (f. 55)

Janë ëndrrat, kontrastet e jetës, vizioni, por dhe vetmia, që si prirje del "dashuria", ai kulm i jetës së vërtetë që zbërthehet në krajatat e kohës e të rrethanave që mbysin përpjekjet për padrejtësitë, për njerëzit e ligj, për ata që nuk përfillin drejtësinë! Në të vërtetë, janë ata që veprojnë kundër ligjit e së drejtës, të cilët janë personazhe të përditshmërisë, që poetja i vëzhgon nga afërsia me përbuzje, në të vërtetë i sheh si dëmtuesit e realitetit juridik e faktik. Është një dhembje e brendshme, që reflektohet në masën e gjerë, mbase amorfe, që hesht dhe kur nuk pajtohet me realitetin.

Një strukturë komplekse dhe ndonjëherë konfrontuese në përbërjen e saj

Ajo më e veçanta mbase e këtij vëllimi poetik është prania e poezisë meditative dhe elemente të saj, një strukturë komplekse dhe ndonjëherë konfrontuese në përbërjen e saj. Këto vargje artikulojnë pikëpamjet e autores Marjeta Shatro - Rrapaj në vizionin e saj aktual të jetës dhe të shqetësimeve që sjell ajo me rendin e ri, me

abuzimet dhe shqetësimet që manifestohen në shumë pore të jetës:

Melankoli të pashpjegueshme,
dëshira që duken e zhduken
e i nënshtrohen fatit
duke pritur të panjohurën. (65)

Ky trishtim, që manifestohet me dilemat dhe brengën poetike, është një e panjohur që krijohet nga pritja që del se gjërat që duhen zgjidhur në rrugë jetësore, i lihen fatit, që në të vërtetë i lihen në dorë anarkisë e manipulimeve të atyre që nuk përfillin drejtësinë. Dhe, kjo pritje, kjo melankoli ndihet në mjaft poezi si një protestë poetike, reagim që artikulon shqetësimin e përgjithshëm që tashmë nuk është i vetëm, por si dukuri shoqërore që parimisht duhet kundërvënë gjithsesi si strukturë e një shoqërie të përparuar. Një poezi e këtillë moderne, që më shumë sugjeron sesa shpjegon, e lë receptuesin duke medituar për thellësinë e saj, emocionin që shpreh problematika motivore dhe ndërlikueshmëria e ndërtimit të saj poetik. Është shpresa dhe dëshpërimi, jeta dhe shoqëria, individi dhe kolektiviteti, në të vërtetë është vetë të qenit!

Një element që është i pranishëm tejetej vëllimit poetik "Marevita" të poetes Marjeta Shatro – Rrapaj është ndjenja e optimizmit në tërë këtë kompleks meditativ krijues, që jep mesazh të veçantë, pra, është dashuria, dashuria si emocion dhe dashuria si mision. Qasja konceptuale e një dashurie për të shfaqur ndjenjën më fisnike ndaj njeriut e Atdheut, për të amortizuar këtë vetëdije në situata dramatike për të qenë vetvetja edhe në këto çaste. Kjo shihet nga vargu i latuar me dashuri e përkushtim, me prirje e kulturë, me emocion të thellë e mesazh të qartë poetik.



Vëllimi "Marevita" i poetes Marjeta Shatro – Rrapaj ngërthen edhe një varg vlerash të tjera letrare, që gjithsesi kërkojnë bashkëpunim me veprën e lexuesin, sepse synim i modernes është përpjekja për të shprehur artin dhe jetën në kontekstin aktual në këtë rast të kësaj të fundit.

Prof. Dr. Shyqri GALICA



Ramiz SELIMI

SHTËPIA PA ZEMËR
(Tregim i shkurtër)

Në majën e kodrës, që dikur ishte e gjelbëruar nga dashuria dhe shpresa qëndronte shtëpia, e cila dukej e fortë nga jashtë, por nga brenda gërryhej si trungu i një peme të kalbur.

Aty banonte Gazepi, një burrë me diplomë, por pa urtësi dhe respekt për të tjerët. Madje dyshohej se brenda shpirtit s'kishte fjalë të ngrohta për askënd. Nuk dinte të dëgjonte dhe nuk donte të kuptonte. Kishte studiuar në qytet dhe gjithnjë mburrej me diplomën e tij.

Mendonte se familjarët ishin analfabetë funksionalë, që nuk do ta kuptonin kurrë, prandaj kishte fjalë të mëdha në gojë, por zemra i rrinte e thatë si ara pa shi. Të gjithë në familje, prindërit, vëllezërit, gruan, fëmijët, i shihte si shërbëtorë në atë dramë ku ai ishte aktor dhe regjisor i vetëm.

Ai kishte ndërtuar një mur rreth vetes që nuk ishte nga guri, por nga krenaria boshe, duke menduar se ishte i gjithëdijshmi.

E quante veten "shtylla e shtëpisë" atëherë kur ai kishte filluar të bëhej një gur i rëndë mbi çatinë që po kërrusej çdo ditë e më shumë. Ai dinte të fliste për filozofi, për histori, për dreq e të bir, por nuk dinte të thoshte: "Më fal, ejani të punojmë bashkë!"

Çdo mëngjes, ngrihej herët dhe lexonte gazeta në tavolinën e drunjtë. Mërmëriste mendime të mëdha për botën, por s'kishte sy për rrëmujën që i ndodhte brenda pragut të vet.

Shtëpia kishte filluar t'i çahej, jo nga mungesa e çimentos, por nga mungesa e zemrës, nga mungesa e vizionit. Nuk njihte kompromis, por vetëm dominim dhe imponim. Mendonte se çdo fjalë tjetër përveç të tijës ishte gabim. Çdo ide ndryshe e shihte si kërcënim për familjen. Dita-ditës familjarët filluan të iknin pa zhurmë dhe atë sa më larg atij fshati, saqë me kalimin e kohës edhe shtazët shtëpiake filluan të ngordhnin nga uria.

Në fund, gruaja dhe fëmijët morën rrugën pa kthim. U shpërndanë si gjethet që i bart era në dimrin e hidhur. Gazepi mbeti vetëm në pallatin e tij, si oratori pa dëgjues. Shtëpia u shpërbë jo nga koha, por nga mungesa e shpirtit vizionar. Dhe, Gazepi, me gjithë librat që kishte lexuar, kurrë nuk e kuptoi se njeriu nuk mbahet mend për sa di, por për atë se çfarë i jep shtëpisë...



Në ditëlindjen e Asdrenit

NJË "MËKAT" I ASDRENIT

Emil LAFE

Rasti më i ri kur kam dëgjuar nga afër Himnin e Flamurit të kënduar nga një kor, ka qenë më 21 nëntorin e shkuar, ditën e hapjes së Kuvendit Kombëtar për Gjuhën shqipe në Pallatin e Brigadave. I kisha përballë dhe fare pranë vajzat dhe djemtë e liceut artistik "Jordan Misja", që e kënduan me shumë ndjenjë e ngazëllim zemre, ndoshta për herë të parë në atë sallë dhe përpara kryeministrit. Te vargjet 5-6 të strofës së parë:

Prej lufte veç ai largohet
Që është lindur tradhëtor...

Vajzat dhe djemtë e korit dhanë gjithë frymën dhe frymëzimin e tyre për të arritur atë *kreshendo,* siç quhet në gjuhën e muzikës, dhe që kulmon te fjala **tradhëtor**. E kënduar te himni ynë ajo kumbon aq solemne, aq madhështore, aq sublime, saqë të duket sikur nuk është fjala për tradhëtorin, po për të kundërtën e tij, për trimin që vdes si hero legjendar duke mbajtur betimin që ka bërë mbi të shenjtin e të shenjtëruarin *"O flamur gjak, o flamur shkabë, O vend e vatr', o nën' e babë!"* Pse duhet ta kemi dhe ta ekzaltojmë në himnin tonë (që është më parë një himn kombëtar i gjithë shqiptarëve e pastaj edhe i shtetit) fjalën **tradhëtor**? Kjo pyetje më ther së brendshmi sa herë e dëgjoj dhe më shkon mendja ta quaj **Një mëkat i Asdrenit.**
Dihet se teksti i himnit tonë është frymëzuar nga kënga patriotike rumune "Pe-al nostru steag e scris unire" ("Në flamurin tonë është shkruar bashkimi"), për të cilën shkroi muzikën kompozitori Ciprian Porumbescu (1853–1883):

Acel ce-n luptă grea se teme
Ce singur e rătăcitor,

shqip:

Ai qe ka frike nga lufta e rreptë
Është vetëm endacak (d.m.th. pa atdhe)

Për këtë "mëkat" të Asdrenit ka rënë fjala edhe në raste të ndryshme me kolegë filologë, po edhe me njerëz të muzikës. E kemi njohur si një "cen" të himnit tonë dhe që "s'ke ç'i bën"! Por duke vrarë mendjen se si mund të kapërcehet ky cen, ka dalë edhe një propozim, që kam dëshirë ta bëj të njohur për atë që quhet "opinioni publik" e veçanërisht për njerëzit e botës së letrave e të muzikës:

Prej lufte kurrë nuk largohet
Kush është lindur arbëror!
Kush është burrë nuk frikohet,
Po vdes, po vdes si një dëshmor!

Ose, për të shmangur përsëritjen *kush ... kush* në krye të vargjeve 2 e 3:


Prej lufte kurrë nuk largohet
Ai që lindet arbëror!
Kush është burrë nuk frikohet,
Po vdes, po vdes si një dëshmor!

dhe kështu ai kumbim aq solemn, aq madhështor, aq sublim i muzikës së atij vargu, tani i vishet fjalës **arbëror**, emrit të popullit tonë në kohën e Motit të Madh, prej nga na vjen edhe Flamuri që kemi, prej nga na ka ardhur edhe frymëzimi e guximi për një "Shqipëri të lirë e të mosvarme".
Sikur t'i kishte shkrepur në mendje Asdrenit fjala ***arbëror*** kur shkroi tekstin e këngës "Betimi mbi flamur", sa bukur e sa madhështor do të tingëllonte himni ynë, që i këndon simbolit të bashkimit, të krenarisë, të vendosmërisë e të qëndresës së paepur! A mund të ndreqet ky "mëkat"



Asdreni

i Asdrenit në vjershën e tij që ka qenë dhe mbetet himni kombëtar i shqiptarëve para se të bëhej himni i shtetit? Them se e kemi lejen dhe mirëkuptimin e tij për ta ndrequr! Duhet pak vullnet i mirë ndërmjet nesh dhe mirëkuptim e interesim edhe nga institucionet që kanë tagrin për veprimet përkatëse ligjore.



Agim H. BERISHA

ËNDRRA E BREZAVE

PËRBALLJA PËR ITAKËN

Domosdo
Do të kthehen një ditë
Nga udha e përtej detit

Atje
S'u peshuaka gjëma e tokës
S'u peshuaka gjaku i brezave

Sa rëndë
Për çlirimtarët secila zemër
Prek secilën plagë

Ata do të kthehen një ditë
Pas sa vitesh përballje për Itakën

Ua dogjën pikëllimin shekujve

Sa bukuri
Për malet epike
Për krismat e atdheut

Ardhja
Vjen vetëm me Ju

Atdheu ka mall
Si prej Rambujesë
Si atë ditë me Lirinë

E BUKURA

Toka ime
E bukura e shenjta
As vritet as shitet

Hijet tragjike
Dhe ofshamat tua
Më lën pa gjumë

Lot të akullta
Pikonin strehët e agimeve
Si në balada

Eklipsi i moteve
Krejt etje ecën lumi
Nën qiellin e mugët

Kohë
Me ethe makth stinësh

Etërit tanë
Asgjë nuk kursyen
Dasmat as krismat as vdekjet

Për Ty

Gjithë jetën ecën
Ecën me barrën e maleve
Toka ime

AGMI LIRIE
(*Y. Humollit*)

Portreti yt
A bëhet me vargje metafora
Shkreptimë dite

Ti
Hapëroje shtigjeve të diellta
Me bashkëmoshatarët


Duke kërkuar
Vetveten udhëve të bardha
Kohë e ftohtë akullimë

Një klithmë
Gjak i virgjër ra në tokën e etur

Ti
Sa e doje jetën e lirë
Ndaj hyre yllshëm në përjetësi
E heshtura e mira

Mblodhe
Dhembjen të gjitha makthet
E stinëve

Dhe preke lartësitë majat
Toka je etja ëndrra e brezave
Ti agmi lirie



Prof. Dr. Hysen MATOSHI

FENOMENI REXHEP QOSJA NË KULTURËN SHQIPTARE

Ndër personalitetet me të cilat identifikohen rrjedhat e proceseve kulturore e emancipuese shqiptare është edhe akademik Rexhep Qosja. Një autor shumëplanësh i shkrimit dhe i mendimit shqip, i cili e ka dhënë ndihmesën e tij në fusha të ndryshme, si në studime letrare, kritikë letrare, historiografi, publicistikë, eseistikë, polemikë, memoaristikë, krijimtari artistike në fushën e prozës dhe të dramës etj., ka lënë gjurmë pothuajse në të gjitha këto aspekte, pa anashkaluar edhe angazhimin e tij intelektual në kohët dhe rrjedhat historike për kombin shqiptar.

Ndërlidhja mjeshtërore e imagjinatës kreative me erudicionin e rrallë

Periudhat e zhvillimeve, qoftë në kulturën kombëtare, qoftë në atë të përbotshme, identifikohen me vlerat dhe personalitet që, në saje të arritjeve të jashtëzakonshme autoriale, i shënojnë ato. Njëkohshëm ndikimi i tyre shkon përtej përmasës kohore dhe përtej hapësirës me të cilën njëjtësohen kulturalisht si autorë veprash a vlerash artistike, kulturore e diturore. Veprat e këtilla, origjinale dhe të papërsëritshme, si manifestim i vetëdijes së lirë autoriale, unike si krijimtari e gjithmbarshme, që kanë një lidhshmëri organike përmbajtjesore e strukturore si vlera të kreativitetit shpirtëror e të racionalitetit mendor, si të tilla, vetvetiu përbëjnë një fenomen kulturor. Akademik Rexhep Qosja, jo vetëm me veprën e tij shumëplanëshe shkrimore, por edhe me qëndrimin parimor intelektual, në kohë të vështira dramatike të historisë, në rrafshin e determinimit të individit me kapacitete të jashtëzakonshme kreative e profesionale, përbën një fenomen për kulturën shqiptare. Një pamje më të plotë, në planin e kontributit profesional, intelektual dhe moral, të shpërfaqur në veprën shkrimore, e ofron projekti më i madh i botimit të një autori shqiptar, që e ka parë dritën në një kolanë unike, sikundër është botimi i veprave të zgjedhura të akademik Rexhep Qosjes, më 2010, ku janë përfshirë 40 vepra të tij të ndryshme të deriatëhershme, të konceptuara në 29 vëllime, kuptohet në edicionin e Institutit Albanologjik, me ekzistencën institucionale të të cilit njëjtësohet dhe përplotësohet natyrshëm e në mënyrë të ndërsjellë portreti i tij. Si totalitet, kjo kolanë është shprehje e një identiteti të autorit, por edhe e një pjekurie të kulturës shqiptare, një fenomen, një dukuri me premisa të shndërrimit në një praktikë të identifikimit të vlerave kulmore tradicionale e aktuale të kulturës shqiptare.

Njëra ndër shenjat e origjinalitetit krijues të Rexhep Qosjes shtrihet në letërsinë që krijon ai. Prozat dhe dramat e tij përbëjnë një kthesë të guximshme dhe të ndjeshme kundruall traditës sonë letrare, ndërsa krijimtarinë e tij letrare nuk e bën të identifikueshme tematika e saj në përmasën që e bën vetë mënyra se si është shkruar ajo, përkatësisht koherenca e padiskutueshme stilistike, që mban vulën e një universi të pashëmbëllyeshëm krijues në kontekstin shqiptar. Përveçse nuk ndjek, në mënyrë të veçantë, ndonjë model nga proza pararendëse shqipe, lirisht mund të thuhet se vepra e tij mbetet në masë të madhe e paimitueshme, e paasimilueshme nga autorë të tjerë, si gjedhe letrare, rrjedhimisht deri sot pa trashëgimtarë të denjë. Duke e përfillur njërin nga parimet themelore krijuese të romanit modern, sipas të cilit romani është dije, Rexhep Qosja ka ndërlidhur në mënyrë mjeshtërore imagjinatën e tij kreative me erudicionin e rrallë. Veç këtyre skajeve vështirë të pajtueshme, ai, me prozat e tij letrare, krahas zotësisë së rrallë të përshkrimit të detajuar, dëshmon se është mjeshtri i sentencës në mendimin shqiptar përgjithësisht. Sentencat e qëlluara janë rezultat i thithjes së një informacioni të gjerë dhe i përthyerjes së tij nëpërmjet përsiatjes filozofike mbi botën. Një aspekt tjetër që ka lëkundur deri diku konceptin tradicional për prozën është edhe fakti se autori e paraqet situatën në personazh dhe jo personazhin në situatë, duke i dhënë kështu prozës së tij edhe nuanca të theksuara lirike. E thëna se shkrimtari gjatë gjithë jetës së tij, në të vërtetë, shkruan një vepër të vetme, unike, në disa raste është e pashmangshme, pavarësisht se ajo krijohet në rrethana të ndryshme dhe në vëllime të ndryshme. Pa dyshim, në kontekstin tonë letrar e kulturor një gjë e tillë në mënyrë të veçantë mund të pohohet për prozën letrare të Rexhep Qosjes, ngjashëm sikundër që, në përmasa botërore, kjo mund të thuhet, bie fjala, për veprën letrare të Gabriel Garsia Markezit. Në këtë pikëpamje, prozat e Rexhep Qosjes, me strukturën e tyre kompozicionale dhe me përbërës të tjerë ideoestetikë, ndjekin logjikën e modelit të kurorës së soneteve, me ç'rast nga njëra prozë te tjetra barten përbërës të caktuar, duke e bërë edhe më të dukshme koherencën e tyre. Këto janë vetëm disa shenja të mungesës së konformizmit kundruall traditës sonë, përkatësisht disa shenja që e identifikojnë origjinalitetin krijues të Qosjes si shkrimtar.

Tri kontribute monumentale të studimit të letërsisë

Një fushë tjetër një e veçantë e veprimtarisë intelektuale të Rexhep Qosjes ka të bëjë me studimet tona letrare. Për punën e tij shkencore janë thënë fjalë të mëdha. Puna

dhe rezultatet e tij janë krahasuar jo me kontributet e kolegëve të fushës, por të institucioneve albanologjike. Pa u ndalur në përmendjen e të gjitha veprave që e trajtojnë letërsinë shqipe, konsideroj se sintezat e mëdha studimore, sikurse janë historia trivëllimëshe e romantizmit shqiptar, monografitë "Porosia e madhe", "Asdreni – jeta dhe vepra", pastaj veprat "Prej tipologjisë deri te periodizimi" dhe "Tri mënyra të shkrimit shqip" janë kontribute monumentale dhënë studimit të letërsisë shqipe. Përveçse ka shtruar, nëpërmjet tyre, çështje të rëndësishme për letërsinë shqipe dhe, në të shumtën, ka ofruar përgjigje të qëndrueshme e të argumentuara shkencërisht, lirisht mund të pohohet se akademik Rexhep Qosja, me veprën e tij të gjithmbarshme studimore, është shndërruar në një shkollë studimesh albanologjike. Në rast se do t'i ndiqte modelet ekzistuese të studimit të letërsisë shqipe, që mbështeteshin në doktrinën e realizmit socialist, sot vështirë se do të mbahej mend, qoftë si historian, qoftë si kritik letrar. Duke ndjekur rrugën e vështirë të moskonformimit me dogmën letrare, përkatësisht rrugën e bërjes së rrugës së re, ai që herët ka nxjerrë përfundime në të cilat shumë bashkëkohës të tij do të vinin vetëm dekada më vonë. Që herët konstatoi rrezikun nga trajtimi i letërsisë artistike në mënyrë të skematizuar sociologjike që pretendonte ta shndërronte këtë art në pasqyrim të proceseve shoqërore dhe në histori të ideve e të ideologjive, rrezikun nga toni glorifikues që e kishte përmbytur letërsinë shqipe pas Luftës së Dytë Botërore, rrezikun nga kufizimet që krijuesve të mirëfilltë ua prodhonte aktualiteti shoqëror e politik, duke i parë si rrugë shpëtimi, në këtë kontekst sociokulturor, përpjekjet e shprehjes së disa autorëve të rinj nëpërmjet simbolit dhe alegorisë. Saktësia e mendimit dhe elokuenca e shprehjes janë karakteristikë e veprës tërësore të Rexhep Qosjes. Ne edhe mund të mos pajtohemi me konstatimet që gjejmë në veprën e tij, por s'do të mund të ankohemi kurrë se nuk e kemi kuptuar atë, se vepra e tij nuk ka qenë e shkruar me një gjuhë të qartë, të saktë, të rrjedhshme, nuk mund të ankohemi se veprës së tij i kanë munguar argumentimet dhe gjithashtu nuk mund të qahemi se i kanë munguar përfundimet, në të shumtën, origjinale.

Vetëdija kritike, si vetëdije që shquan kombet e qytetëruara

Jokonformizmi nuk nënkupton vetëm qëndrimin apriori kundër, ngase një gjë e tillë çon në rrezikun e kundërvënies skematike. I vetëdijshëm për këtë, gjatë dekadave të punës së tij intelektuale, Rexhep Qosja ka kultivuar vetëdijen kritike, si vetëdije që shquan kombet e qytetëruara, por, e cila, fatkeqësisht, edhe sot e kësaj pak gjallëron ndër ne. Ai nuk ka reshtur asnjëherë t'i shprehë pikëpamjet mbi aktualitetin, mbi historinë,



Akad. Prof. Dr. Rexhep Qosja

t'i mbrojë qëndrimet e tij dhe të polemizojë për to. Në shumicën dërrmuese të shkrimeve publicistike ka angazhuar tërë qenien intelektuale e morale në mbrojtje të çështjes shqiptare, duke publikuar monografi, analiza, komente, reagime, intervista etj. Sado që mban qëndrim kritik ndaj papërgjegjësisë së shfrenuar që ka kapluar shoqërinë tonë, në mënyrë të veçantë ndaj papërgjegjësisë politike, në shkrimet e tij nuk zotëron dhe nuk predikohet pesimizmi. Madje, mund të thuhet se, edhe kur pakkush besonte se shqiptarët do të mund të dilnin nga kthetrat e Serbisë, në vitet e letargjisë sonë politike, Rexhep Qosja vazhdimisht do të pohonte se lufta me konferenca shtypi kundër Serbisë kishte alternativën: "Në qoftë se shqiptarët sot nuk e përdorin dhunën për arritjen e qëllimit të vet, kjo nuk domethënë se një ditë nuk do ta përdorin. Dua të them: në qoftë se rrugës paqësore nuk do ta arrijmë qëllimin tonë të drejtë e të ligjshëm – lirinë dhe pavarësinë, ne e dimë se është e ligjshme dhe lufta... shqiptarët nuk do ta durojnë pambarimisht atë që e durojnë sot, nuk do të luftojnë vetëm me gojë kundër pushtimit serb". Përveçse një deklarim plotësisht jokonformist, kundruar në kontekst të vitit 1992, kur fjala paqe në fjalorin tonë politik nuk kishte lënë vend për asnjë fjalë tjetër zëvendësuese, ky pohim u dëshmua edhe si parathënës i zhvillimeve të mëpastajme. Profetik ishte edhe konstatimi i tij nga kjo kohë se fitorja politike serbe

mbi Kosovën nuk do të zgjaste përgjithnjë dhe se në aktin e fundit çështja e Kosovës do të përmbyllej me fitoren historike të shqiptarëve.
Vepra e shumanshme shkrimore e Rexhep Qosjes shtrihet në fushë të krijimtarisë letrare, të historisë së letërsisë shqipe, të historiografisë përgjithësisht, të kritikës letrare, të publicistikës etj. si faktorin më konvergjues e njeh stilin e veçantë e të kodifikuar të autorit. Nëse stili është vlera më koherente e veprës së tij shkrimore, jokonformizmi, si aspekt estetik dhe njëkoshëm edhe etik, është vlerë që ngërthen në vete më shumë sesa shkrimtarin, më shumë sesa historianin e letërsisë, më shumë sesa publicistin, më shumë sesa polemistin - jokonformizmi ofron totalitetin e veprimtarisë së përgjithshme të Rexhep Qosjes, është mënyra e jetës së tij.

Një shenjë e identitetit drejt një vetëdijeje kritike e moderne si tregues e pjekurisë kulturore shqiptare

Kultura jonë – e përfaqësuar në një format unik shkrimi të njërës ndër figurat më emblematike të botës bashkëkohore shqiptare – si fenomen risimtar, ka gjetur në veprën dhe veprimtarinë e Rexhep Qosjes një shenjë të qartë të identitetit tonë kulturor, që e ka transformuar rrënjësisht vetëdijen tradicionale, anakronike, mitike, folklorizuese, glorifikuese, himnizuese, epigonike, ideologjizuese, akademizuese drejt një vetëdijeje kritike e moderne si tregues i pjekurisë kulturore shqiptare. Vepra shkrimore e Rexhep Qosjes është fenomen i rrallë kulturor, një trashëgimi monumentale që vjen në një format prej më shumë se 20 mijë faqesh, duke e shndërruar autorin e saj në një dukuri specifike dhe orientuese për rrjedhat e zhvillimit të dijes, të kulturës dhe të mendimit shqiptar.
Duke e përfunduar këtë shkrim të përmbledhur, mbi veprën dhe veprimtarinë e vijueshme kreative intelektuale të Profesor Rexhep Qosjes, dua të shpreh, në mënyrë të sintetizuar, bindjen se Profesori ynë, si fenomen i papërsëritshëm kulturor, përveçse shumëplanësh në produktin e tij shkencor, artistik, publicistik, memoartistik etj., po kështu mund të thuhet se u takon njësoj të tri kohëve: të kaluarës si historian, e specifikisht si historian i letërsisë, si autor që veprën e tij shkencore e bazon në faktografi e argumente e gjithnjë duke i shpalosur, interpretuar dhe konstatuar aspektet më të dallueshme të identitetit shqiptar; ndërkohë që i takon të sotmes si krijues i vlerave të rëndësishme kulturore e diturore, por edhe si dëshmitar, si kritik dhe si vëzhgues objektiv i fenomeneve e zhvillimeve në jetën tonë shoqërore, politike, kulturore, shkencore etj. dhe gjithsesi i takon edhe të ardhmes si vizionar, si ideolog, në krye të herës, i përqendruar tek e nesërmja e shqiptarëve, te përbashkësia funksionale e kombit.



Vladimir MUÇA

TINGULLI I TIM ETI


Ky tingull çekiçi
Është tingulli i tim Eti?...
Ku ta gjej atë tingull kujtimi,
Ta gdhend me daltën e fisit,
Të formoj dëshirën e amanetit,
Dëshirave tona
mbytur nga mashtrimi.

I papunë,
Me pamje manekini
Pritjen e dëshirës e bëra mikun tim.
Ngadhënjimi shfryhej mbi vuajtjet spartane,
Të vërtetat mbi kurme jete falte.
E unë, mes udhëkryqesh
Zgjidhja ëndrrën
Mes tollovisë mjerane.

Tingulli i çekiçit në gurin e tim Eti
Më mban zgjuar
Mes botës reale dhe surreale,
Më rëndon mbi supe si Gur Pendimi
Më shumë se pesha e këtyre maleve.
Kokën ngre mbi banderolat,
Eci rrugës mes maktheve,
Mashtrimeve të një fushate;
Ëndërroj tingullin e çekiçit gurgdhendës,
Keqas arnuar viteve abstrakte.

Hapin e politikanit dhe hapin e punëtorit
E shtroj në rrugëtimin e një shprese të vonuar;
Duke ecur drejt një mëngjesi ngjyrë alle,
Me shpirtin e një dashurie
Pa dhimbje e skamje.

Oh, dëshirat e mia të gjora,
Gjakuar mes ngjyrash partiake!...
Ngopur me kënaqësi prostitutash
Mes shalëve të një fushate,
Rruposur në oreksin e një balene,
Në ekstremet e vjetra
Të një orgazme.



Shpendi TOPOLLAJ

VEPRA SHUMËPLANËSHE E VLADIMIR MUÇËS

Kushdo që do të marrë mundimin për t`i hedhur qoftë dhe vetëm një sy historisë së letërsisë shqipe, patjetër që do të konstatojë jo vetëm numrin e madh të autorëve ushtarakë në të, por edhe kontributin e rëndësishëm që ata kanë dhënë për letërsinë, për të cilën strukturalisti bullgar Cvetan Todorov thotë se "i lejon secilit t`i përgji-gjet më mirë thirrjes për të qenë njeri". Ne kuadrot që shërbyem gjithë jetën tonë në radhët e ushtrisë, kemi arsye të ndihemi krenarë që nga gjiri ynë kanë dalë qindra poetë, prozatorë, dramaturgë e kritikë letrarë me emër, të cilët me veprat e tyre kanë nderuar veten dhe Atdheun. Oficerët, para se të ishin luftëtarë në mbrojtje të interesave të paqes, të lirisë e të pavarësisë së popullit e të vendit të tyre, janë ndier qytetarë si gjithë të tjerët, që edhe atje në transhe apo marshimet e gjata e stërvitje me armë në dorë, mes ushtarëve, kanë shpërfaqur shpirtin e tyre të ndjeshëm, dashurinë për të mirën, të ndershmen e të bukurën. Dhe i kanë konceptuar ato sipas formimit të tyre kulturor, njohjes së artit, të shkencës apo të librave të shumtë që lexonin. Në punën e tyre plot vështirësi, synimi ka qenë përcjellja e kësaj fryme dhe edukimi i efektivave me vlerat më të larta të trashëgimisë sonë të pasur.

E vetmja shkollë për shkrimtarin - biblioteka

Siç dihet, nuk kishte repart që të mos kishte bibliotekën e vet plot me libra dhe nuk kishte ditë që të mos i trajtonim ata në orët e kulturës masive. Kjo e bëri librin shok të pandarë dhe një arsye më shumë për të nxitur tek ata më të talentuarit dëshirën për të shkruar. Siç shprehet nobelistja Nadine Gordimer: "E vetmja shkollë për shkrimtarin është biblioteka: lexim, lexim, lexim!" Dhe, njëri nga ata oficerë që nuk e lëshoi asnjëherë librin nga dora, ishte dhe miku ynë, Vladimir Muça, dhe që më pas, me krijimtarinë e tij shumëplanëshe, pra, me librat e shumtë që shkroi e botoi, arriti të bëhet një poet, prozator, eseist dhe kritik letrar mjaft i njohur. Andrallat e pafund gjatë kohës që ai punoi si oficer nuk e favorizuan, e mundësuan që të botonte mirëfilli nga krijimtaria e tij, ndaj e nisi këtë rrugëtim pak me vonesë. Por "nuk është kurrë vonë për të qenë ai që duhet të ishe", mendonte Elioti. Madje sot më shumë se kurrë, shoqëria jonë, në të cilën po lulëzojnë vese dhe fenomene aspak dinjitoze, mund të ketë më shumë nevojë për thënien e Kamysë se vepra e shkrimtarit do ta mbrojë qytetërimin nga vetëshkatërrimi.

E parë kështu, qenia shkrimtar, veç të tjerash, e bën një autor edhe misionar të popullit të tij. Ja pse në të dhjetë librat e Vladimirit me poezi gjejmë: delikatesë, ndjenjë, emocion, mall, nostalgji, dashuri, reminishenca për vendlindjen, miqtë, shokët, prindërit; Ostrenin e babait, Libohovën e nënës, apo edhe trishtim për ikjen në emigrim të shqiptarëve. Ja si shkruan ai te poezia "Kokën kthej pas", ku të kujton diçka nga stili i pavdekshëm i Jeseninit: "Nderim dhe lavdi s`kam kërkuar, / Zhurmërinë fëmijënore e njoh, / Ndaj stepem e shumë i menduar, / Vendin ku linda e shoh. / Shikoj portokallin te dera, / Të plakur, pa lule që mot, / Brigjet me brugat e blerta, / Marsiakët të trembur pa zot. / Të desha shtëpi ku linda / Në lagjen Erzen atë Shëndre, / Ndaj veten time e binda, / Me ëndrra të bukura, pa fre. / Buzë brigjeve me shkurre rakitash / Duart i gjakosa çdo ditë, / Vështrimet zhbiruese petritash, / I ngjita lart mbi selvitë." Në tregimet, novelat dhe romanin "Në gjurmët e ëndrrave", Vladimiri materialin e merr nga jeta, me të mirat dhe të këqijat e saj, me bukuritë dhe shëmtitë e saj, por gjithmonë me besimin se e nesërmja do të jetë më e mirë. Kurse shpirtin e tij të madh dhe mendjen analitike, rrethuar nga një erudicion letrar, ai e shkrin teksa analizon krijimtarinë e të tjerëve, në të pesë volumet e tij. Ezra Poundi ka thënë dikur që "mos ia vër veshin kritikës së atyre që nuk kanë shkruar asnjë vepër të mirë", kurse Ladi e ka vërtetuar se di të shkruajë vepra të mira, ndaj dhe është tërësisht i besueshëm në ato që shkruan për libra dhe shkrimtarët tanë.

Mirëpritet mendimi i tij kritik

Shkrimtari Sazan Goliku për "Kaleidoskopin" e tij thotë: "Duke lexuar shkrimet e kritikat letrare të Vladimir Muçës bindesh se vullneti i duhur, përkushtimi e pasioni për letërsinë arrijnë që për një autor (edhe pa shkollimin e specializuar akademik), të krijojë tekste që u përgjigjen kërkesave e niveleve serioze të letërsisë së një vendi e një kohe, duke dhënë ndihmesë me vlerat që përmbajnë." Kjo aftësi e tij, ka bërë që autorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë Shqipërisë, ta kërkojnë dhe mirëpresin mendimin e tij kritik. Kjo ka bërë që ai të ketë miq ngado, si në Kosovë, Maqedoni të Veriut, Itali apo Greqi dhe të jetë i ftuar në veprimtaritë që ata organizojnë. Në çdo ngjarje letrare, Vladimir Muça shkon i përgatitur seriozisht me shkrim. Punon për këtë pa u lodhur, edhe pse duhet pohuar se kjo do kohë, mund, dije e shfletime pa fund, gjë për të cilën dikush vërente se "nevojitet një mendje shumë e pazakontë, që të marrë përsipër analizën e së qartës" (Alfred N. Vhitehead). Por Ladi ia del me sukses, pasi veç mendjes së qartë, ka edhe shpirtin e pastër. Dhe, pikërisht për këtë, u bën nder si vetes, ashtu edhe shokëve të tij, me të cilët kaloi vitet e bukura dhe të vështira, si kuadër i ushtrisë sonë.



Akad. Prof. Dr. Floresha DADO

FORMËSIMI 'VIZUAL' BRENDA RRJETËS NARRATIVE

Figura-personazh, boshti i narracionit

Pothuaj në gjithë teoritë, që janë marrë me gjinitë rrëfimtare, nocioni i personazhit është lidhur me dy konceptet: *subjekt* dhe *fabul*. Pavarësisht nga termat, nganjëherë të ndryshëm, që kanë përdorur teoricienët, nga antikiteti e deri në teoritë letrare moderne (G. Genette, Shlomith Rimmon-Kenan dhe Mieke Bal) për të emërtuar këto koncepte, si: *story-histoire-fabula-narration-narrative-text*), nuk kemi të bëjmë thjesht me çështje termash, por me ***thelbin e ndërtimit*** të veprës dhe rolin që luan personazhi brenda strukturës funksionale të saj. Jo më kot teoritë narratologjike i kushtuan vëmendje të veçantë rolit që ka personazhi në procesin e komplikuar rrëfimtar, sepse boshti organizues i gjithë këtij procesi mbetet pozicioni dhe thelbi përmbajtjesor i tij. Sipas këtyre teorive personazhi është një 'unitet i integruar' në rrëfim, që përfshin edhe 'unitete të niveleve më të ulëta…, që lejon të ndërtohen konfiguracione semantike të tekstit.' Personazhi, duke qenë në qendër te narratives, është organizues i tekstit, sepse artikulon të gjithë tipat e sekuencës: qofshin këto narrative, deskriptive, dialoguese dhe i jep kuptim këtij artikulimi, duke qenë ***njëkohësisht edhe efekt i strukturës*** në të cilën 'jeton'. Në termat narratologjikë, personazhi nuk është gjë tjetër përveçse potenciali për histori, për zhvillimin e kohësisë dhe hapësirës, shkurt për narrativen në vetvete.

Rrëfimtari në ndërtimin e personazhit

Trajtimet e para narratologjike nisën që në veprën *Poetika* të Aristotelit, ku doli në plan të parë koncepti i thurjes së subjektit, brenda të cilit veprojnë karakteret (personazhet). Por, sidomos gjatë shekullit XX përfytyrimi mbi *personazhin* dhe rolin e tij ka përbërë një problem të rëndësishëm të narratologjisë dhe teoricienë, si V. Jouve pohuan se ishte pikërisht narratologjia ajo që ofroi qasjen më interesante për personazhin.

Më parë, deri në prag të trajtimeve teorike të formalistëve rusë, e sidomos të V. Propit, personazhi shihej më tepër rezultat i organizimit të materialit në një intrigë dhe përfaqësonte, nga njëra anë, një mjet për të lidhur në seri motivet, nga ana tjetër, një mishërim dhe personifikim të motivimit të lidhjes së tyre. Kjo i referohet, sigurisht në mënyrë të veçantë, gjinisë rrëfimtare, në të cilën realizohet një ndërtim specifik i subjektit, përmes pikëvështrimeve dhe niveleve të ndryshme të thurjes rrëfimtare.

Kuptimi i rolit të rrëfimtarisë në ndërtimin e personazhit ndryshoi, sidomos gjatë shekullit XX. Kështu, në fillim të këtij shekulli teoricienët e Formalizmit Rus i dhanë *sistemit narrativ* një kuptim të ri, funksional, duke e konsideruar personazhin si një komponent thelbësor të tij, mbi të cilin nuk pranohet analiza psikologjike. Në teoritë e mëvonshme, si ajo e Propit, që u rimor nga Todorovi, Greimasi, Bremondi etj., perceptimi i personazhit lidhet me sferën e *funksionit*, *aksionit*, të rolit si '*aktant*' ose '*agjent*'. Në këtë linjë kuptimi i personazhit shihet në sfondin e rrëfimit i lidhur ngushtësisht me ngjarjen: "historitë ekzistojnë vetëm atje ku shfaqen, si *ngjarja* ashtu dhe *ekzistuesit* dhe nuk mund të ketë ngjarje pa ekzistues." Më vonë, studimet e strukturalistëve Greimas, Bart etj., thelluan teorinë e studimit mbi të dhe, ndonëse në një farë mënyre secili ka pikëvështrimin e vet, konceptimi i personazhit, brenda procesit të rrëfimit, u mbështet në qasje tjetër. Sipas teorisë së Bartit analiza strukturaliste nuk e përkufizon personazhin në aspektin psikologjik, nuk e sheh atë si një qenie, por *si pjesëmarrës*. Dhe është i saktë vëzhgimi i V. Jouve se, me qasjen strukturaliste u hap rruga për një qasje gjuhësore, që u zhvillua edhe te studimi i Ph. Hamonit: *'Për një status semiologjik të personazhit.'* Duke iu referuar analizës semiotike të personazhi, autori e mbështet përkufizimin mbi të sipas tri kategorive: a) personazhe referenciale, b) personazhe që përfshijnë lexuesin ose autorin, c) personazhe anafora, që bashkojnë dhe strukturojnë veprën nëpërmjet një sistemi kthimesh dhe kujtimesh.

Jo vetëm trajtimet teorike, por në radhë të parë është tradita e romanit, nga fillimet e rrëfimtarisë klasike deri tek eksperimentet moderniste, dëshmi e ridimensionimit të vazhdueshëm të rrëfimtarisë, të shumëllojshmërisë së raporteve midis rrëfimtarit dhe personazhit, të konfigurimeve nga më të ndryshme, të pozicionit dhe rolit që luan ky i fundit në gjithë strukturën rrëfimtare. Por, ndërsa romani klasik e zbulon thelbin e karakterit në marrëdhënie dhe kushtëzim nga një kontekst i caktuar, ku mbizotëron kryesisht raporti shkakor dhe kronologjik-kohor, romani modern kapërceu skemat tradicionale, ai shfaqet më refleksiv, ligjërimi organizohet në të njëjtën kohë si refleksion i brendshëm dhe i jashtëm i botës së personazhit.

Koncepti mbi ***strukturën narrative*** përfshin skema të ndryshme të zhvillimit të personazhit, të motivit që e vë atë në lëvizje, të raporteve që krijon me personazhe të tjera, apo me autorin, apo me lexuesin etj. Personazhi është niveli më i lartë i organizimit, sepse ***lidh sekuencat,*** sikurse ***edhe përcaktohet prej tyre***. Në këtë nivel të abstraksionit semioticienët kanë dalluar se personazhet i realizojnë rolet në situata të ndryshme, si: ndeshjen protagonist/antagonist, kërkimin subjekt/objekt, dhënës/marrës, ndihmës/kundërshtar etj… Raporte të tillë realizojnë aspekte dinamike të rrëfimit.

Një trajtim i tillë narratologjik i personazhit, që e vendos atë në qendër të vëmendjes, krijon një hapësirë të pafund të konceptimit të tij artistik dhe mundësi të shumta

të analizës letrare. Personazhi, në njësitë përbërëse të strukturës sipërfaqësore, lidhet në mënyrë të dukshme me ngjarjen, e cila është ndryshim nga një gjendje në një tjetër. Ngjarje të veçanta kombinohen për të krijuar mikro-sekuenca, të cilat bashkërisht krijojnë historinë, apo, më saktë, filozofinë e plotë.

Te **'***E penguara'* e I. Kadaresë, mendimi i personazhit zbulohet në trajtë pavetore nga rrëfimtari, çka e shpëton personazhin prej vështrimit të njëtrajtshëm nga ana e lexuesit, ndez vatra të papritura vështrimi dhe si rrjedhim, përjetimi ngjitet në nivel më emocional. Ndërsa te '*Përbindëshi'* personazhet i nënshtrohen një narracioni të përzier (rrëfim dhe dialog në mungesë).


Duhet thënë se, me gjithë format e larmishme të zhvillimit të gjinisë rrëfimtare, me gjithë trajtat e zakonshme apo dhe nga më të çuditshmet të formësimit të figurës-personazh, ky është në themel të strukturimit të veprave, pavarësisht nga raportet që ndërtohen midis tij, autorit dhe elementeve të tjera të poetikës së veprës. Prandaj, koncepti mbi *personazhin* mbetet pika kyçe e përpunimit teorik narratologjik, një faktor ***i ndikuar nga strukturat e pafund rrëfimtare****,* por njëkohësisht ***edhe ndikues në to***. Me strukturën dhe thelbin e brendshëm kuptimor të tij, ai 'prodhohet', por bëhet edhe shenjues i rëndësishëm, sepse nxit, kërkon të krijohen lloje të ndryshme të trajtave rrëfimitare, duke qenë ***faktor lëvizës***, që nxit hapësira dhe mundësi të pafund të një procesi të pandalshëm zhvillimi.

Kuptimi gjatë procesit narrativ

Në ç`drejtim duhet hetuar kuptimi i personazhit brenda strukturës së një rrëfimi? Kjo është çështja e parë që është shtruar nga teoricienët e narratologjisë. Një ndër propozimet (M. Bal) është që ky vëzhgim të bëhet në 'pasqyrimin e serisë së ngjarjeve', që do të thotë se rrëfimi zbërthehet në ngjarje, të cilat mund të studiohen sipas pozicionit të tyre në raport me njëri-tjetrin. Kështu ndodh, për shembull, në romanin '*Goja e botës'* e Z. Çelës, ku rrëfimi përbëhet nga një numër pjesësh që ndjekin njëra-tjetrën: ai ka një strukturë gjatësore të kohës dhe të veprimit. Ky këndvështrimin 'horizontal', që ka të bëjë me rrjedhën e një 'seri ngjarjesh' (aksi *sintagmatik)*, nuk mund të jetë i mjaftueshëm për të njohur personazhin, prandaj del në plan të parë pasqyrimi serisë së ngjarjeve, parë në prerje vertikale, ku analiza kalon nga *shenja* te *domethënia* e personazhit. Pra, qasja ndaj figurës-personazh mund të bëhet sipas parimesh që e realizojnë analizën narrative në mënyra të ndryshme, ose *horizontalisht,* ose *vertikalisht*, ose *sipas të dy qëndrimeve*. Fakti që struktura narrative e veprës letrare është krejt e ndryshme nga strukturat që organizojnë llojet e rrëfimit historik, biografik, publicistik etj., nxjerr në plan të parë rëndësinë e njohjes së specifikave të brendshme të saj, të parimeve strukturale që kanë formësuar romanin, në rrjedhat e zhvillimit historik të tij. Në prozën tonë këto parime janë shpesh të ndryshme midis formave klasike, ku struktura narrative ngrihet si një sekuencë e ngjarjeve (një pjesë e mirë e romaneve të letërsisë sonë) dhe prozës moderne (sidomos postmoderniste), ku braktiset rendi, synohet mohimi i mbylljes së strukturës dhe realizimit të një kuptimi të qartë. Vepra të tilla, që nuk i referohen një referenti real ka disa.

Proza jonë, sidomos e para viteve `70, ngrihet mbi strukturën tradicionale, me një rrëfim që zhvillohet përmes fazash të qarta të konfliktit dhe krizave të personazhit. Por ndikimi i prozës moderne, ku mbizotëroi koncepti se rrëfimi nuk mund të jetë një integritet struktural nga fillimi në fund, solli eksperimentime. Synimi drejt një fundi 'të hapur' (term i përdorur nga Wallace Martin…) i dha një formësim të ri personazhit, i cili brenda strukturës narrative shfaq një fizionomi me referencë të paqartë, apo trajtë jo normale. (Kjo ndodh në romanet postmoderniste të viteve të fundit).

Meqenëse formësimi i figurës-personazh realizohet në kompleks ngjarjesh, pavarësisht rendit të lidhjes midis tyre, bota e brendshme e tij dhe marrëdhëniet reciproke me personazhe të tjera marrin kuptim pikërisht prej thelbit të ngjarjeve, gjithnjë si një proces. Procesi është ndryshim, zhvillim dhe parakupton një vazhdimësi kohore… Kur personazhi lidhet me një ngjarje kyçe, zë vend në një hapësirë të kohës në të cilën ngjarjet kanë qenë ngjeshur, në një çast të shkurtër të kohës jeta e personazhit merr një kthesë vendimtare. Shembujt janë të shumtë, si në romanet e Kadaresë, të Kongolit, të Tufës etj., ku është e qartë se rrëfimtaria e tyre është një proces, por, njëkohësisht, brenda romaneve edhe çdo ngjarje është në vetvete një proces, pjesë e një procesi më tërësor dhe kompleks. Brenda këtij procesi ('*Dimri i madh', 'Nata është dita jonë' e R. Qosjes, 'Ngjizja e papërlyme'* e A. Tufës etj.) një sistem personazhesh bashkëjetojnë, kundërvihen… në pozicione të ndryshme, duke u formësuar dhe, njëherazi, duke konkretizuar ciklet narrative në strukturën e rrëfimtarisë tërësore, e përbërë nga ***struktura e brendshme*** e veprës letrare, e cila, në sajë të vetisë së shumëkuptimësisë së fjalës, mund të shfaqet përmes formave të ndryshme të ***strukturave sipërfaqësore***. Në strukturën narrative të këtyre romaneve, dhe të tjerave, duket se në plan të parë është struktura sipërfaqësore, që ka të bëjë me vazhdimësinë e aksioneve, ose dimensionin sintagmatik, por, që në fakt, i përgjigjet strukturës së thellë, që ka të bëjë me filozofinë e veprës (terma të përdorur nga M. Wallace). Në dy nivelet vepron personazhi, në qendër të çdo rrëfimi është një *aksion* dhe një *realizues* i këtij aksioni. Në këtë kuptim personazhi është pjesa e domosdoshme e strukturave narrative, sepse është mbështetës i funksioneve narrative dhe njëkohësisht është i kushtëzuar nga vendi që zë në strukturën e të rrëfimit. Duke qenë se të rrëfyerit është një fenomen kompleks, shumë i gjerë, i larmishëm, pozicioni dhe roli i personazhit në të mund t`u nënshtrohet pikëvështrimeve nga më të ndryshmet: historike, antropologjike, psikologjike, hermeneutike, strukturaliste e semiotike, ideologjike etj. (*Nga një punim më i gjatë*)



Fazli HAJRIZI

NJERI ME VLERA UNIKE

Latif Berisha, poet me vetëdije të lartë kombëtare, pedagog i pashoq, studiues i thellë, pajtimtar i urtë.

Njëzet e gjashtë vjet më parë, pikërisht më 24 mars 1999, kriminelët serbë e vranë në shtëpinë e tij në Mitrovicë njeriun e mrekullueshëm, poetin, studiuesin, mësimdhënësin Latif Berisha. Ai ishte një emër i njohur i letrave shqipe, poet që solli një prurje të merituar cilësore, studiues i thellë, ligjërues i pashoq në Universitetin e Prishtinës, kryetar i shoqatës së parë të studentëve shqiptarë *"Përpjekja"* në Beograd (1957), kryetar i Degës së LDK-së në Mitrovicë gjatë viteve '90, udhëheqës i Këshillit të Pajtimit në vitin 1990 etj. Koha e rreptë e mortit, koha e shfaqjes a paraqitjes së tij teksa është bashkuar tashmë me frymën, e bën të vështirë të gjesh fjalën më të saktë, fjalën më të ëmbël, fjalën më të bukur për ta portretizuar. Emri i tij në kujtesën tonë lëviz. Lëviz edhe në parafytyrimin tim sepse, si shumë studentë të tjerë, e kam pasur profesor ndër më të dalluarit e më të dashurit, sepse me të pastaj më ka bashkuar jo vetëm fjala për letërsinë dhe artet, jo vetëm të qenit e tij pedagog në Universitetin e Prishtinës në degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Fakultetit Filozofik, jo vetëm profesioni i tij si studiues, por edhe më shumë angazhimi i përbashkët në Lëvizjen e Pajtimit Gjithëkombëtar, pastaj në Kryesinë e Degës së LDK-së, miqësia dhe mallëngjimi që ndanim së toku sa herë gjenim pak kohë.

Ligjërues që i jepte peshë historike e teorike fjalës

Latif Berisha, njeri i durueshëm e i vetëpërmbajtur si asnjë tjetër, ishte profesor i respektuar gjithkund, dekan i dijes letrare dhe estetike, ligjërues me talent burimor, që dinte t'i jepte sa peshë historike e teorike fjalës, aq dhe shprehësi, elegancë, stil, hijeshi. Kjo dije është një enciklopedi shëtitëse mbetur në mbamendjen e mijëra e mijëra nxënësve të Gjimnazit e të Normales së Mitrovicës, të studentëve të Universitetit të Prishtinës, të Beogradit e të Tiranës, ku ka dhënë leksionet e tij mbushur plot njohuri e pasion; ngulitur te shkrimtarët, artistët, intelektualët e kohës, lexuesit e shumtë, kombit. Latif Berisha është ndër poetët e parë shqiptarë pas LD-së në Kosovë. Shpirti e zemra e tij janë derdhur në vargjet e vëllimit "Tufa", botuar para 68 vjetësh, mendja e begatë e profesorit të spikatur është mbjellë në mijëra artikuj, ligjërime, kumtesa; në librat "Lexim letrar" të përgatitur për nxënësit e shkollave të mesme, e gjen të përzgjedhur në gazeta letrare e revista shkencore të botuara dhe të tjera që i ka lënë në dorëshkrim, por që kriminelët serbë, pasi e kanë vrarë, ia kanë djegur bashkë me shtëpinë. Prindërit e pagëzuan me emrin Latif. Gjatë jetës e lartësoi kuptimin e tij, duke e bërë edhe më domethënës. Kudo që punoi e veproi, qe i mirë, i këndshëm, rrezatoi bukuri shpirtërore. Një grimë herë e shoh rrugëtimin e tij në jetë si një trajektore drite, një hapësirë e lakmuar për gjithë njerëzit që i blatohen pasionit të tyre siç ai iu blatua. Atij i shkon metafora "tri gota" dhe po të mos shkruante asnjë vjershë tjetër, pos kësaj që është antologjike, do të mbetej i pavdekshëm në kujtesën e lexuesve. Me rrënjën e gjakut ishte nga fshati Smerkonicë (Qytezë), ndërsa horizonti i mendjes, fisnikëria dhe lartësia e karakterit dhe e dinjitetit njerëzor, së toku me aftësinë e tij të jashtëzakonshme për të pushtuar auditorët universitarë duket sikur paraqitnin edhe metaforën e qenies dhe të mendimit të tij të shtrirë në mbi 50 vjet studime, botime, veprimtari kritike, pedagogjike, atdhetare. Mendja dhe shpirti i Latif Berishës qenë të dyja të gjera, të thella, të hapura.

Përpos gjerësisë dhe lartësisë, në studion e tij bujti edhe aventura e guximit teksa u jepte formë qasjeve të tij kritike e analitike. Nuk ishte folklorik dhe dogmatik. Brezi im, dhe të tjerët më pas, u mëkuam nga pena e tij e shkathët, nga mendja e tij e hapur, mësuam mjeshtërinë e shqyrtimit kritik ku idetë nuk duheshin mbytur nën zhguallin e klisheve dhe skemave, as të ftoheshin nga bryma e racionalitetit të tepruar, por të fluturonin hapësirave të çlirëta të asociacioneve sikurse aq hijshëm dinte të fluturonte ai. Latif Berisha ishe modeli i fjalës së zjarrtë, pasionante, i stilit të veçantë, i frymës së kohës. Kishte afinitet të vlerësonte personalitetet letrare artistike. Veprimtaria letrare e Jeronim de Radës, e Zef Serembes, e Naim Frashërit, e Gavril Darës së Ri, e Luigj Gurakuqit, e Elena Gjikës, e Ali Asllanit, e Hil Mosit, e Andrija Kaçiq Mioshiqit, e Zef de Radës e shumë të tjerëve, paçka se koha kishte hedhur mbi fjalën e tyre velin e vlerësimit historik, te lexuesi i Latif Berishës kalonin po përmes portës së frymës së tij. Frymë që shpirtëzonte shumëçka e shumë kë, duke mbetur gjithë po ajo, e ngrohtë dhe e shtrenjtë sa s'ka. Ndjenja e bukur, emocioni i thellë, sqima stilistike ishin tre të parapëlqyerit e tij. Ky ishte modeli më elegant që aso kohe, kur fjala ishte e lidhur nga vargonjtë e robërisë, ne mësuam, vlerësuam dhe pëlqyem nga prof. Latif Berisha.

Rruga më e dashur e tij - ku flitej shqipja...

Kujtoj me mall se si ai ngarendte sa nga një auditor në tjetrin, sa nga Prishtina në Beograd, në Tiranë, tek Ar-

bëreshët e Italisë, në Kalabri e Sicili, te shqiptarët në Sofje, Bukuresht, Stamboll e gjetiu. Ai ishte në rrugë sepse vetë ishe një rrugë. Por rruga më e dashur e tij ishte ajo ku flitej shqipja jonë e bukur, sepse Latif Berisha ishe një selitës i shqipes, ishe zot i kësaj fjale nëpër ligjërata para studentëve, në tubime shkrimtarësh e artistësh. S'di pse ligjërimi i tij kishte diçka përthithëse brenda, diçka si nga magjia apo religjioni, sepse ndoshta vetëm kështu shpjegohet ai interes i madh që dëgjuesit e tij të shumë, posaçërisht studentët e letërsisë i dorëzoheshin situatës hipnotike të komunikimit me të. Rrallë njerëz e kanë këtë veti si ajo e profesorit të larguar, por të paharruar, Latif Berisha. Po, ai ishe një ligjërues i rrallë, i shkallës së parë, sepse e gërshetonte bukur mirë dijen dhe analizën e kthjellët me migrimet nëpër mistikën e artit, në gjëza e referenca estetike, filozofike, në bëma personalitetesh. Kjo lidhej doemos edhe me kujtesën e tij të jashtëzakonshme, e cila mua dhe shumë të tjerë na pati sfiduar qindra herë teksa na tregonte, madje gjer edhe faqen e librit a shkrimit ku mund të gjendej kjo apo ajo gjëzë, ky apo ai emër personazhi, varg poetik, sentencë filozofike, figurë artistike (simbol, metaforë, krahasim, alegori, epitet, hiperbolë). Na habiste se si mbante përmendsh qindra vargje të poetëve tanë të romantizmit e ata botërorë. Mendja e tij ishte vërtet një bibliotekë. Ishte pa qibër, i thjeshtë, zemërhapur, andaj dhe kurrë nuk nguroi të bënte pjesë të vlerësimit të tij jo vetëm shkrimtarë të Rilindjes e veprat e tyre, por edhe autorë të kohës më të re anembanë Shqipërisë etnike.

Që nga fillimi i vitit 1990 e deri kur u nda nga ne Latif Berisha ka qenë kryetar i Degës së LDK-së në Mitrovicë. Ishte një njeri paqësor, një observues politik mjaft i vëmendshëm, mbështetës i projektit paqësor, por, kur e kërkonte nevoja, edhe veprues. Janë të njohura vizitat e tij që ua ka bërë ushtarëve të UÇK-së në Shalë të Bajgorës. Kur filluar bombardimet e NATO-s mbi caqet e ushtrisë e policisë serbe, disa miq kërkuan prej tij që të mos kthehej në shtëpinë matanë Ibrit sepse ishte rrezik dhe mund t'i kushtojë me jetë. Profesori prej se ishte vënë në krye të lëvizjes në Mitrovicë, ishte koshient për rrezikun, prandaj edhe më 24 mars 1999, ishte i vendosur të ndajë fatin e vet me popullin e tij, duke ndjekur në mënyrë të ndërgjegjshme rrugën e rrezikut.

Mes heshtjes e meditimit

Profesor Latif Berisha tashmë është bashkuar me frymën. Prehet në paqen e amshueshme, ashtu siç ishte edhe shpirti i tij: i bardhë dhe i tejdukshëm si ajri! Në njëzetegj-ashtëvjetorin e ndarjes, ish studentët, familjarët, miqtë e shumtë s'mund t'i harrojmë kurrë mësimet, këshillat, të qeshurën e tij me ashkun e shpirtit. Ishe i pangopur me jetën, me gëzimin, se ishte një pionier i tyre. Ata që e kanë çmuar



Prof. Latif Berisha

dhe dashur aq shumë, si miqtë e bashkëveprimtarët, e dinë se ai ishte nga ajo farë që e sfidonte harresën e mortit, duke mbetur pjesë e memories kulturore të shqiptarëve. Fjala e tij, ashtu si pjalmi, diku nëpër sallat a amfiteatrot e fakulteteve, nëpër auditorë universitetesh ka për të pështpëritur në vetmi sublime. Jemi të sigurt për këtë. Ajo ngaherë do të gjallojë në kujtesën tonë, pranë një kafeje a një bisede miqsh; dhe mes heshtjes e meditimit. Të tjerët kanë për ta gjetur në rafte librash dhe arkivash fjalën e tij të mençur, fjalën e dijes, fjalën e ngrohtë, të bukur e të kulluar të shpirtit, fjalën e njeriut që ndërtoi me aq punë e pasion një emër me kuptim të veçantë: i bukur, i këndshëm, i mirë.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, trupi i pajetë i profesor Latif Berishës është rivarrosur në vendlindjen e tij. Në "Lagjen e Minatorëve" të qytetit të Mitrovicës, shtëpia e tij, ku ka jetuar, ende është gërmadhë. Flitet se do të rinovohet së shpejti. Biblioteka e Qytetit fill pas luftës është pagëzuar me emrin e tij.

Në vitin 2004, presidenti dr. Ibrahim Rugova, e ka dekoruar profesor Latif Berishën me "Medaljen e artë të Pavarësisë", për kontributin e dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Në 10-vjetorin e ndarjes nga ne, prof. Latif Berishës, më 24 mars 2009, kryetari i Republikës së Kosovës, prof. dr. Fatmir Sejdiu, e ka dekoruar me "Medaljen e artë të Pavarësisë" familjen e prof. Latif Berishës, në një akademi përkujtuese.



Arbnesha KELMENDI - DRAGA

SI DALLGËT NË STUHI

STUHIA

Në sytë e tu doja të gjeja prehje
Flasin me shpirtin sa herë lëshojnë shikimin
Desha ta shuaj mallin që nuk shuhet
Të të përqafoj
Të qaj e të qeshem
Të ngushëllohem

Papritur fryu stuhia
Përmbysi dëshirat
Ma mori shikimin
Ëndrrat u përzien në pagjumësi
Shiu lagu çdo gjë
Prapë etja s'u shua
U betova
Jam kjo që jam
Nuk di si duhet ndryshe
Lotët nga inati u ngurtësuan
E luftonin me zhgënjimin
Pse të betohem para vetvetes për veten
U ktheva
Aty ku isha nuk mund të kthehem kurrë
Pa ty
Pa ne
Shumë vështirë
Stuhia vazhdon

A JETOHET PA FRYMË

Dashuron
E s'di ç'është ajo
Nuk e di si jetohet pa frymë
Shpirtra të shkëmbyer
Janë ndërruar rolet
Flasin me emër tjetër
Sa kuptohen nga mllefi
Zjarri ndizet flakë
Akuzojnë veten
Mallkojnë fatin
Ku ishin më herët
Ajo pushonte sytë
Në kaltërsinë e detit
Kur fliste bërtiste
Por dhe buzëqeshte

Sa bukur i qeshte fytyra
Zëri i shkonte në qiell
Kur qeshnin bashkë
Dashuria pret ata sy
Ajo më e çmendur se dashuria
Më e vendosur se kurrë
Të dënojë veten
Mezi pret të prekë kaltërsinë
Nuk di se ç'është dashuria

ZGJOHEM

Në mëngjeset e hershme
Kur gjumi tërbohet
Si dallgët në stuhi
Mendja shkon te ti
Zgjohem
Ditën marr në krahë
Bëhem bashkë me shumë zemra
Lutem për ty
Ato për të dashurit e tyre
Lutjen e bëjmë bashkë
Kthehem te vendi yt
Pushoj veç trupin
Mendja bëhet rrugaçe
Dikur vonë
Lodhet e kthehet
Në gjysmënjeri - gjysmërobot
Lutet të dalë
Në ditën e re përsëri

ME DUART E MIA

Mbyta dëshirën
E dashurinë
Ëndrrën e jetës
Tash a më dënon kush
Më shumë
Sesa unë veten
A është dënimi
Më i tmerrshëm se mosbesimi
Sa pyetjet iu bënë "vrasëses"
Herë pohon
Herë mohon
Më shumë hesht
Me veten nganjëherë flet

Nuk durohet të luhet me ndjenjën
Kurrë më e fortë s'ka qenë
U dorëzua para murit të heshtjes
Duke mbrojtur veten
Ik tash tha
Mos prit kthimin
Te dera me emrin e saj
Me mijëra herë t'i tha fjalët
Prapë zgjodhe dyshimin
Mbyte dashurinë e jetës

Ajo pështpërit
Më mungoni
Ti dhe vetja ime
As me veten
Nuk di çka të flas më

FJALA

Lidhi vetminë
Me vargun e pritjes
Kurorëzoi me zjarrin e syve
Zemrës
Trupi u bë hi
Me një grusht u mblodh
Të ruhet trofe
Kujtim i trishtë
Sytë u mbytën në sytë e vet
Herë zmadhohen
Herë zvogëlohen
Derisa humbin
Duke fshehur dhimbjen
Jotja të mos zgjohet
Humbi ndjenjën e shpresën
Inati shoku më i mirë
U deh nga dyshimet
E dehur kërkoja sytë
Të t'i kthej

U lavdërove për forcën
Harrove
Forca isha unë
Ishe ti
U mësuam
Verbërisht t'u rezistojmë
Betejave
Fjalëve jo
Atëherë kur s'e pret
Fjala të vret



Idriz Berisha: Pikturë

MOS IKNI

Ku po ikni ju lulet e ardhmërisë
Gjithë këta eshtra që ju flasin
Nga dheu i nënëlokes
Shumica kanë emrin tuaj
I kanë mbytur hienat e Karpateve
Pa qefin e pa dërrasa groposur i kanë
Pa emër pa fis pa atdhe

Ata kanë luftuar për ju për ne
Për të ardhmen
Për këtë tokë
Ujitur me gjak
Na e sollën lirinë
Mos ikni
Mos u bëni mosmirënjohës
Për hir të atyre që ranë për atdhe

Ku po shkoni
Askush s`do t'ju flasë më ëmbël se gjuha e nënës
Mos ikni

Atje
Në vend të bukës
Do të hani dashurinë e tokës arbërore
Shpejt do të harroni gjakun tonë
Mos e helmoni të ardhmen
As nënën më nuk do ta njihni
Kur të ktheheni të humbur

Eshtrat e të parëve po ju lusin
Qëndroni këtu
Shpirti i gjakut tonë



Hysen KËQIKU

ETJE QË NUK SHUHET

RRAP I MADH

Bjeshkë e Madhe e kreshpëruar
Vendlindje viganësh
Në ngrohtësinë e kallur më mban

Vetëm vesa e mëngjesit
T'i freskon buzët eshkë
Në motet e çmendura
Kur kanibalët digjnin autoktoni

Sa herë më vjen më i fuqishëm
Ai kushtrim shqiponje kreshtë më kreshtë
E asaj rojtareje krahhapur
Për çdo rrap rrasë e shkëmb
Në meridianët tanë të grimcuar

Prore kanë etje për një pikë vese
Për atë ndjenjë ushtimë rrapi
Roje besnike e bjeshkëve të larta

Në vegim etjeje që nuk shuhet

Sa kam dëshirë të bjerë shi
Vetëm ai nuk ka frikë nga zjarri
Plasaritjet e buzëve flakë qesin

Bashkë me erën dredh
Hetova se më laget qafa
Balli e duart e mia të hapura
Ndiejnë kënaqësinë e freskut

Nën një rrap degëgjerë
Vërej majat e gjetheve pika kristal

Vë buzët maje një gjethi
Pik pika e shiut në buzën time
Shuaj etje shuaj mall
Sa rrap i madh

BISEDË ME GJYSHIN

Ku ta gjej një mulli
Të m'i bluajë fjalët
Të më dalin të kripura
Riga shiu në një ag rrezeartë

Nuk të flas me sy përdhe
Të flas se e ndiej nevojë shpirti

Unë gjysh para se të vdisje kisha vetëm tri javë
Më kujto nëse të vjen zëri im
Atje ku pushon Ti - në amshim

Mos ma merr për të madhe çka them
Me krenari flas për vdekjen tënde
Plumbi i armikut të kapi në kraharor
Jo si qyqarëve që ikin nga pika luftarake

Po të tregoj o gjysh asgjë nuk kemi bërë për ty
Po ti ke bërë shumë edhe malet e dinë
Dëshmorët nuk ankohen as nuk gjykohen
Ata e kanë vendin e tyre të merituar

Ndoshta o gjysh më dëgjon kah flas e psherëtij
Ndoshta më sheh duke shkruar me sa mall
Për ty o gjysh edhe për vete që më le miturak
Për t'u rritur krenar në djepin e ahishtës sime

Plumbi që ta mori jetën u shpagua shumë vonë
76 vjet më vonë... edhe me shumë rënie heroike
Viti dy mijë u festua me qindra fëmijë
Luftëtarë ishin të gjithë se ishin gjaku yt
Gjaku i nënëmadhes Etlevë

Për t'u kënaqur me Lirinë
Dritën e së cilës e pe në përpjekje
Me grahmat e fundit atje përtej mallit
Njësoj si i mbretit Monun për Dardaninë

NUK JETOHET PA KËNGË

Çeltira mes malesh
Shpesh më duket se më thërret
Unë ia fal praninë time
Pa dorën në dorë
Pa shijen e kalodontit në gojë

Pa dhëmbët e bardhë
"Si gurët e lumit
Fill pas shiut kur po i shndrit dielli"

Nuk janë më as lulet petalehapura

E di kur i numëroje me kusht
"Nëse dalin aq sa them...
...Shpesh dilnin aq sa thoshe
Aq sa ditë i ditonim bashkë
Aq sa psherëtima lëbyrur
Brenda dritës së vetëtimës

Nuk i ka më Çeltira mes malesh
As unë nuk i kam në këtë duhamë

Në pëllëmbët e djersitura
Avulluar rrugëtimit
Pa dorën tënde në dorë
Pas një loje kujtimi rrethkëputur

Krejtësisht njësoj
Si dy bilbila në një degë
Njëri këndonte tjetri dëgjonte

Bilbili këngëtar iku
Iku edhe tjetri pas këngës
E di ai më mirë se unë

Nuk jetohet pa këngë

BIMËSI HIBRIDE

Si zvarranik hap zgërfyej
Qelbin për t'ia shtrydhur
Për ta fundosur vargun idhnak
Se vajtimin s'e duron meditimi

Pak pa dalë në sipërfaqe
Të relievit të përcëlluar
I shpërndahen dhëmbët
Si stërkala të ngrira
Askund gjurmë
Askund shije
Askund psherëtimë

Dikush do të pyesë
Pati këngë apo nëmë
Vargu që nuk e njohu vetveten
U shkri në pellg shullëri
Do të thoshte namëtari
Dhëmb shkërmoquri

U shkërmoq apo u shkokëlua
Si tramak misri në trinën e shtypjes

Bimësi hibride
Mbetur shkapërderdhur
Në vendin e merituar



NË KËTË NUMËR TË "METAFORËS"
PIKTURAT E ARTISTIT E POETIT
MASAR KUPA

Në revistën letrare "Metafora" të LSHK-së, këtë herë janë përfshirë pikturat e artistit dhe poetit Masar Kupa, i cili deri tash ka pasur rreth pesëdhjetë ekspozita të pavarura e të përbashkëta në disa qendra të kulturës e në mjediseve të ndryshme.
Krahas artit pamor, është marrë edhe me artin letrar, që nga bankat e shkollës fillore.
Ka botuar këto vepra: "Motiv zjarri", poezi, 2007, "Imazhe jete", poezi, 2018, "Jeta me imazhe", "Imazh pas imazheve" etj.
Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.



Bariu



Xhemil BYTYÇI

PSE MË QORTON, MOJ?

DUKE PËRKUJTUAR ATË EMËR

Duke përkujtuar atë emër
Në befasi vërejtëm
Një paradigmë

Fërshëllimë gjarpri i kishte hyrë
Lakuriqësi e dukshme

E strukëm paturpësisë
Të përgjumur
Edhe kur dritat e yjeve
Në padurim para tij
U shuan
Pamja e hënës mbeti e ngrirë

Rrugëtim i qumështit
Fije mjegulle
Ku festojnë
Muzat qiellore
Tokës së ngrysur
Heshtjes së kapërdisur

MONOLOG ME VETVETEN

Befasi të këndshme e quaja
Monologun me vetveten
Pak si shenjëtrim i denjë
Të sakrificës për identitet

Nga erdhi kjo kërkesë
Për ç'arsye
Pyesja e pyesja

I shtërngova duart e fatit
Realitet krejt
Përkundrejt pabesia
Më vinte pas

Cilat ishin çastet që pengonin
Triumfin real
Në mot orësh të liga
Zemrash të thyera
Me qetësi vetëmohimi
Ankesa hukamash
Rrugëtimet fatlume

S'mund të gjenim
Hapësirave të humbura
Se kishin kaluar Urës së Gurit
Gurësh të gjakosur
Moteve

THUAJ

A jam unë ai
Ai lis i madh
Mbi kreshta të atdheut

Nën hije atje
Tejlarg
I sigurt qëndroja
Si shkabë mbi shkëmbinj
Mes oshtimash
Zërave e lugjeve
Të fëmijërisë

GJUHËN E LULEVE FLAS

Pse më qorton moj
Kur e njeh dashurinë
Për lule
Sa herë më ke dëgjuar
Gjuhën e luleve tek flisja

Nuk është gjuhë e njerëzve
Që e humbin qetësinë
Kjo gjuhë të jep nder
Ledhatueshëm

MEDALJON ME PIKA VESE

Shpirti yt i pikëlluar
S'kishte asgjë shpërfillëse
Dashuri e heshtur
Pa fat
Pa të drejtë dënesje
Jam medaljon me pika vese
E dashur
Edhe kur nuk më kërkoje
Visare jete
Mbi qafë
Shtrirë t'i kam t'i kam
Ëndje kujtese


Aida MUJA
GJALLICA

E lartë, e bukur, e thepisur
mburojë qytetit i shkon.
Gjallicë, rrafsh i Lumës
me qetësinë e kënaqësinë,
të çlodhin e të relaksojnë.

Me bjeshkët e Pikëllimës,
me rrafshin e verimit në lartësi,
me vazhdimin e bukurisë
plotësim i madhështisë.

Poshtë të rrethon kodrina e Tërthores,
në lindje Tejdrinja në jug,
Ura e Vezirit me lumin Drin
të mbështjellin kaq bukur,
të çojnë deri në muzg.

Në këtë vend të bekuar,
natyra mall për historinë
gjithmonë më bëjnë krenar
emrin tim malësori kuksian!



Motiv nga Gjakova

SIMFONI E JETËS

Muzikë dëgjoj,
magji më duket.
Pentagramet lëvizin
në notat e kohës ulen.
Lëviz jeta pa harruar dëshpërimin tim,
melodia e këngës më jep shoqërim.
Eci krah me stinët
rënduar si era
me vitet e jetës shoqe ngahera,
eci në shi e në të ftohtë me kohën plakem,
me heshtjen mbi supe që më shoqëron orvatem.
Eci me jetën që lëviz,
mendimet e dëshirat të parealizuara
simfoni e gjallë e jetës trazuar çastet m'i ka shoqëruar.
Jetën krejt pa dashje
përqafoj zhurmë në çdo moment,
çast në ëndrra e mendimet shijoj
kapluar me melodinë e simfonisë së jetës adhuroj

V. H. Auden
EPITAF PËR NJË TIRAN

Qëllimi i tij ishte përsosmëria e një lloji të veçantë
Dhe vargjet që thurte ishin të qarta;
E njihte marrëzinë e njeriut si pëllëmbën e dorës
Dhe kishte mani të madhe për ushtri e për flota;
Kur ai qeshte, deputetët e nderuar
shkriheshin duke qeshur,
Dhe, kur ai qante, fëmijët e vegjël vdisnin rrugëve.

Përktheu: **Agron Shala**

Mirlinda LATIFI
T'IA KTHEJMË BUZËQESHJEN FYTYRËS

Në këtë natë të bukur vjeshte,
Ku yjet ndrisin lart në qiell,
Thirrja e muzës të bën për vete
Dhe koha e vrenjtur bëhet diell.

Valë emocionesh më pushtojnë
Kur penës të shkruaj i jap liri,
Mendja si zog i lirë fluturon,
Me imagjinatën e ëndrrave pa kufi!

Poezia, ky zë i fshehur i shpirtit tim
Shpreh ndjenjat e zemrës që më tundon,
Me vargje mistike e melodi pambarim
Për qetësinë shpirtërore që mungon.

Të frymëzohemi nga bukuritë e jetës,
Pareshtur të qëndisim vargje, poezi,
T'ia kthejmë buzëqeshjen e vrarë fytyrës,
Poezia është vlerë që nuk njeh kufi.

TRIPTIK PËR JETËN
BUZËQESHJA

Buzëqeshja është si dielli që rrezaton çdo anë,
Mrekullia e saj të gjithëve na madhështon,
Njeriu ndihet i qetë kur buzëqeshja e përshkon,
Është fuqi magjike, dhuratë që s'shteron.

LOTI

Kur loti pikon nga syri, rrëshqet si shiu mbi tokë,
Ua shpërfaq dhimbjen zemrave që lëngojnë,
Por s'është veç dhimbje, ai shpreh edhe gëzim,
Loti i pastron zemrat nga çdo pikëllim.

PAQJA

Kur në shpirtin tonë paqja gjen strehim
Shtrin pushtetin e saj në frymën e dashurisë,
Ajo ndërton ura mes të bukurës e harmonisë
Na shpie të sigurt në rrugën e ardhmërisë.

BOTIME

DASHURI E PËRJETËSUAR NË VARGJE

Duke lexuar vëllimin poetik "Dashuro një minutë" të poetit Sejdi Berisha

Sejdi Berisha është njëri ndër poetët, shkrimtarët, dramaturgët, që i takon brezit të tretë të krijuesve të pas Luftës së Dytë Botërore. Ai bën pjesë në grupin e poetëve më të shquar të këtij brezi në letërsinë tonë. Në krijimtarinë e tij poetike, frymëzimi i dashurisë zë një vend të veçantë, si për nga përmbajtja ashtu dhe për nga realizimi artistik. Poezia e tij, kushtuar dashurisë ngërthen në vete veçanti si në aspektin e procedimit krijues, ashtu dhe në atë të realizimit artistik që e dallon nga të



tjerët. E tillë është përmbledhja me poezi "Dashuro një minutë", titull ky mjaft simbolik, domethënës me rrezatim shumështresor emocional, që ngre dimensione të thella të botës së poetit, të shprehura me këto vargje kuptimplote në fillim të poezive:

Mjerë ai kush nuk di
Sa i madh është shkrumbi
Sa i rëndë loti
Sa e etshme lumturia
Për dashuri
("Përkushtim")

Teksti dhe nënteksti poetik i vargjeve të sipërshënuara paralajmërojnë diç të rëndësishme, shqetësuese në relacionin e dashurisë ndërmjet të dy të dashuruarve. Atyre u mungon apo u tepron dicka që nuk e duan, por ballafaqohen me të papritur e pakujtuar, e cila u shkakton dhembje, lot e nostalgji.

Një imazh dashurie

Vetë titulli i librit është mjaft interesant, që të kredhë thellë në shtjellën e mendimeve, duke të bërë për vete. Edhe pse është mjaft konciz, i qartë, por dhe provokues. Ai shpreh dhe simbolizon një imazh dashurie që nënkupton se në jetë, dashuria qoftë edhe një minutë, apo edhe më gjatë ia vlen të dashurojë e të përjetojë subjekti lirik, por nëse dashuron me tërë qenien, me ndjenjë, zemër e shpirt, atëherë nuk mund të dashurojë dy herë:

Ti lindja ime
Ti vdekja ime
Ti jeta ime
("Kur të vjen...")

Kjo dashuri, në të gjithë fjalorët e gjuhëve të botës, është më e bukura që e ka krijuar natyra dhe njeriu, ngase me të fillon dhe mbaron çdo gjë në rrugëtimin jetësor. Poezia që i dedikohet këtij rrisku të dashurisë, qoftë reale apo e imagjinuar, është më e bukura nga të gjitha llojet e poezisë. Këtë poezi më së tepërmi e shquan bukuria, butësa, joshja e shprehur me gjuhë të ëmbël engjëllore që funksionalizohet me anën e mjeteve stilistike, sidomos të epiteteve, të krahasimeve dhe të metaforave të zgjedhura. Pra, kjo gjuhë e bukur poetike, që buron nga shtresat më të thella të botës së brendshme të poetit kushtuar dashurisë, shpreh kënaqësi, takime, ndarje, dhembje e përmallime të pafundta. I tërë ky imazh e mesazh poetik në vargjet e Sejdi Berishës realizohet me anë të mendimit të peshuar, ndjenjës së zjarrtë dhe shprehjeve të artikuluara mirë metaforikisht. Në këto vargje të dhembjes e të dashurisë, bota shpirtërore e poetit është e trazuar, ajo ngjason me shiun pranveror:

E ti s'je afër meje
Shiu pranveror
Syrin ma përvëlon
Më shpëto të lutem
Qaj me lotin tim
("Ti qaj me lotin tim")

Dashuria është zjarr që ndizet me dëshirë, por që djeg edhe pas shuarjes, hiri i saj të shkrumbon gjatë. Dashuria e vërtetë, thënë me gjuhën poetike, është e fuqishme, të gazmon, të ligështon, të bën për vete gjatë dhe kurrë nuk të braktisë. Pra, të dashuruarit i bashkon, i bën *një*, por në këtë *njësim* ndijor ka kënaqësi, ka ngadhënjim, ka hidhërim, takim, ndarje, dhembje, pikëllim, madje jo rrallë edhe dështim:

Sërish zëri yt s'më lë fjetur
Më thuaj ?
Ku takohemi
Në gjirin tënd
Apo në zemrën time
("Kujtim")

Ndodh kështu me poetin, pse vetë jeta është dashuri dhe dashuria është jetë. Andaj, poezia që i kushtohet këtij rrisku jetësor u përngjan valëve të detit që herë vijnë të qeta e herë të vrullshme, dhe pas vetes lënë brigjeve: kujtime të shumta, të paharruara pritjesh, takimesh, vendtakimesh, përshëndetjesh, ndarjesh pa lamtumirë, që me vonë bëhen gjeometri dhembjesh e përmallimesh.
Kështu ngjet edhe me poetin e vargjeve të dashurisë:

Dashuro një minutë. Për ethjet e puthjeve
Për dridhjet e takimit
Kthehu nën pishën plakë
Së paku të qajmë bashkë
("Frymëmarrje")

Ku ka jetë, ka dhe dashuri


Filozofët e poetët thonë se aty ku ka jetë, ka edhe dashuri. Dakord. Por ka edhe dashuri të penguar, e cila është shumë më e fuqishme se ajo e lirë, atëherë ajo bën mrekulli, thyen drynat e dyerve, përbiron muret e ngritura dhe vjen në kohën dhe në vendin e caktuar, ndaj poeti klith thellë në vete: "*Edhe nëse është pas shtatë dyerve*", do ta bëjë takimin e përqafimin. Këto dëshira, grishje, vuajtje e dhembje të poetit janë në shërbim të dashurisë, të cilat e frymëzojnë për një dashuri të sinqertë të gjithëjetshme. Në fushën e poezisë të shumtë janë poetët kombëtarë e ndërkombëtarë, të cilët kanë thurur vargje për dashurinë që nga kohët më të hershme deri më sot, madje nuk ka poet as poeteshë që nuk ka shkruar vargje për dashurinë, qoftë si përjetim, kënaqësi, qoftë si lëndim, hidhërim, apo përmallim. Sejdi Berisha, ndarjen nga e dashura e përjeton rëndë, nuk mund të pajtohet me fatin, ndaj i duket vetja se i përngjan shiut që në dritare qan e rënkon pa ndalur:

Pse kaq gjatë bie shi
E, unë rri në dritare
Me sy valë
("Pritje")

Sa ka lule e ngjyra në pranverë, aq ka edhe frymëzime të dashurisë në vargjet e përmbledhjes "Dashuro një minutë" të Sejdi Berishës. Ai me tërë qenien e tij, klith i dashuruar: *"Po qe se mundesh / Vdis për t'u ngjallur në mua",* gjë që nënkupton se plagën e dashurisë nuk e shëron asnjë bar tjetër mjekues, përveç nektari dhe aroma e dashurisë, e cila dashnorëve u mungon për shkaqe të njohura e të panjohura. E, veprat më të mira të dashurisë shkruhen kur ndizet zjarri i tyre ose edhe pas shuarjes së tyre, atëherë kur drurit të gjelbër i bien gjethet dhe e kaplon verdhësia...

Një përmbledhje e veçantë

Në fund mund të thuhet se dashuria në vargjet e përmbledhjes "Dashuro një minutë" e Sejdi Berishës



është e veçantë, ajo shquhet për nga ndjenja e sinqertë e poetit kushtuar dashurisë. Fati i dashurisë së tij në shumëçka përngjan me atë të poetit arbëresh, Zef Serembe, të Lejles dhe të Megjnunit të Fuzulit në poezinë e orientit, "Vuajtjet e Verterit të Ri" të Gëtes në atë gjermane etj.
Në bazë të vargjeve të kësaj vepre, lirshëm mund të thuhet se ky poet nuk dashuroi me mendje e zemër, i vetëdijshëm se mendja harron, zemra ndalon, por me shpirt, që as nuk harron, as nuk ndalon, por jeton dhe përjetëson dashurinë. Pra, Sejdiu dashurinë e tij e ligjëroi me elokuencë dhe pavdekësoi me anën e këtyre vargjeve poetike e sintetizuese, që mund të merren si epitaf, kujtim i jetës dhe i veprës së tij: *Po qe se mundesh / vdis për t'u ngjallur / se prapë je në mua* ("Edhe pa fjalën time").
Mesazhin që shprehin vargjet e lartcituara të këtij poeti e paraqesin dhe e determinojnë më së miri: dashurinë e (pa)dashuruar të këtij poeti, e cila jeton dhe nuk vdes në të dy botët.

Prof. Dr. Adem ZEJNULLAHU



Behram HOTI

KOSOVË O LULE ZJARRI

I.
Kosovë o Nëna jonë
Kosovë o tokë e vuajtur
Kosovë o tokë e kuqe
Kosovë o Gur i ndezur
Kosovë o Ari o hekur
Kosovë me zemër kristali
II.
Kosovë tokë Dukagjini
Kosovë tokë Kastrioti
Kosovë o flakë baroti
Kosovë o djep Dardani
Kosovë o tokë e Bogdanit
Kosovë e Palit t'Hasit
Kosovë e Adem Jasharit
III.
Kosovë Dhekuqe me eshtra
N'ty u farkuan shiqeta
Mullinjtë eshtrat t'i bluan
Rrufetë natë e ditë t'gjuan
Klithmat n'ty nuk pushuan
Trupin ta dërrmuan furtunat
Kokën ta shkurruan në gjak
T'qëlluan n'kokë në krah në sy
Shekujt ujqish o shekujt e zi
Kosovë NËN-o Flokët me gjak
Fëmijët i rrite pa këmishë pa lulak
IV.
Ditë e natë me sy në frengji
Truallin ta lavruan medet
Me qengja tu t'ri ujqit e zi
Ti Kosovë me plis mbi kry
Qëndrove në n'Ballkan Histori
V.
Kosovë tokë e kuqe dhebardhë
Kosovë tokë me pishë me arrë
Kosovë tokë me legjendë n'ballë
Kosovë tokë me hitha në bark
Kosovë me pemë mollë e dardhë
VI.
Kosovë t'preu shpata e Sulltanit
Kosovë të mbuloi flaka e tymi
Kosovë e Idriz Seferit e Boletinit
Diell e qiell Tokë e Dhe Kushtrim
Kosovë o Pishë e Bac Bajramit
Kosovë o këngë e Zhuj Selmanit
Kosovë o Jetë e Hasan Prishtinës
Kosovë o Besë Shotë e Azemit
Ahmet Delia Meha i Prekazit
Sakicë mbi vetullë - Lulen e ballit
VII.
Kosovë me kortezhe e funerale
Kosovë me maltretime e burgje
Kosovë e Mësuesit Shaban Jashari
Kosovë e Flamurit Poet Grejçevcit
Kosovë Lis Rezalle me Pisha Gur e Male
Kosovë me Tirq e Plisa Kosovë me këngë
E me Besë Shqiptari
Kosovë me Diell me Lule Zjarri
Kosovë e Adem Jasharit

POETI DHE RAPSODI

Po dridhet bjeshka n'Kull t'Flamurit
Po ia shtrin dorën vëllau-vëllaut
Po dridhet mali po dridhet vërria
Në barkun e nënës po gëzohet fëmija
Kush na hyn me sherr n'oborr
Nuk i lëmë as vend për vorr
Qëndresa jonë - guri për gur
Besa e jonë - Besa mbi Flamur

ÇIÇAVICA

Çiçavicë nyje në mesjetë
Mugulli shortin e Bleron
Zogu-Zogut ditë i këndon
Rrënja Lisin e jetëson

Lisi ka sall një jetë
Çiçavicë nyje në mesjetë
Çiçavicë bjeshkë në Drenicë
Udhë e gjatë he gjarpërore
Me përpjetëza e teposhtëza
Mugulli në bunga degëmëdha
Me syshqyer e me buzë t'çara
Kush e preu Bungun e Parë
Degëthyer krasit n'fytajë
Kohë Pashiqit në Murtajë
Çiçavicë me sygaca-cunga-bunga
Vidha çerdhe lenda gur rrudha
Këndon një qyqe në atë verr
Err e terr me diell në kerr
Ta prenë mrizin te kroi
Ta mësoi emrin Anadolli



Heroi legjendar Adem Jashari

Mal me ujë mbi dhe Bucina
Dheun ta puthi Azem Galica
E pas Azemit Mehmet Gradica
Çiçavicë e streha jonë
Lisat te vranxhi n'martina
Për gjithë jetë rruf në Gurra
Ti nuk shterove ke shumë Curra
Ku ka lisa ka kulla burra
Burrë Kosove Shaban Polluzha
Ti i dhe ujë e i dhe bukë
Me janxhik e basin krip
Plis mbi kokë japanxhë n'shpinë
Epopeja për Arbërinë
Udhë e gjatë he gurore
Çiçavicë Drenicë Arbërore
Këtë këngë ty ta fala jetë
Çiçavicë nyje në mesjetë

Fadil H. CURRI
GJERGJ KASTRIOTI

Pallën në dorë sa herë shtrëngonte,
Sa herë e tundte ajo vringëllonte,
Me fuqi trimëri besë e burrëri,
Fitore çdo herë i sillte vendit të tij!

Bashkoi bukur fjalën me urti,
Djepin me djep e syrin me sy,
Bashkoi Toskë e bashkoi Gegë,
Bashkoi Komb e bashkoi Fe,
Në Sofrën e madhe Atdhe!

Mbrojti traditën besën e Mëmëdheut,
Mbrojti nderin e Zonjës Evropë,
Mbrojti racë e mbrojti Fe,
Në tokën e Arbërit i Madhi Skënderbe!

NGA KOSOVA DERI NË INDI
(Nënës Tereze)

Të varfërve e të sëmurëve
Sa shumë u ndihmove!
Me duart e tua të bardha
Të sëmurët i shërove!

U ndihmove edhe të uriturve
Moj dritë kandili e xhevahire,
E lindur nga ky komb
Me prejardhje të lashtë Ilire!

Me ty, anembanë bota
Ishte shumë krenare,
Dole nga rrënja e lashtë
E tokës iliro-shqiptare!

Që nga trojet tona
E deri në të largtën Indi
Fale shumë buzëqeshje
Dhe shumë dashuri,
Nënë e bekuar
Shën Tereza ishe ti!

EPOPEJA E MËRGIMIT

Një ndihmesë me vlerë në publicistikën shqiptare paraqet vepra "Ikja e madhe" e shkrimtarit Albert Zholi

Tani është bërë më e prekshme. Janë pikërisht këto faqe libri të autorit Albert Zholi, që na sjellin kaq afër, kaq përmbledhtas, atë epope mërgimi që përfshiu gjithë tokat e Shqipërisë me fillimin e dekadës '90.



Fundshekulli XX e rrudhi edhe njëherë Atdheun tonë. Edhe ashtu i pakët siç ka qenë, me pjesë të tëra territori e popullsie të ndarë nga trungu, kur priste t'i rritej shtati duke u bashkuar me Kosovën martire, ky dhe u mpak nga njerëzit që po i iknin, shumica pa kthim. Kjo lëvizje popullsie në drejtim të shteteve të perëndimit e kryesisht drejt Greqisë, në fillim ngjau si gëzim pas ndrydhjes së gjatë nga shteti totalitar: pastaj, kuptimi i mërgimit e ktheu ikjen në tragjedi, ndërsa tani gëzimi dhe tragjedia kanë depërtuar te njëra-tjetra fatalisht dhe përjetohen me ankth. Sepse të shumta kanë qenë humbjet, vdekje të ndryshme, por më shumë tragjike e të parakohshme.

Vdekje nga krimet, por edhe nga përpjekja e stërmundimshme për të arritur "tokën e premtuar". Autori me një analizë të plotë të të gjitha shkaqeve që çuan këtë shkulje të rrënjëve shqiptare, na sjell pamje, episode e ngjarje rrëqethëse, që shoqëruan dhe vazhdojnë të shoqërojnë këtë emigracion të paparë në histori për përmasat, popullsinë e vendit, dhe kohën e shkurtër. Libri "Ikja e madhe "është gjithashtu një pasqyrë e historisë së marrëdhënieve të vjetra e më të reja midis Shqipërisë dhe Greqisë, këtyre dy vendeve ballkanike, të cilat vërtet shumë ngjarje i kanë bashkuar, por kanë mjaftuar edhe pak syresh që të inspirojnë ndjenja armiqësore e skepticizmi. Vetë dyndja e emigrantëve drejt Greqisë krijoi përsëri një klimë të re, diku mirëkuptimi, diku mosbesimi, thotë autori, por ai ka shpresën se ashtu si shtrëngatat e qindra shekujve nuk i shpunë kurrë këta banorë të vjetër në luftë midis tyre, edhe kjo lëvizje e re do të jetë vetëm një urë miqësie.

Autori nuk pretendon të ketë përshkruar gjithçka nga peripecitë e shqiptarëve në rrugën e tyre drejt Greqisë e në Greqi. Duke jetuar e punuar në Athinë, A. Zholi rreh të tregojë për jetën e "athinjotëve";iptarë, hallet problemet, rritjen e mirëqenies së tyre ekonomike, por edhe përndjekjet, përbuzjen dhe mungesën e arsimit të fëmijëve të tyre në gjuhën amtare. Ai nuk harron t'u drejtohet edhe studiuesve arvanitas për të hequr një paralele të qartë midis emigrantëve të kahershëm shqiptarë dhe tani në kohët moderne. Të gjitha ngjarjet në emigracion autori nuk i ka ndarë asnjëherë nga zhvillimet e fundit në Shqipëri. Duke e vendosur veten në krah të ndryshimeve demokratike, ai tregon zhgënjimin e madh që i pushtoi emigrantët për politikën mediokre, amatoreske të qeverisë shqiptare ndaj gjithë zhvillimeve ekonomike e shoqërore, por sidomos për mospërfilljen totale ndaj emigrantëve. Shembja e të ashtuquajturve skemave piramidale, - nënvizon A. Zholi, përbën shembjen përfundimtare të besimit të shqiptarëve emigrantë në qeverinë postkomuniste të Berishës. "Ikja e madhe" është një përpjekje serioze për të paraqitur një nga dramat më të mëdha të popullsisë shqiptare dhe nga ky kundvështrim, ai është një kontribut me vlerë në publicistikën e re shqiptare.

Mihallaq QILLERI



Albert Z. ZHOLI

NË KUFIRIN E NDARJES
(Tregim)

Ditë e ftohtë nëntori! Kakavija dhe pse e mbushur me njerëz, dukej si e ngrirë, e ngrirë. Vetëm avuj dilnin nga gojët e njerëzve. Zërat dukeshin sikur ishin trembur nga ai realitet i zymtë, prekës, strukur në ndërgjegjen e tyre, për t'iu përshtatur makthit të padashur të ndarjes. Njerëzit shihnin si të hutuar njëri-tjetrin, duke mos gjetur dot fjalët e përshtatshme të ndarjes. Fytyra të mpira, të vrenjtura, të dëshpëruara, mbushur plot ankth dhe brengë të shihnin sytë gjithandej. Lot ngrirje që të përcillnin në mënyrë të pavetëdijshme një zbrazëti shpirtërore sikur të ndodheshe në një planet të panjohur dhe jo në një pikë kufitare të atdheut tënd të shtrenjtë. Kur ndodhesh në këtë kufi-ndarjeje, kur shikon të valëvitet krenar flamuri kombëtar, natyrshëm në qenien tënde të gëlon një ndjenjë gëzimi që të jep forcë dhe krah që më vonë, po kjo vijë imagjinare e ndarjes kufitare, sapo e kalon, të pret forcat, të deziluzionon, të mpakë, të bën të psherëtish thellë, thellë në shpirt. Asnjë cicërimë zogu nuk dëgjohej. Edhe qentë që na vinin rrotull nëpër këmbë të shihnin si të hutuar duke tundur vetëm kokat dhe bishtin. Të gjithë po flisnim me shikim dhe me kokë. Heshtje misterioze në mes mijëra gjallesash njerëzore. Policët, miratimin apo mosmiratimin e kalimit e bënin me të tundura të kokës. Nga kjo soditje aspak relaksuese, më shkëputi zëri i ëmbël i nënës sime:
- Do të ikësh dhe ti bir?!
- Po, nënë, do të iki!
- Po ti punë të mirë kishe, mor bir…! - dhe psherëtiu thellë, shumë thellë. U mbështet në gjoksin tim dhe filloi të qajë me dënes. Lotët e saj të nxehtë dhe të kripur depërtuan nëpër bluzë dhe lagën gjoksin tim.
- Po ndahemi biro, po ndahemi së gjalli. Dy në Greqi, një drejt Italisë, ne në shtëpi si kërcunj. Unë s'dija ç't'i thosha, vetëm i lëmoja flokët e thinjur. Babai im i mirë, rrinte si i ngrirë me vështrimin tutje në thellësi të Greqisë.
- Do të mblidhemi ndonjë ditë të gjithë bashkë, o bir?!
- Do të mblidhemi, nënë, do të mblidhemi!
- Po kush na ndau kështu, kush…?! - dhe filloi të qajë me zë, duke më pushtuar më fort rreth vetes. Ishim në kufirin e ndarjes në Kakavijë… Disa metra përballë nesh, një vajzë e vogël 5-6-vjeçare mes të qarave thërriste:
- Baba, baba, ktheu mos më lër vetëm! Ndërsa ai po i tundte dorën nga ana tjetër e kufirit.
- Më tej dy të porsafejuar:
- Do të ikësh i dashur …? - dhe dy pika loti si margaritar i ranë faqeve të bukura. Po ne s'ndenjëm as… - dhe shikon me turp nga prindërit.
- Një nënë tjetër:
- Mos më harro, bir i nënës! Të lutem, vetëm letra dhe zërin në telefon duam, asgjë tjetër! - dhe kafshon buzën për të ndaluar lotët. Dhe, ja … Hapet një portë. Një portë hekuri. Kaluam një prag. Pragun e një porte të ftohtë, që ndante dy shtete, dy botë. Andej nga ne ankth, dhimbje, braktisje, toka djerrë, lot. Këndej këngë, gjelbërim, punë. Ne, shumë pak po e kalonim këtë portë, shumë të tjerë kalonin për te bota e ëndrrave duke kaluar male të thepisura, gryka të mbuluara me borë, pyje me egërsira, dete të ftohta dhe të mjegullta, lumenj të rrëmbyeshëm…
- Shkonim të gjenim parajsën…E gjetëm?! Mbrapa linim lot…!

Çezare PAVEZE
QYTET NATËSOR

Një poet përshkoi
mes për mes oqeanin vezullues
prej guri e çeliku
të qytetit natësor.
Gjatë rrugëve ulërijnë
teksa thyhen në plasje
forca të pashtershme,
lumenj të qetë yjesh
që çmenden në vorbulla.
Poeti përshkon
gjithë qiellin e natës
me gjeste të mëdha, si ai që përleshet.
Një burrë që bie mes yjesh
do t'i mbyllte kështu grushtet
nga ankthi në tëmtha
duke regëtitur në ritëm.
Në brerorет e dritës
poeti u matet në delir
uraganëve kozmikë të forcës
së qytetit natësor.

Shqipëroi: *Zija Vukaj*


Botime

NJË PUBLIKIM PLOT DINJITET – ATDHETAR E ARTISTIK
BSHASH i "Zëri i mërgimtarit", Novara, Itali, 2025.

Kur lexon deri në fund librin "Lulëkuqet e globit", me krijimtari për fëmijë, një libër i shkrimtarëve dhe i artistëve shqiptarë në Novara të Italisë, mendja të shkon në ato vite të Rilindjes së vërtetë shqiptare, kur botoheshin libra shqip sa në Sofje, sa në Bukuresht, sa në Athinë e sa në Stamboll. Ishin kohë të tjera dhe mendësi të tjera, por ja që në Novara të Italisë lind shoqëria e madhe shqiptare që bashkon shumë shqiptarë, jo vetëm ata që kanë emigruar në Novara, por edhe shumë më tej. Shoqata "Zëri i mërgimtarit" është një shoqatë që ka lëshuar valencat e saj gjithandej, duke realizuar bashkëpunimet e shumta me shoqata e me njerëz të letërsisë dhe të artit nëpër botë.

Një institucion që ka rreth vetes poetë, shkrimtarë dhe artistë

Të kthehem te libri i porsabotuar "Lulëkuqet e Globit", një libër që të ngjallë shumë emocione në shumë



drejtime. Pyes: "Si ka mundësi që një shoqatë në emigracion të sjellë në publik një libër fondamental me krijimtari për të vegjlit?" Kjo pyetje vazhdon më tej duke thënë se ku i kanë gjetur poezitë për fëmijët autorë shqiptarë të hershëm si Bedri Dedja, Adelina Mamaqi e Pandeli Koçi, apo autorët durrsakë, që unë i kam në qendër të vëmendjes për poezitë e tyre bashkëkohore, por jo për poezitë e tyre për fëmijë? E këta poetë janë Agim L Bajrami, Vladimir Muça, Xhevahir Cirongu, Trandafile Molla, Myftar Gjonbalaj, Urim Mezini, Agim Lika, Eda Miri, Hajri Lamaj etj. Por ajo që më shumë të bën përshtypje, është fakti se si është e mundur që një shoqatë e veçantë në Itali, që ka afruar autorë shqiptarë dhe italianë të botojnë libra në seri?

Botimi i "Lulëkuqet e Globit" është një klithmë atdhetare, një shpirtëzim që do ta kishin zili shumë e shumë shoqata si në atdheun amë, Shqipëri, ashtu dhe në shoqata të tjera të përhapura nëpër botë. Pa hyrë në analizën e këtij libri kaq delikat dhe kaq të domosdoshëm për ditët që kalon jo vetëm shoqëria shqiptare dhe pjesët e emigruara të saj, por akoma më tej deri në diasporat e Amerikës e të Australisë, do thosha se ky libër është abetarja e poezisë shqipe për fëmijë. Kështu do ta quaja me plot vendosmëri. Është produkt i një institucioni të ri, një enti botues të suksesshëm, një institucion që ka rreth vetes njerëz, poetë, shkrimtarë dhe artistë. Ky institucion botues e ka emrin "Zëri i mërgimtarit".

Nuk ka medalje që "të përkufizojë" vlerat e këtij libri

Ja dhe kapitujt që ky libër emeton me plot dinjitet: Poezi për fëmijë nga poetë shqiptarë, poezi për fëmijë nga vetë fëmijët, krijime të nxënësve në artet figurative, prozë për fëmijë nga vetë fëmijët. Nuk mund të komentosh, vetëm lexo dhe medito, kujto fëmijërinë tënde, nëse je i rritur e më tej lexoji këto poezi e proza me nipat dhe mbesat e tua!

Nuk ka medalje që "të përkufizojë" vlerat e këtij libri, nuk ka kritikë që të shprehë kundërshti për këtë libër kaq dinjitoz, kaq të domosdoshëm, që vetë toka e mëmëdheut nuk e ka bërë të ngjashmin me këtë libër. Një vlerë të madhe librit i rritet nga redaktori Hamdi Hysuka ka, nga botuesja Etleva Rrapa, e cila ka bërë një parathënie ekselente, së bashku me Fatmir Gjestilën, për këtë libër. Po kështu dhe botuesi "Lena Graphic " ka merita të mëdha për paraqitjen me ngjyra dhe grafikën e përsosur nga Daniel Zhusti. Të mos harrojmë se është një botim i Prishtinës dhe hyn në bibliotekat e shqiptarëve plot dinjitet, jo vetëm artistik, por së pari atdhetar.

Fatmir MINGULI



Merita KUÇI - THARTORI

PRITMË!
(Ese)

Çdo kohë ka heronjtë e vet. Çdo individ ka një betejë për të fituar, rrugë për të përshkuar. Është e lehtë të dish armikun kur e ke atë përballë. Ke një aspiratë për të qëndruar. Ke përpara identitetin, ke tokën, atdheun, ke nënën, gruan, fëmijët, motrën, ke miqtë, ke përditshmërinë dhe frymën ndarë me të tjerë.
Ky nuk është ritual, është vetë ekzistencë, është jetë dhe nuk është pak. „Jeta ka lindur të jetojë", - thotë e shenjta Nënë Tereza dhe e dhënë në çdo formë, ajo është e shtrenjtë. Po ashtu siç janë edhe idealet njerëzore, që përqafojnë individë apo grupe shoqërore, që çojnë përpara iniciativat dhe kurajën për zhvillim e përparim.
Tashmë aroma e barutit qark botës as nuk është harruar dhe as nuk po i thahet apo largohet era.
Epërsia e flakëve, qofshin luftarake, bakteriologjike, qofshin ato teknologjike, i qëndrojnë si kërcënim njerëzimit, duke i kujtuar gjithnjë se diku, dikush është dhe do të jetë mbi të tjerë.
Kjo të tjerë apo "Tjetra" (apo Tjetri - ferri sikur thoshte Kafka) sikur shkruaj në një nga poezitë e botimit tim më të fundit poetik "Unë jam Ti", "është diskursi i një rrëzimi shpirtëror, ku duhet pranuar se sot veç armëve, përballë nuk luftohet vetëm me krisma, por edhe me "ideologjizma" të moderuara, gënjeshtra me prapavijë afatgjatë, me qasje drejt kopshtit personal dhe pak ose aspak social dhe shoqëror. Vetëm dhe vetëm për veten.
Dhe, kjo është lufta e tragjikes së brendshme, kur thyhesh prej besimit apo dashurisë, kur je i pambrojtur nga errësira që sjell zhgënjimi apo gënjeshtra e falsitetit njerëzor, human.
Të mundesh nga dashuria, përkushtimi apo altruizmi që fal. A është kjo një "metaforë" apo një formë bashkëjetese?!
Kam hasur dhe dëshmuar luftëra të vogla, të ftohta. Luftëra për të thyer, zvetënuar kurajën apo forcën e rrugëtimit, por e mira të troket, të zgjon, të bën të përballesh, të ndërtosh, të bësh përpara. Thonë se e vërteta dhemb, sikur thonë se të vërtetën nuk e do kush. Por ajo ekziston dhe sa më vone t'ia hapësh krahët, aq më shumë lufta e brendshme do ta vrasë njeriun, qëllimin



Motiv nga Gjakova

për të cilin njeriu ecën e frymon në tokë.
E vërteta është e lidhur me fjalën. Sa më e qartë, ëmbël, bukur ta artikulosh, aq më shumë shfaq prirjen, bindjen dhe merr vendin dhe hapësirën në kohë si njeri.
Kam parë, po shoh përditë njerëz që zvarriten, mbahen apo imponohen me letërsinë e tyre mediokre, pa pranuar se sa shumë punë duhet ta bësh krijesën tënde lartparëse, që ajo t'i shërbejë kohës dhe brezave, të edukojë qasje ndaj sakrificave.
Shoh çdo ditë njerëz të letrave që u janë trembur orëve të tyre njerëzore dhe biologjike. Protagonizmi i tyre ngado dhe fasadash të pamerita, të krijon idenë, ndjesinë e largimit nga këto mjedise, por edhe të kundërtën, të rilindë të krijosh gjurmën tënde të pjekur.
Ato duan që me "luftën" e tyre të qëllimshme, t'i bëhen "çati" qytetërimit që në gji të vet mbajnë njerëz me histori madhërisht të thjeshta, zemra altruiste, që nuk i krijuan emrat e tyre enkas që t'ua varin ndonjë rruge apo shkolle, ndonjë sheshi apo pllakate. Ata që krijojnë biografi të paqena, e kanë vendin jashtë antologjive qytetase apo universales, njerëzores.
Njerëzit e vërtetë, krijues dhe të urtë, më shumë se veten, duan veprën e shërbesës, duan që „lufta" e tyre të ngrihet me paqe dhe që ylli i tyre në qiellin e dijes të bëjë dritë për të tërë, për brezat.
Ky është modeli që dua, që ndjek me përpjekjen pozitive për ta bërë të zakonshmen të vlefshme, lehtësuese dhe jetës e luftës t'i përgjigjem: pritmë!



Mimoza EREBARA

RROFSH, O SKËNDERBE!
Një vështrim ndryshe

Nuk duhet të ankohemi më për Heroin tonë Kombëtar sepse me të vërtetë paska pasur edhe një vlerë që ne deri më tani nuk e dinim. Rrofsh, o Skënderbe! Në fakt duhet të ankohemi për vete, për mendjeshkurtësinë dhe verbërinë tonë proverbiale. Mirë ne, populli i thjeshtë, po as historianët, bile edhe "skënderbegasit" (studiuesit e mirëfilltë të figurës dhe të epokës së Skënderbeut), nuk e paskëshin pikasur një dëshirë të kahershme të tij. Po ndoshta për ta ka qenë e vështirë se, të humbur nën malet e fakteve e të dokumenteve, me siguri e kanë pasur krejtësisht të pamundur të hulumtojnë kaq detajisht.

Edhe sikur!... Sikur ne sot kemi vetëm Skënderbeun! Radha e heronjve mitikë, të gjallë e të vdekur, është kaq e gjatë!... Madje ata të gjallët kanë radhën shumë, shumë më të gjatë...

Tek e fundit, ç'u tha, u tha, e ç'u gjet, u gjet për të. E, problemi ynë kombëtar është i zgjidhur përfundimisht dhe Skënderbeu mund të rrijë i patrazuar në sheshin e tij, në të vetmen pronë princërore-demokratike-socialiste. Dhe, ne mund të festojmë pa u ndalur për të, mjaft të mbajmë shënim datat.

Vlera e asaj që u zbulua krejt rastësisht, si të gjitha zbulimet e mëdha, është kaq e madhe dhe e paçmuar saqë më shtyn të ngjitem në monumentin e bronztë dhe të gdhend me germa prej ari stemën e NATO-s. Po, po, stemën e NATO-s. Sepse ky zbulim ka të bëjë pikërisht me një dëshirë të panjohur të Skënderbeut për të hyrë në NATO! Po, po në NATO, por sigurisht, jo në organizatën që njohim ne. Bëhet fjalë për një protoNATO të shekullit të kalorësisë. Fakti i pozicionimit drejt Perëndimit, drejt qytetërimit dhe progresit njerëzor, lufta legjendare ndaj Lindjes është një arsye më shumë për politikanët e historianët tanë për të menduar kështu. Por kjo pa dyshim është njëra anë. Ana tjetër duket paradoksale, në pamje të parë, por nëse mendojmë pak më thellë e më gjatë, do të kujtojmë lehtësisht se brezi i ri (shekulli XXI), nuk duket se është aq i ndryshëm nga ata, të vjetrit (shekulli XV), sa ç'pandehet se është, megjithëse modelet e konsumit tashmë kanë një përmbajtje tjetër.

Dëshpërimi, që rrjedh në mënyrë të pavetëdijshme nga dështimi i një sistemi, ka të njëjtën mënyrë shprehjeje, shprehet po haptas dhe po egërsisht. Nga kjo pikëpamje vlen ky konstatim që na çon patjetër në një përfundim interesant: Shoqëria jonë e sotme, në vend që të ecë përpara, ngelet rob i një modeli foshnjarak, që në themel të genit të saj ka po ato vlera të vetvetes për lirinë e individit, barazinë e vëllazërinë. Një sistem patriarkal i dështuar vlerash përderisa nuk arrihet në një unifikim të plotë, por që mbetet gjithmonë segmentar e fragmentar. I dështuar është ky unifikim segmentar që në themel, në formën e të menduarit, që në këtë rast është tejet i kufizuar. Në këtë mënyrë këto kushtëzojnë njëra-tjetrën, duke na sjellë para situatash krejt të pavolitshme regresi, përderisa modelet që na udhëheqin nuk arrijnë të parandalojnë diktatin dhe katastrofat e mëtejshme njerëzore. Shkurt, kemi pasardhës të denjë të asaj epoke patriarkale, po të lavdishme. "Belle epoque-a" jonë ka mbajtur vetëm pjesën e parë - atë të të qenit patriarkale. Është më e thjeshtë të besosh se je fitimtar, kur në të vërtetë je humbës dhe është tragjike kur mendon se ky qëndrim ndaj këtij raporti përcillet në shekuj me të njëjtin mesazh.

Në fakt flitet shumë për kalbëzimin e kësaj shoqërie, për nevojën e zëvendësimit me një shoqëri tjetër më të përparuar, ku energjitë individuale do të kryenin me të vërtetë një revolucion në konceptet qendrore, larg ndrydhjes politike. Nëse do të ndodhte kështu, atëherë mund të flisnim lirisht se në shoqërinë tonë janë shfaqur impulse të tjera dhe se kjo shoqëri midis dy alternativave të zhvillimit, kalbjes dhe përtëritjes krijuese, zgjedh fuqishëm këtë të fundit. Duke u bërë kësisoj pioniere e një unifikimi të plotë vlerash, larg kufizimit mendor patriarkal. Një kufizim që na bën të ngjashëm konceptualisht, mendërisht si edhe nga pikëpamja e funksionimit të jetës sonë me paraardhësit tanë të shekullit XV.

Por, në të vërtetë, politika jonë është larg këtij qëndrimi dhe këtij shndërrimi konceptual, përderisa ajo në çdo rast vetëm i bën lajka sistemit tradicional të vlerave aq shumë sa në fakt nuk ka bërë gjë tjetër, po veçse i ka braktisur ato. Në këtë rast kemi një përpjekje që një figurë si ajo e Skënderbeut ofrohet në vend të një justifikimi të paaftësisë, në vend të fesë, politikës, filozofisë, aq sa i kalon edhe kufijtë e absurdit kur pohohet se ai, Skënderbeu, ishte pro anëtarësimit në NATO! Qoftë kjo edhe një PROTONATO - nëkupto: Perëndim!

Apo ndoshta jemi në të njëjtën Epokë dhe kjo do të ishte diçka e natyrshme?

Ramë ORACA

LAMENT PËR LULËKUQET

mezi e mblodha një tufë me lulëkuqe
që kanë lulëzuar nëpër fushëvarre
me aromë legjendash

si një etje e pashuar
vetëm shiu ua rrit rrënjën e mallit
të gdhendur në dërrasë të gjoksit tim

s`di ku ta fsheh dhembjen për to
në cilin shesh t`i ndez qirinjtë e lotit
druaj që t`i fik harrimi
më i rëndë se plumbi

i përmalluar me sy nga ura e paudhë
ditët me net më përzihen
përveç lulëkuqeve të mermerta
që frymojnë në zemrën time
ato kallen e nuk digjen
vlojnë e më përvëlojnë
dhe prapë kthehen në kujtim

si një fotografi e brejtur nga koha
ato mbijetojnë brenda meje
dhe çmallem me to
sa herë shkoj ndër varre
i shoh duke buzëqeshur në mermer
fytyrat e tyre që na mungojnë

Mirvete KABASHI - LEKU

RIKTHEVA KOHËN

Sot
U riktheva në kohë
U ndjeva me krahë
E me mall
Si një shqiponjë
Fluturova në horizont
Deri te retë e bardha
Bashkë me muzën time
Dhe melodinë
E valëve të Lumbardhit
Më përshkon shpirtin krenaria
Për rrugët e etjes
Për gjurmët e hershme
Të historisë kombëtare
E gëzuar citoj vargje
Përball flamurit të Skënderbeut
Në odën e xha Ymerit
E Abdyl Frashërit

Minire RUKOVCI - HYSENI

HESHT

Ah, këto fjalët që ngelin në grykë,
as nuk thuhen, as nuk shuhen,
si zjarri të heshtura që digjet ngadalë,
ta çelin mëngjesin herë bluhen, herë zhbluhen.

Janë fjalë që s'i thua se peshojnë shumë,
se po i nxore ndoshta thyhesh vetë,
janë emra që ti nuk i shqipton dot,
se malli për ta të vret e të pret.

Aso fjalësh që rrinë pezull në ajër,
si ata zogjtë që nuk kanë strehë,
fluturojnë pa gjetur një degë,
gjersa krahëkëputur bien mbi dhe.

Me lotët e natës pikojnë pa zhurmë,
si yje që fiken dalëngadalë,
shkëlqejnë një çast në qiellin e shpirtit,
pastaj humbasin në errësirë si valë.

Halil XANI

NË KURBET

Ju pata në prehër tani ju shoh në ekran
Përqafim i ftohtë në dritën e bardhë
Kur hani bukë, më duket i hani rrënjët
Që ju ngelën thellë në këtë dhe.

Zogj të pafajshëm, larg në Perëndim
Po rriteni në një gjuhë që unë s'e kuptoj
Shpresa më thotë zogjtë kthehen një ditë
Me emra që s'janë përkthyer as harruar.

I mungon zhurma oborrit të blertë
Të qeshurat që mbushnin sofrën thërrime
Në ëndërr më vini me çanta në krah
Me mall në sy, më flisni në gjuhën time.

Nëpër albume më zbardhi bora
Flokët e mi u bënë dëshmi malli
Ju po rriteni si lulet mëngjeseve
E unë po plakem me ju në poezi.



Bedri HALIMI

TË DHËNA SHTERUESE PËR NGJARJET E VITIT 1981

Bajram Kosumi, "Revolucioni 1981", "Brezi '81 & Embeta", Prishtinë, 2025.

Studiuesi, shkrimtari, publicisti dhe veprimtari i çështjes kombëtare (ish-kryeministër) Bajram Kosumi, këtë vit doli me librin e radhës me titullin tërheqës "Revolucioni 1981".

Autori duke qenë edhe vetë, jo vetëm pjesëmarrës, por edhe një ndër udhëheqësit e ngjarjeve të vitit 1981, dënohet me 15 vjet burg, ku pjesën më të mirë të rinisë së tij, e kaloi burgjeve serbe.

Kështu, duke i njohur ngjarjet e kësaj periudhe në hollësi, Bajram Kosumi, paraqitet para opinionit lexues dhe studiues, me një libër studimor, kushtuar këtyre ngjarjeve me rëndësi, për historinë më të re të Kosovës në veçanti dhe të popullit shqiptar në përgjithësi.

Rreth ngjarjeve të vitit 1981, janë shkruar artikuj të shumtë, janë bërë komente të ndryshme, janë thurur poezi e poema, janë shkruar tregime e janë thurur këngë nga autorë të ndryshëm.

Për këto ngjarje janë organizuar edhe tribuna të ndryshme politike, kulturore e shkencore.

Por gjithashtu për këto ngjarje janë dhënë edhe komente negative, madje janë shkruar edhe artikuj mohues rreth karakterit të këtyre ngjarjeve, si në vitin 1981, ashtu edhe në vitet në vijim, duke vazhduar në variacione të ndryshme, nga individë të caktuar deri në ditët e sotme.

Siç shihet, e veçanta shtesë e këtij libri është fakti se autori edhe vetë është një nga protagonistët kryesorë të këtyre ngjarjeve, si dhe studiues serioz në fushën e letrave shqipe.

Së këndejmi, autori Bajram Kosumi, arrin të tregojë në hollësi rrjedhën kronologjike të zhvillimit të ngjarjeve, duke i paraqitur ato nga këndvështrimi i shumë pjesëmarrësve dhe i grupeve të ndryshme, që janë marrë me veprimtari të fshehtë atdhetare.

Autori i këtij libri paraqet deri në hollësi çdo kontribut të secilit autor, që është munduar të shkruajë diçka për këto ngjarje, duke e bërë kështu paraqitjen e një analize sintetizuese të burimeve të ndryshme, të cilat i citon me pedantëri.

Moszhvillimi ekonomik i Kosovës

Përpos theksimit të pabarazisë së shqiptarëve në Jugosllavi në çdo sferë të jetës, në këtë libër, autori, arrin të sqarojë se në cilën pozitë të zhvillimit ekonomik ishte Kosova në vite të ndryshme, qysh më 1947 dhe si u bë që nga niveli i zhvillimit të njëjtë me BeH-në, Maqedoninë dhe Malin e Zi, ajo të mbetej vendi më i pazhvilluar ekonomik!

Në këtë mënyrë, nga një nivel i produktit shoqëror dhe i të ardhurave kombëtare për frymë 2 herë më i ulët se mesatarja jugosllave në periudhën pas Luftës së Dytë, Kosova bie në vitet e fundit të viteve të 70-ta në një nivel 4 herë më të ulët. Gjatë të njëjtës periudhë 40-vjeçare, Kosova, e cila në vitet e para të pasluftës ishte në produktin shoqëror dhe në të ardhurat kombëtare për frymë në nivel të njëjtë me atë të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të Bosnjë-Hercegovinës, bie në një nivel 2,5 herë më të ulët në krahasim me këto republika. Kurse në krahasim me republikën më të zhvilluar të Sllovenisë, kjo diferencë u thellua nga 3,3 herë në vitin 1947, në 7,5 herë në vitin 1981 (E. Reuter, Die Albaner in Jugoslaëien, München, 1982, f. 57; "Rilindja", Prishtinë, 1-2 maj 1987, f. 8; aty, 8 nëntor 1987, f. 7).

Rrjedhimisht dallimet dhe prapambetja e Kosovës në krahasim me ekonomitë e republikave jugosllave dhe të Krahinës së Vojvodinës po shkonin duke u thelluar (Kosovo – Past and Present, Belgrade, 1989, f. 183-189, 190-196).

Qasja ndaj mohimit të ngjarjeve të vitit 1981

Autori Bajram Kosumi paraqet të dhëna nga burime të shumta edhe nga shtresa e intelektualëve të proveniencës nga Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, nga Lidhja e Komunistëve të Serbisë, nga Lidhja Komuniste e Kosovës etj.

Përmes shembujve e citateve të shumta, autori shkërmoq mendimin morbid të klasës politike të proveniencës jugosllave se "ngjarjet e vitit 1981, nuk ishin të nevojshme, ishin të dëmshme apo edhe të manipuluara nga shërbime të ndryshme të UDB-së, të Rusisë e deri te akuzat për implikim të Shqipërisë etj."

Nga të gjitha gjërat që gjenden në libër, jo vetëm studiuesi i mirëfilltë, por edhe lexuesi i rëndomtë, por nuk ka se si të mos pyesë kush ishin këta përfaqësues të klasës politike shqiptare në Kosovë, të cilët kanë qenë gjallë në të gjitha proceset e periudhave të ndryshme, që nga pas Lufta e Dytë Botërore në Kosovë, në Serbi e në Jugosllavi? Prandaj, rrjedhimisht edhe lindin pyetjet se sa këta përfaqësues të klasës politike shqiptare, të proveniencës jugosllave, janë bashkëpërgjegjës për mosngritjen e zërit ndaj shpërnguljes së shqiptarëve për Turqi në vitin 1953

me rastin e marrëveshjes famoze turko–jugosllave mes Josip B. Titos e Fuat Kyprilit? Si u bë që këta përfaqësues të shqiptarëve të Kosovës të mos e ngritnin zërin ndaj dhunës së egër të periudhës së Rankoviqit, ku pësuan shumë shqiptarë, duke u dëmtuar rëndë fizikisht? Si u bë që kjo klasë politike në vitin 1968 ta përmendë edhe republikën dhe si u bë që po kjo klasë politike më 1981 të hidhet në sulm kundër rinisë dhe popullit të Kosovës, përkatësisht kundër kërkesës Kosova Republikë, duke i dënuar demonstratat, njësoj si Federata Jugosllave, si Republika e Serbisë, me histeri, llahtari e dëlir?

Për më tepër dhe për më keq, si u bë, që ndonjë politikan me ndërgjegje të vrarë, apo pa ndërgjegje fare, me paturpësinë më të madhe, të deklarojë se studentët dhe populli shqiptarë në demonstratat e vitit 1981 "paskan kërkuar republikë staliniste e enveriste"?

Kush e beson këtë "arsyetim"?


Përderisa dallimet dhe prapambetja e Kosovës në krahasim me ekonomitë e republikave jugosllave dhe të Krahinës së Vojvodinës shkonin duke u thelluar, përse mohuesit e ngjarjeve të vitit 1981, nuk e ngritën zërin dhe nuk iu kundërvunë politikave shfrytëzuese të resurseve të Kosovës?

Prandaj, me të drejtë autori Bajram Kosumi arsyetimet e qëndrimeve të fundit, pos të tjerash, i quan edhe 'enigmatike', ndonëse vetë sjellja praktike në shoqëri, e individëve të tillë, gjatë tërë periudhës sa kanë qenë nëpër detyra udhëheqëse, në funksione të ndryshme, e kanë treguar qartë se sa kanë mundur e sa mund të qëndrojnë 'enigmatike'.

Këtë e dëshmon më së miri, vetë fakti i përfundimit të karrierës së tyre, kur asnjëri nga këta udhëheqës, nuk mbeti i pandëshkuar në forma të ndryshme, madje edhe me burg, nga politika shoviniste serbe me në krye Slobodan Milosheviqin.

Matja e kohës me sahatin e prishur të autonomistëve

Në anën tjetër, Bajram Kosumi është objektiv edhe në çështjen e të arriturave që janë bërë, përmes autonomisë së vitit 1974, duke theksuar se ndër të arriturat kryesore të kësaj autonomie janë: pjesëmarrja në njësimin e gjuhës letrare shqipe, si dhe hapja e universitetit në gjuhën shqipe. Mirëpo, përmes analizës, Bajram Kosumi, heq edhe dilemat e qëllimta, rreth Kushtetutës së vitit 1974. Ai me argumente të shumta u kundërvihet mendimit të individëve të caktuar, që shkruajnë se Kushtetuta e vitit 1974, sipas tyre, i kishte të gjitha ingerencat shtetërore, e rrjedhimisht sipas kësaj logjike, nuk paska pasur fare nevojë për ngjarjet e vitit 1981! Madje sipas kësaj mendësie, këto ngjarje vetëm sa e paskan shpejtuar procesin e marrjes së autonomisë së Kosovës, përkatësisht Kushtetutës së vitit 1974!



Pikërisht në këtë libër, këto gjëra sqarohen hollësisht, edhe për lexuesit e thjeshtë, duke qartësuar se ku ishte defekti i Kushtetutës së vitit 1974; në cilën pikë të kësaj kushtetute Kosova ishte e lidhur me Serbi dhe në cilën pikë ishte e lidhur për Federatën Jugosllave. Pikërisht përmes analizës së argumentuar, sqarohet se, përse Kosova ishte pjesë e Serbisë, dhe përse Kosova nuk mund të shpallte Pavarësinë e vet me rastin e shkatërrimit të mundshëm të Jugosllavisë.

Gjithashtu, autori sqaron se si dhe përse shqiptarët në ish-Jugosllavi administroheshin nga pushteti i Beogradit në krye me Josip Broz Titon, se si shqiptarët i ndanë në disa njësi administrative si në Kosovë, Serbi, Mal të Zi, Maqedoni. Gjithashtu sqarohet se përse shqiptarët quheshin kombësi, ndonëse numerikisht ishin popullsia e tretë në përbërje të ish-Jugosllavisë, pas serbëve dhe kroatëve.

A mund të ndalej procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë, sikur të mos ekzistonin ngjarjet e vitit 1981?

Më tej, në këtë libër, autori sqaron se si do të përfundonin shqiptarët dhe Kosova, nëse nuk do të ndodhnin ngjarjet e vitit 1981, ku rrjedhimisht në këtë rast të imponohen pyetjet logjike se vërtet çfarë do të ndodhte

me shqiptarët në përgjithësi, me Kosovën në veçanti, sikur të mos kishin ndodhur ngjarjet e vitit 1981. A do të shpëtonte shpërbërja e Jugosllavisë, sikur të mos kishin ndodhur këto ngjarje?

Përderisa komunizmi u shpërbë në të gjithë Evropën, në radhë të parë në Bashkimin Sovjetik, ku shpërbërja ndodhi fatmirësisht pa gjakderdhje, për shkak të pragmatizmit politik të Mihajl Gërbaqovit, në Jugosllavi ndodhi e kundërta: tendencat e unitarizmit dhe hegjemonisë serbe filluan të paraqiteshin qysh në vitin 1971–1972. Pra para se të jepej autonomia e vitit 1974 për Kosovën. Këto tendenca pastaj, shkuan në rritje, gjatë vitit 1978 e tutje.

Po gjatë kësaj periudhe, krahas shqiptarëve edhe boshnjakët e Bosnjës (popullata myslimane), ishin etnitë më të ngulfatura, si në planin politik, ashtu edhe në atë nacional.

Prandaj, rezultatet e luftës në Bosnjë dhe pasojat e këtyre rezultateve për popullatën myslimane tashmë dihen. Një ndër shkaqet e këtyre pasojave ishte edhe mungesa e homogjenitetit te popullata myslimane e Bosnjës, e cila kishte arritur gjatë periudhës jugosllave, që të koketonte në përmasa të mëdha me serbët e Bosnjës, si dhe me serbët kudo në nivel jugosllav, ku shumë mysliman të Bosnjës, gjatë kësaj periudhe, si për shkak të martesave të përziera, ashtu edhe për shkak të bashkëpunimit kulturor në sferën e letërsisë, të muzikës e të artit, me ç'rast në disa fusha, një pjesë e kulturës së popullatës myslimane ishte njëjtësuar me kulturën serbe, ku rrjedhimisht kishin arritur në situatën sa ta quanin veten si jugosllav. Dhe, pastaj pasojat dihen.

Ngjarjet e vitit 1981 përballë kozmopolitizmit jugosllav

Ngjashëm edhe në Kosovë, para fillimit të ngjarjeve të vitit 1981, disa shqiptarë e kishin përqafuar frymën e kulturës serbe, si në letërsi, muzikë etj., dhe çdo gjë të 'ndritshme' për në Evropë, përkatësisht perëndim, këta njerëz e shihnin vetëm përmes dritares së Beogradit.

Kjo shtresë e njerëzve të kësaj mendësie, kishte rrezik të zgjerohej, me rrezikun për ta bërë kështu hibridizimi kulturor e nacional, duke e përqafuar kështu frymën serbe, që përmes eufemizmit, pastaj është të quajtur 'komb jugosllav'.

Bajram Kosumi, të gjitha këto, i zbërthen në këtë studim, dhe i zbërthen bukur, me shembuj të shumtë, për shtresat e ndryshme të estabilishmentit kulturor dhe politikë në Kosovë dhe te shqiptarët në përgjithësi.

Prandaj me të drejtë, nxjerr konstatimin se ngjarjet e vitit 1981 janë revolucion edhe në planin kulturor, politik e nacional, por edhe në planin ekonomik. Këto ngjarje e ndërprenë procesin e jugosllavizimit të një shtrese të shoqërisë shqiptare, që në emër të liberalizmit, kishte përqafuar frymën serbe, të mbështjellë me amalgamën e kozmopolitizmit jugosllav.

Me të dhënat që sjell Bajram Kosumi në këtë libër, arrin ta heqë çfarëdo dileme për ndonjë lexues dhe ndonjë studiues, që ka mundur të ketë hamendësime lidhur me karakterin e këtyre ngjarjeve, duke sjellë argumente të shumta, përmes analizës dhe shembujve konkretë.

Natyrisht, autori nuk ka se si të qëndrojë indiferent ndaj tendencave të djeshme, por edhe të sotme, të ndonjë individi, që tenton të vërë sadopak hije mbi këto ngjarje. Ai përmes analizës së thellë ka arritur ta shkërmoqë pikëpamjen edhe të ndonjë intelektuali "modern", që për shkak të ambicieve të veta, apo edhe deficiteve të ndryshme në sferën kombëtare apo shkencore, mundohet të shfrytëzojë "bërrylat", duke u përpjekur për ta paraqitur mendimin e vet, gjoja serioz dhe origjinal, e që këto qëndrime i quan qëndrime të ashtuquajtura "të mesit të artë", por që me të dy këmbët rrëshqet nga mesi, duke rënë kokë e këmbë në mendimin mohues, të cilave mendime e qëndrime, tashmë vetë praktika historike, ua ka dhënë përgjigjen. Por, përgjigjja decidive e autorit, nuk mungon as në këtë libër. Thënë ndryshe, këta individë në shkencë me mendime të tilla do t'i quanim, "prosta rečenica" (fjali e thjeshtë).

Bajram Kosumi, nuk polemizon me individin. Ai i kundërvihet mendimit të paqëndrueshëm, përkatësisht logjikës së mohimit mekanik, përmes analizës dialektike shkencore.

Libri ka mbi 500 faqe, me referenca të shumta shkencore, brenda 8 kapitujve. Gjithashtu duhet të theksojmë se libri mund të lexohet si studim në tërësi, ku çdo kapitull është studim në vete, (sikur po lexohej edhe si i vetëm). Edhe në këtë rast, lexuesi nuk mbetet pa përgjigje në dilemat që janë munduar të krijohen nga qarqe të caktuara. Pra, në secilin kapitull jepet përgjigje për dilemat e veçanta, ndërkaq, në tërë librin jepet përgjigje për të gjitha dilemat në tërësi.

Gjithsesi ky libër ia vlen të lexohet nga të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare, për t'u njoftuar më hollësisht dhe më denjësisht për periudhën e lavdishme të ngjarjeve të vitit 1981, e që me të drejtë autori Bajram Kosumi e quan: Revolucioni 1981. Ato vërtet ishin Revolucion, që patën ndikim në zhvillimet politike deri në ditët e sotme

Si rrjedhojë, kushdo që të marrë mundimin të shkruajë për këto ngjarje apo për këtë periudhë historike, të dhënat që ofron Bajram Kosumi në këtë libër, nuk mund t'i anashkalojë asnjë studiues serioz.

Trandafile MOLLA - BAJA
SHPËTIMTARI I ATDHEUT

Treqind kalorës rrugës lëshojnë tringëllima,
një shpatë fitimtare qëndron si bajrak,
kalojnë me furi grykëmalesh, ndihen ushtima
fushave çelur lulet jargavan e zambak.

Këtë karvan të gjatë e udhëheq një kryetrim,
Gjergj Kastrioti, biri i Gjonit në Krujë
në krahun e tij shpata lëshon fërgëllim,
ka ardhur të shpëtojë atdheun nga hordhi e huaj.

Treqind trima me malet bërë gjerdan,
në terrin e natës nënës ia prishin gjumin,
t'i fshijë lotin e dhimbjes, të ndalë vaj e gjëmë
lotët e vajzave nuse që mbushin lumin.


Udha ishte e gjatë, toka nën këmbë dridhet
si shkumë e valëve pluhuri ngrihet lart,
gjithë populli u zgjua, nga gjumi hëna ngrihet
- Mirë se erdhe Skënderbe, atdheu të pati fat!

U tmerruan çallmat, dridhet gjysmëhëna,
fërkuan sytë, kjo gjëmë u dukej e pabesë
përqafimin përmallshëm birit i jep nëna:
- Mblidhuni, o burra, të lidhim besa-besë!

Në kuvend u ndez fjala, ashtu si ndihej shpata
o popull i Arbërit për tokën duhet bashkim,
se lirinë e vërtetë këtu mes jush e gjeta,
të shporrim pushtuesin, kështu foli ky trim.

Dhe treqind kalorës, të veshur në hekur
të gjithë bashkë u bënë edhe tre mijë,
nëna lindi shqipe në beteja për të mos vdekur,
lirinë e paqen mbrojmë burra dhe fëmijë.

Kalorësi stërvitur ndër luftëra të rrepta,
asnjëherë nuk iu bind pushtues Sulltanit,
zemrat e shkulura ua vuri përmbi çallma,
trimat i dalin zot atdheut e Ballkanit.



Ura e Taliqit

Ajne IBERHYSAJ
ANA…
(Fëmijëve që lufta ua vrau ëndrrat)

Dhimbja i ngjan një mjegulle që s'pyet për kufij.
Në xhamat e thyer të mëngjesit,
ku drita e agut i këndon ditës si rrobë mortore,
ajo ecën pa fjalë e heshtur me shekujt.

Në cep të oborrit, sytë më mbetën pezull,
ku luhaja priste hijen e saj.
Ana… luante me fluturat.
Muret dëgjuan e panë, por duar nuk patën.
Lulet ranë në tokë si të ndëshkuara
dhe bilbili… ndali këngën.

Anaaa, çika ime! … një copë shpirti u vra!

Thirrja copëtoi qiellin pëllëmbë pas pëllëmbe.
Thirrjet u bënë shungullimë lutjesh,
nën të, dheu u drodh.
Në qiell… askush s'e ndjeu.

Një kor i zi korbash u lëshua
mbi trupin e një nëne dhe bije dardane.

"Ana…", thashë me vete, u dridha!
Mjegull… flakë… më zunë sytë.
Lotët derdheshin si një faj i lashtë,
që as koha s'e shlyen dot.
Mëkati, dhimbja… pa mëshirë
e përvëluan edhe tokën.

Britma si gojë e harruar ndër shekuj,
u ngrit drejt kupës së qiellit.
Ana! As lisat nuk u përkulën më.
Vetëm shi… dhe dhimbja e një nëne,
dhe lotët… që përqafohen në dhe.
Zëri i saj me hijen endet… endet.

Një erë e egër, si fryma e fundit e një epoke.
Sakrament lutjesh të pashpërblyera edhe sot.
Toka i ruan si dëshmi.

Ana!
Shndrit… shndrit me sy drejt diellit.

Shekujt ju quajtën
barbare… o, barbare!

Ana…
luaj në tokën dardane,
fluturat t'i mbajnë krahët ngrohtë.



Suzana VARVARICA - KUKA

"MOS U NGUTNI!"

Sa bukur në gegërisht "mos u ngutni!" të jep mundësinë e të kupturit "mos u nxitoni!", si për mirë, ashtu dhe për keq. Ky titull, i cili u gjet në mesin e debateve mbi konkursin e zhvilluar në Ulqin rreth monumentit të Skënderbeut. Ai më pëlqeu pa kufi, u huazua prej të shprehurit të skulptorit të mirënjohur shkodran Ferid Kola.

Ky tekst lindi mes dhjetëra debatesh, të cilat i kam ndjekur me vëmendje mbi atë se çfarë po ndodh së fundmi në trojet shqiptare me artin e skulpturës monumentale. Ai është një art domethënës e social politik, jeton në kohëgjatësi dhe i përballet vëzhgimit dhe shijeve të brezave. Cilësia e mirë, ose jo e tillë, e skulpturës monumentale, e realizuar ditëve të sotme mes shprehive të kamufluara të realizmit socialist në imazhin figurativ realist ose modernist, kalimet apo kapërcimet e krjimeve



Ernst Barlach, "Hakmarrësi", 1914

nga një sistem vlerash te tjetri, ende shkaktojnë një gjendje amullie figurative në sytë e publikut apo të njerëzve të jetës së përditshme. Edhe pse janë krijime të kohës së sotme ose më konkretisht të kryera gjatë gjysmës së parë të shekullit XXI, shihet se ende është e vështirë të dallohet e të kapërdihet cilësia dhe tipologjia e shkulpturës monumentale në ditët tona. Situata më e fundit është ajo e krijuar rreth boceteve të propozuara për monumentin e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, i cili do të vendoset në Ulqin të Malit të Zi.

Siç e do rasti u zhvillua një konkurs, ku morën pjesë 17 bocete skulpturore. Një numër shumë i paktë ky për rëndësinë e një subjekti të tillë. Vendet e nderit u përcaktuan nga gjykimi i anëtarëve të komisionit të ngritur nga bashkia e qytetit. Vendin e parë e zuri propozimi i një kompozimi të llojit kompleks figural i ndarë në dy grupe, heroi Gjergj përballë trimave malësorë të Ulqinit i skulptorit Sabri Behramaj. Vendin e dytë e zuri propozimi i një kompozimi ekuestër të Gjergj Kastriotit mbi kalë, i cili ecën qetësisht dhe fitimtar, i skulptorit Vasil Rakaj. Vendin e tretë e zuri propozimi i një kompozmi të gjinisë së shtatores së heroit, me qëndrim vertikal, i skulptorit Agron Ujkashi. Të tre fituesit sollën tri atmosfera të ndryshme figurative. Deri më tani, ato në aspektin kompozicional të zhvillimit të formave skulpturore rezultojnë të njohura, të trajtuara dhe ekspozuara në mjediset ndërkombëtare dhe kombëtare.

Kompozimi skulpturor, që ka zënë vendin e parë, ka prej disa ditësh që ndodhet nën trysninë e gjykimeve negative, shpeshherë fyese dhe herë refuzuese dhe mohuese. Dhe në pak raste pranohet si një vepër e konceptuar ndryshe dhe që i përket formave të artit modern. Dhënia e mendimeve është ndarë në dy grupe të mëdha, ku masa më e rëndë anon nga mospranimi i kompozimit skulpturor të përzgjedhur si vendi i parë prej komisionit të profesionistëve të kohës. Nën një vëzhgim të veçantë mbi opinionet e asaj popullsie shqiptare, që ka marrë pjesë në debatet publike e në rrjetet sociale, dallon se tri bocetet skulpturore të propozuara duken sikur përcaktojnë qartë dhe mirë nivelin njohës dhe kulturor, dijet mbi monumentalizmin, shijet dhe dëshirat për formën figurative të heroit. Dhe kjo është e natyrshme.

Ka dhjetëra arsye pse ndodh që publiku i sotëm, në të përditshmen e vet, arrin të shpreh ide të shumëllojshme mbi imazhin monumental figurativ të heroit kombëtar. Ai, kur vihet përballë propozimeve figurative të artistëve skulptorë, shqetësohet rreth asaj çka nesër, e çdo ditë do të duhet të vështroj dhe admiroj. Nëse analizojmë mendimet e shprehura në publik arrijmë të zbulojmë jo vetëm nivelin ideo-kulturor të dëshirave të tyre, por edhe pamjen e stadit të sotëm dhe të nivelit të deritanishëm të skulpturës monumentale, të propozuar e të krijuar nga artistët shqiptarë.

Një nga opinionet më të zakonshme të publikut është se duan ta shohin e ta rishohin heroin mbi kalë ose siç njihet në gjuhën e artit, në formën ekuestër. Arsyeja pse më e shumta e mendimeve të publikut shqiptar e dëshiron ende ta shohë heroin kombëtar mbi kalë, pra, të formës ekuestër, është thuajse qindravjeçare e më shumë se kaq. Ajo lidhet më parë me kulturën figurative të artit ndërkombëtar, e cila heroin mbretëror, perandorak dhe mesjetar apo prijësin e një ushtrie e ka parë të realizuar më së shumti në formën e ekuestrit të vendosur në sheshe qendrore të shteteve europiane dhe më gjerë se kaq. Historia e artit e daton, si një ndër ekuestrat më të hershëm, monumentin e Marcus Aurelius mbi kalë, derdhur në bronz në 173 - 76 pas K., i cili gjendet në Romë. Po në në qytetin e famshëm të Romës nis edhe historia e ekuestrave të Gjergj Kastrioti Skënderbeut. Skulptori Romano Romanelli, (1882-1969), e realizoi veprën në 1938, e cila u vendos në vitin 1940 në sheshin "Albania" në Romë. Ndërsa, portreti – bust i Gjergj Kastrioti Skënderbeut, realizuar në bronz nga Odhise Paskali (1903-1985), ishte vendosur në vitin 1939 në Kukës. Pamja e këtij portreti u bë burim frymëzimi dhe ndikimi tek shumë skulptorë të viteve të komunizmit dhe ende ka ndikim mbi dhjetëra skulptorë të pas viteve `90.

Shembuj të ekuestreve nëpër botë ka shumë. Ata ndikuan në zgjidhjet kompozicionale të ekuestreve që kanë realizuar artistët shqiptarë gjatë shekullit XX e në fillim të atij XXI e që sot ndodhen në sheshet e qyteteve Krujë, Tiranë, Prishtinë, Shkup, Detroid. Ekzistenca e tyre e realizmit figurativ, me pamjen e heroit mbi kalë para ushtrisë së tij, tërheq vëmendjen dhe nxit të mos pranohen lehtësisht zgjidhjet e tjera kompozicionale. Kjo nxitje shkaktohet edhe pse historiografia e periudhës komuniste e trajtoi Gjergj Kastriotin si një hero lufte dhe lider të bashkimit kombëtar, duke ia anashkaluar disi cilësitë e tjera si: politike, diplomatike, sociale dhe fetare. Këto cilësi, të faktuara në ditët e sotme nga burime arkivore, e pasurojnë dijen mbi figurën komplekse të kryetrimit mesjetar shqiptar, por në të njëjtën kohë kanë krijuar edhe rezistencë për t`i pranuar, duke shkaktuar tek një pjesë e popullsisë një mendësi të ngurtë e të ashpër, e cila dëshiron ta trashëgojë figurën e kryetrimit të himnizuar e madhështore. Madje në skulpturën monumentale vetëm të vendosur mbi kalin e tij, si dhe mundësisht të mos lejohen trajtime të tjera figurative dhe kategorikisht të përjashtohen trajtimet e formave moderne. Gjithësesi, asgjë nuk absolutizohet. Kërkimet figurative në artet pamore e kanë trajtuar figurën e kryeheroit me shprehi emocionale të disallojeve dhe në pozicione të ndryshme. Por mendësia ekuestrale në popull lidhet ngushtësisht me ekzistencën e qëndrueshme ekuestrale artistike, e cila e ka përmbushur më së miri qëllimin estetik dhe vijoi të funksionojë dhe në konkursin e fundit të Ulqinit. Boceti i equestrit Skënderbe, i skulptorit Vasil Rakaj u vlerësua me çmimin e dytë. Në këtë mënyrë shihet se bëhen bashkë dijet monumentale të tri segmenteve: popull, artist dhe anëtarë profesionistë të komisionit vlerësues. Por komisioni nuk i dha vendin e parë, edhe pse jam e bindur që e ka njohur mjaft mirë situatën populiste të parapëlqimit të një ekuestri për Skënderbeun. Në trojet ku jetojnë shqiptarë ndodhen dy ekuestër të tij në Shqipëri si një në Krujë, me autor Janaq Paçon dhe një në Tiranë me autorë: Janaq Paçon, Odhise Paskalin dhe Andrea Manon. Një tjetër në Prishtinë replikë e ekuestrit të Krujës dhe një në Shkup me autor Thoma Thomai Dhamon.

Boceti i çmimit të tretë tregoi se kërkesa e artistit ishte të shkëputej prej ekuestrit dhe të pasqyronte një shtatore monumentale, ku psiku dhe fiziku tors i heroit të qëndrojnë drejt, me shpatën vertikalisht para e të mbërthyer me të dy duart. Një trajtim i tillë tashmë është shumë i përhapur në skulpturat e statujave që i përkasin dëshmisë së figurës së mbretit, klerikut reformator ose figurës metaforike "Drejtësia", në gjykatat e larta. Disa prej tyre janë si: ajo e mbretit viking Alfredi i Madh, që jetoi në shekullit IX dhe objekti kryesor i tij është shpata. Statuja e reformatorit Ulrich Zwingli në Zvicër, që mban përpara biblën dhe shpatën, si dhe statuja alegorike "Drejtësia", që mban para trupit shpatën dhe ndodhet në hyrje të fasadës qendrore të gjykatës supreme të Londrës. Te boceti i çmimit të tretë shpata është objekti simbolik kryesor. Ai kryen dy funksione, atë të mjetit luftarak dhe atë të kryqit si shenjë e një luftëtari të mesjetës, qëllimi i të cilit ishte jo vetëm të bashkonte shqiptarët, por edhe të mbronte perëndimin e krishterë ndaj vërshimit të pushtimeve të lindjes osmane, një dëshmi kjo e njohur dhe e folur vetëm pas viteve `90. Ndërsa simbolet e metaforave figurative e qarkojnë këtë bocet në mënyrë tregimtare, ku evidencohet mazhi i shqiponjës në kraharorin e heroit. Natyrisht një gjetje e tillë kompozicionale e shtatores së heroit udhëheqës e luftëtar është e njohur në skulpturën e krijimeve të artistëve shqiptarë, duke nisur me statujën e Skënderbeut, me shpatën të ngulur në tokë, të realizuar nga Odhise Paskali. Ndërsa komisioni ka vlerësuar drejt kërkesën monumentale të skulptorit Agron Ujkashi, e cila shkoi deri aty sa ta shohë heroin si një individ të veçantë, që nëse do të ishte fitues do të bëhej vetëm shprehi e faktit statik të ekzistencës së heroit përmes një trajtimi realist e i plotësuar me simbolika objektesh tregimtarë.



Umberto Boccioni, "Format unike të vazhdimësisë në hapësirë", 1913

Vjen një ditë dhe vjen një brez tjetër skulptorësh të rinj, që arsyetojnë për të evidencuar të ndryshmen e që dëshirojnë të jetojnë me modernen, me forma figurative që tejkalojnë tërësisht format e para e të njohura realiste të krijimit monumental mbi Skënderbeun si equestrian, ashtu dhe shtatoren në këmbë. Ata bëjnë, pasi dëshirojnë të provojnë tjetrën apo të renë që dallon shpesh e panatyrshme, sepse figurat që krijojnë i largohen pasqyrimit të drejtpërdrejtë të natyrës. Ky qëndrim solli në konkursin e Ulqinit bocetin e propozuar nga Sabri Behramaj, i cili është i përbërë nga dy pjesë. Mendoj se komisioni e shquajti si një zgjidhje të veçantë, të patrajtuar më parë në skulpturën shqiptare monumentale dhe e vlerësoi me çmimin e parë, vlerësim që tashmë nuk mund të kontestohet, por që mund të debatohet e të opinionizohet.

Sa e mundur është të pranohet e të shijohet ky trajtim jo realist dhe kjo zgjidhje kompozicionale që i përket po themi parimeve të skulpturës moderne të shfaqura në Europën e fund shekullit XIX dhe të fillimit të shek. XX? Sa origjinal është një trajtim i tillë si në formë dhe në përmbajtje?

Kur në vepër janë bërë bashkë dhe në lartësinë e duhur estetike të gjitha elementet kreative e përbërëse, atëherë



Oseph Csaky, "Autoportreti", 1913

është plotësisht e mundur të pranohen trajtime jo realiste edhe kur ato përdoren për të pasqyruar personalitete historike. Dhe, kjo ka ndodhur me monumentin portret bust të shtatores së Fan S. Nolit, që ekspozohet në Tiranë, krijuar nga skulptori i mirënjohur Thoma Thomai Dhamo (1939), pas viteve `90. Monumenti u prit me kritika të shumëllojshme. Sot i ka tejkaluar të gjitha. Asaj kohe shënoi fillesën e trajtimit të një skulpture moderne mbi subjektin e personalitetit historik dhe anashkaloi tërësisht mendësitë raliste dhe ato të realizmit socialist.

A mund të themi se është e njëjta situatë me projekt-bocetin e çmimit të parë në Ulqin? Në pika të përgjithëshme po, por në pika nevralgjike jo! Krijimi modern i Thoma Thomai Dhamos është i besueshëm pasi rridhte nga puna krijuese e një artisti të formuar qartë e qenësishëm me kulturën moderne figurative europiane që në vitet `50 të formimit të tij në Akademinë e Arkitekturës dhe të Dizajnerit në Pragë. Ky formim krijimi vijonte çdo ditë në studion e tij edhe në kohën e komunizmit. Të gjitha skulpturat e tij edhe kur tentojnë të kapërcejnë realizmin etiketohen si të Thoma Thomai Dhamos. Kjo lidhet me qëndrueshmërinë jetike dhe artistike të krijimit individual, që përcakton dinjitetin estetik unik të artistit.

Ndërsa me artistin e ri, Behramaj, shihet qartë që kemi përballë një përmbajtje dinjitoze, një zgjidhje domethënëse dhe krejt të ndryshme nga ç`kemi parë deri më sot në lidhje me personalitetin e kryetrimit, si dhe në lidhje me veprat e tjera të artistit. Ajo që po shqetëson publikun, ajo që "e penalizon" projektin është forma plastike që ka realizuar idenë e tij. Ajo është një formë plastike e huazuar thuajse nga pak te gjigandët e ekspresionizmit, abstrakt ekspresionizmit, kubizmit dhe të futurizmit. Kjo formë e huazuar eklektike, përmes skulpturës monumentale, i është veshur kryeheroit dhe luftëtarëve të tij për të sjellë një pamje tjetër të tyre jo realiste. Dhe, në mënyrë të llogjikshme kjo formë e huazuar e ka opinionizuar negativisht artistin, sepse sipas tyre, përmbajtja, që nënkupton organizimin e subjektit të monumentit në dy grupe dhe forma plastike apo skulpturore nuk janë "përputhur", nuk janë bërë bashkë dhe kanë krijuar një atmosferë skulpturore plot thepisje dhe pikëpyetje. Kjo ndodh sepse artisti shqiptar dhe arti figurativ apo pamor në Shqipëri, por edhe në Kosovë nuk i kanë zhvillimet e lëvizjeve moderne të njëkohshme me ato europiane e më gjerë. Dhe më e trishtueshmja është se shpeshherë artistët shqiptarë bien në imitime dhe huazime të formave të lëvizjeve moderne europiane, pa u thelluar në psetë dhe arsyet e lulëzimit të tyre. Më kryesorja është se këto zhvillime u mungojnë edhe dijeve të publikut shqiptar, i cili nuk është edukuar me to gjatë formimit shkollaresk apo akademik. Ai, publiku ynë, është ushqyer me forma të artit të pasqyrimit të drejtpërdrejtë nga natyra, me ato natyraliste dhe realiste, si dhe format e artit të propagandës dhe për këtë ka çdo të drejtë të shprehet se dëshiron një monument realist e me forma të lexueshme natyraliste, për kryetrimin Skënderbe. Por a duhet që këto dëshira ta penalizojnë veprën fituese? Mendoj se jo. Por a ka te këto dëshira të publikut një fill që të bën të mendosh nëse vepra është dinjitoze ose jo për të paraqitur figurën legjendare të Skënderbeut? Natyrisht që ka. Dhe bukur qartë e thotë skulptori Ferid Kola, "Mos u ngutni!".

Forma e huazuar moderne e artistit shqiptar i ka bazamentet e forta, që mund të ecim mbi to duke lexuar e njo-



Sabri Behramaj, "Skënderbeu me trimat", projekt–bocet, 2025

hur historinë e artit ndërkombëtar. Nëse mendojmë rreth ekspresionizmit, do të zbulojmë se asnjë artist madhor i tij nuk trajtoi figurën e njohur reale të përsonalitetit historik, por trajtoi emocione të ndryshme njerëzore. Duhet të pranojmë se artisti shqiptar ka huazuar formë ekspresioniste, e cila lindi në brumin e lëvizjes artistike, që u cilësua ekspresionizëm dhe u shfaq në fillim të shekullit XX. Në skulpturë ai dallohet nga ekzagjerimi i formave, mënyra se si emocionet manifestohen intensivisht dhe nga refuzimi i realizmit klasik. Në skulpturë ekspresionizmi nuk kërkonte saktësi estetike, por të përcjellë ndjenja ankthi, dëshpërimi, vuajtjeje ose energjish negative përmes figurave me një dinamizëm të fortë dhe të transformuara. Vepra "Hakmarrësi" (1914) e skulptorit gjerman Ernst Barlach (1870-1938), është një vepër themelore në skulpturën moderne ekspresioniste, që paraqet kaosin dhe emocionet e një bote në prag të trazirave (bëhet fjalë për shpërthimin e Luftës së Parë Botërore) intensitetin e thellë emocional dhe eksplorimin e vuajtjeve njerëzore. Artistët ekspresionistë nuk kishin asnjë qëllim për të krijuar me format e tyre të reja imazhe të personaliteteve të njohura historike.




Dr. Fatmir SELIMI

NË RRUGËN PA KTHIM

Historia e shpërnguljes së familjes
së Xhemail Dragobuzhdës për në Turqi.

Xhemail Dragobuzhda, pas ndjekjes së mbi 800 fshatrave shqiptare nga Sanxhaku i Nishit, përkatësisht nga rrethina e Leskovcit, me familjen e vet shpërngulet në fshatin Pozharan të Vitisë. Prej aty, më 1925 i bashkohet karvanit të pafund të shqiptarëve për të migruar për në Turqi. Ata së pari vendosen në Bafra të Turqis, në brigjet e Detit të Zi, por jeta në Bafra nuk u pëlqen dhe vendosin të kthehen me familje në Pozharan, në vitin 1937.





Në vitin 1944, pas futjes së forcave serbe në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, torturat për familjen Dragobuzhda vazhdojnë. Madje pushtuesit e pushkatojnë prindin e Xhemail Dragobuzhdës, Tahirin, së bashku me qindra të tjerë shqiptarë të pafajshëm.
Sipas të dhënave, Tahir Dragobuzhdën e ka pushkatuar Milan Jariqi, një kolenel nga Mali i Zi, njëherësh edhe drejtor i burgut të Gjilanit. Në vitin 1958, Xhemail Dragobuzhda e takon Milan Jariqin në fshatin Pozharan afër një are të mbjellë me misër. Kështu, Xhemaili e qëllon Jariqin me disa plumba në kraharor, të cilin e plagos rëndë, por nuk vdes.
Pas aktit të kryer, Xhemail Dragobuzhda niset për në shtëpi për t'u përshëndetur me farefisin e tij. Nga habia, ai ia heq kokën një pate dhe një gjeli në shtëpinë e Shahin Mursel Dragobuzhdës. Nga aty ai niset për në Shkup.
Më parë kishte përgatitur dokumentet e udhëtimit për në Turqi. Nga Shkupi nisen rrugës pa kthim. Prej Selanikut vazhdojnë për në Stamboll me anije. Bashkëshortja e Xhamail Dragobuzhdës, Akilja, vazhdon ta mbajë vajzën e vdekur ende në duar. Kufoma në anije i tërheq peshkaqenët, të cilët fillojnë ta sulmojnë anijen. Kështu, pas kësaj, kapiteni i anijes së bashku me ekuipazhin nisin të hulumtojnë për kufomën e mundshme në anije. Pas një kohe, zbulojnë se Akilja po e mbante kufomën e vajzës ende të mbështetur në gjoksin e saj, kinse po i jepte gji. Ata e marrin trupin e pajetë të vajzës, të vdekur që para një jave dhe e hedhin në det, gjë që i largon përfundimisht peshkaqenët nga sulmi i mëtejmë i anijes.

Rrahim M. SADIKU
TE MOLLA E KUQE...

Aty toka çdo kohë nxjerr zjarr
Për armiq shpirtsëmurë barbarë.
Hiri e rrënja më shumë se ar.

Rrënja e fara e MOLLËS së Kuqe
Nga hiri ynë si rreze dielli
Çdo plis dheu toke e qielli.

Kaluar kanë kohëra e mote
Këtu pjesë dielli e pjesë jete
Pjesë Historie para bote.

Këtu hija e tokës lëshon krisma
Mollën e Kuqe e bekoi zoti
Porositi Skënderbeu qëmoti.

Flori BRUQI

EDUKOI BREZAT E KOHËS

Gjithë jetën me laps në dorë edukoi brezat e kohës,
fëmijëve ua mësoi gjeografinë e atdheut.
Si yjtë polarë, hartat e Shqipërisë Etnike,
brezat i panë netëve në sytë e tij
në retinën e tij delikate.
Shkumësi i bardhë shpjegonte të padukshmen e dritës,
mundimin e madh në kohën e pa kohë.
Shpirtrave të dlirë u foli për Ariun e vogël,
fytyrëqeshur me busullën e dijes në dorë
E sytë e tij kurrë s'u përulën në kohë.
I therte dhimbja për Atdheun e ndarë pikë e pesë…
E shijoji Rilindjen e Kombit
kërkoi nëpër hapësira qiejsh e resh,
Alpet e lira shqiptare
të veshura me kostum shekullor.
E gjeti shkabën dy krenshe
në themelin e shtëpisë të bërë blozë
dhe e bëri të pavdekshme rininë e vet
i rijësuar në mote...

Mexhid HAVOLLI

PËRRALLË E VJETËR

Ti, secilës ditë
M'i rri e ndrojtur
Sa herë të kërkoj
Përtej stinës së zjarrtë.

Lumi i pritjes
S'qetësohet në mua
Dikush përsëri
M'i rrëzon ëndrrat.

Kot grindesh me durimin
Fjalëve u iku vjeshta
Tek mbaron përrallë e vjetër
E gjatë sa durimi në atë gur.

Si të dal nga ky mllef
Dhe kësaj rruge që s'mbaron
Në mua dhe në ty.

Derisa shtëpisë m'i mbeti çel dera
Është koha t'ia vëmë gurin
Ëndrrës që pa pra zgërdhin.

Mikel GOJANI

NJË RRUGËTIM I GJATË

(Jeronim de Radës)

Shpeshherë si në ëndërr
Kam marrë një rrugëtim të gjatë,
Drejt kodrave të Maqit arbëresh
Përballë Shënmitrit.

Duke ecur gurëve lashtësorë,
Kam takuar Jeronimin e Radhenjve,
Poetin që edhe mbas dy shekujsh
Akoma gjallonte.

Së bashku
Me kohën dhe personazhet e tij
rronin Skënderbeu,
Serefina Topia, Milosau, Rina...
Kroi me ujë të ftohtë e të kristaltë,
Shtëpitë, rrugët, lisat, hijet...

Dielli dhe Hëna e të parëve...
Çdo gjë që frymonte
E shndërruar në ikonë.

De Rada
Si Prometeu...
I përtërinte njerëzit,
Natyrën,
Dhe dheun...

E shoh tani se si
Me një cironkë në xhep
Rrugëve kalon dhe
Pështpërit

"Gjaku ynë i shprishur,
Gjaku i Arbrit rron..."



Ajo dhe hutini

Syhejl HAVOLLI
NË SHTËPI PA SHTËPI

Qe pesëqind vjet
Jetoj në shtëpinë time i huajzuar

Pa dëshirë
I shprush dëshirat

Portretin e Migjenit
E gozhdova në mur
Pronari pa abetare
Ti nuk je pronar i kësaj shtëpie
Asgjë mos var

Migjeni duke buzëqeshur
Në zemrën time
Më porositi
Vazhdo projektin e revolucionit poetik

Minivere MAKA
TË PRUSHTAT PLAGË

mbi qilim t'purpurtë sonte eci
aroma e saj më josh si ditën me shi
avulli dremit pa zhurmë në shpirtin tim flakë
rrezen e artë n'prozhme e çau një krismë
vello e bardhë n'krah t'ëndrrës ishte aty
natën kur retë po mbështjellin horizontin gri
hënës së plotë rrugë i kanë zënë
të prushtat plagë n'kraharor vezullim

zhagas eci pa zhurmë në shpirt
ballë rrëshqas në Itakën e ëndërruar
mbi të purpurtin qilim sonte eci
se Penelopa qëndis këmishë të pritjes

unë si trumcak i plagosur këndoj nën strehën e vjetër
nga shpirti nxjerr dufin e mbledhur shekujve
lulëkuqet nga varri të më zgjojnë
atje ku aromë e saj më pret
me këngë në shpirt e meteorë dritash

si pegasus mbi oazë të thinjave ta mbërthej
në pranverat e gjakosura t'ia shëroj të prushtat plagë
mall të shuaj në këmishë të pritjes
në tokën e lulëkuqeve maratonë të sjell
kënga të jehojë përtej legjendës së pritjeve
atje ku Ajkuna vajtonte Omerin
e në luadhe zërat e agut të lirisë t'i kthej

eci në qilim t'purpurtë
se lulëkuqet kanë prekur stinët
aroma më josh e më thërret
sonte kur qielli ngryset e shiu bie si atë ditë

Fatbardha KAÇI
AROMË BLIRI NË PRISHTINË

Deh mushkëri të qiellit aromë bliri.
Prek fytyrë t' Prishtinës,
ky parfum qershori.
Zogu i agimit nis fluturimin.
Rrezet e diellit i puthin zgjimin...
Në faqe ndërtesash,
shkruar dorë engjëjsh,
premtim mosharrese të dëshmorit.
Në to, dhembje tjetër klith:
- 54 gra dhunuar... n'gjysmë viti.
Eh, këto pemë të blirit si shpirt,
zgjatur kanë krahë të njerëzisë,
përqafim të ëmbël t'pafajësisë...

Vashë e hirshme mbrëmja vjen,
këngë e dashurisë në qytet.
Aromë bliri vesh dhe yjësitë...
Duke uruar: "Natën e mirë!"
buzët e kohësisë i puthin ballin,
ballin edhe sytë e lirisë.

...Aromë bliri... fryma jote,
Prishtinë...

Veli VELIU
NË MAJËN E KORABIT

Me alpinistët u ngjita
Në majën e Korabit,
Si mbi kulmin e botës
Dhe shikova në largësi.
Udhëtimi përpjetë i gjatë,
E pata ndihmën e labit,
Vërtet më e madhe
me duket kjo Shqipëri!

Era frynte më fort,
e ndez zjarrin në shpirt!
Shqiponja e ka shikimin
dhe fluturimin ngadhënjimtar,
Prej zemrës më erdhi kjo forcë
nga gëzimi qeshin sytë,
Asnjëherë më mirë
vendin tim s'e kam parë!

Agim BAJRAMI

TROTUAR KORRUPSIONI!


Trotuari ku eci unë i ngjan një udhe mundimi
Me gropa dhe pluhur të verdhë
Ai u shkërmoq dy javë pas inaugurimit
A thua s'kish qenë asnjëherë

Me lekët që vodhi ndërtuesi hajdut
(Pa pasur aspak drojë e frikë)
U nis menjëherë për të çlodhur pak trutë
Në Ibiza dhe Sharm el Sheik

Dhe çon prej andej ca foto "të nxehta"
Me të dashurën e tij si koketë
Duke pështëritur nën zë: Sa e bukur është jeta
Kur ligji dhe shteti je vetë

Mjafton që të lehësh siç leh lukunia
Të bëhesh dhe vetë pjesë e saj
Si lumë do të vërshojnë paratë pasuria
Ndershmëria është virtyt budallaj

Trotuari i ri ngjason me një udhë ferri
Me gropa të thella humnerë
Ne ecim mbi të si një grumbull me dele
Dhe vetëm blegërijmë ndonjëherë



Nga webfaqja koha.net

Faruk TASHOLLI

HUNI DHE MAGARI

Veç me mujtë magari
Nji herë me kapë hunin,
Kish m'i shkoq do njerëz
Që ia kanë marrë trunin.

Kish me dalë qytetit
N'çdo hap tu' i taku,
Dykambshat mbrapshtana
Të vyem për hu!

Ani me zgat kryet
Me k'qyr n'parlament,
Prej poterës, gazit -
I kishin dalë mentë!

Ish ndalë m'u ankue
N'derë të Qeverisë:
Pse na përgojoni
Si soj t'magarisë!

Vërtet na magarët
Bërtasim tuj pallë,
Por mirë e dimë rendin
Kur duhet m'u ndalë.

Ndërsa ju or shokë
Mbytni pëllitjet tona,
Tek e çoni zanin
Nëpër mikrofona!

Ne gjithë nëpër shekuj
Besnikërisht kem` pallë,
Po pse ju o njerëz
Ndërroni fytyrë e fjalë?!

Ah, me pasë magari
Veç nji herë nji hu!
Kush ia mori veset
Krejt e kish shkoklu!

Ferit LAMAJ

SHKALLË GJYQËSORI

Për ca prona të tim Gjyshi
shkuma po më del.
Njëzet vjet gjyq pas gjyqi
me rrënjë, me themel.

Nëpër shkallë zbrit e hip,
rrahur si këlysh:
kur ia nisa isha Nip,
sot jam... Babagjysh!



FNP "Drini poetik", Prizren, 2025



LSHK: Pas një veprimtarie letrare



Në SHF "Enver Maloku" të Podujevës



NË SHF "De Rada" të Ferizajt



"Drini poetik": Juria dhe fituesit (2025)



Përmet: Festivali kombëtar i poezisë "Gjurmëve naimiane", 2025

Ky numër i "Metaforës" pjesërisht përkrahet nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës.



L I 4R 3 A 2 !

ÇMIMI 2€ / 200 lekë